

*B.H.
M. 88*

ANDRE M.JED.JA




vepra letrare 1

NDRE MJEDJA

vepra
letrare

1




Mbledhur e pajisur me komente e shënimë nga
RINUSH IDRIZI

Redaktor

LLAZAR SILIQI

Shënim i redaksisë:

Gjatë përgatitjes për shtyp të veprës poetike të Ndre Mqedjes janë bërë disa ndërhyrje të pakta drejtshkrimore.



NDRE MJEDJA

Krijimtaria letrare e Ndre Mjedes po i paraqilet lexuesit me dy vëllime.

Vëllimi i parë përmban veprën «*Juvenilia*», vjersha që s'qenë përfshirë në këtë përbledhje poetike, si dhe vjersha të mbeturat dorëshkrim.

Në vëllimin e dytë janë vendosur poemat «*Lissus*, «*Scodra*», «*Liria*» e vjershat për fëmijë. Po në këtë vëllim janë përfshirë edhe shkrime në prozë të këtij autorit, diskutime në parlament e korrespondenca me G. Majerin.

JETA DHE VEPRA E NDRE MJEDJES

Studimet dhe hulumtimet e bëra lidhur me figurën e poetit të shquar Ndrë Mjedja kanë ndriçuar tashmë shumë aspekte të jetës dhe të krijimtarisë së tij, gjë që ka mënjanuar inkonsekueanca dhe qëndrimet e kundërtta, duke përforcuar e pasuruar argumentet në të vërtetat mbi këtë personalitet. Por, ndërkaq, nuk mund të flasim për shterje të të dhënave jetësore, për sa kohë që jeta dhe veprimtaria e Ndrie Mjedjes jashtë atdheut është pothuajse e paprekur, e pagjuruar. Dhe ky kapitull i hapur prek një jetë afér dy dekadash.

Andrea Mjedja, apo si e njohim më shumë, Ndre Mjedja, lindi më 20 nëntor 1866 në Shkodër, në familjen e varfër të Jak dhe Luçie Zefit. Mbas Andresë atyre u lindi dhe një djali tjetër, Lazri. Kjo familje e vogël shpejt do të mbetet pa Jakun, burrin e matur dhe babanë e dashur. Bashkëkohësit, që kanë jetuar në rrugën «Kroqej» në Shkodër, e mbanin mend mirë shtëpinë e varfër të kësaj familjeje, mbanin mend mirë Luçien, rrobalarësen, atë grua të fortë, këmbëngulëse, që mbajti peshën e rritjes së dy fëmijëve në një kohë të vështirë, të renduar aq shumë nga gjhypja dhe shfrytëzimi.

Ishte periudha kur Shqipëria ndodhej nën sundimin e Perandorisë Osmane, e cila, e mbërthyer në kriza të vazhdueshme politike dhe ekonomike, ruante së forti marrëdhënie dhe shprehi mesjetare, që shfaqeshin qoftë në jetën shoqërore, qoftë në atë ekonomike dhe politike. Një pjesë të mirë të këtij rrënimi ekonomik dhe të kësaj prapambetjeje të thellë e mbante edhe Shqipëria, e cila, më shumë se çdo vend tjetër, ishte bërë pre e lakkive të Fuqive të Mëdha dhe e shovinistëve fqinjë. Shumë misionarë të huaj vërtiteshin në këto troje dhe bënin politikën e shteteve që i kishin dërguar, duke u paraqitur si ihtarë të kulturës shqiptare apo përkrahës të përpjekjeve liridashëse të popullit tonë. Por lëvizjet çiirimtare kishin përfshirë trupin e atdheut dhe heroizmi ishte bërë i zakonshëm. Patriotët nuk ndaleshin përpara asgjëje. Mbrojtja e atdheut, e kufijve të tij, fitimi i lirisë dhe i pavarësisë, lëvrimi i gjuhës shqipe, arsimimi i popullit ishin çështje thelbësore, që përcaktonin fytyrën patriotike të kombit, rrugëzgjidhja e të cilave varej vetëm nga impejnimi e vetëmohimi e deri në sakrifikim nga ai unitet veprimi e mendimi i patriotëve, që të conte drejt lirisë, drejt formimit të asaj ndërgjegjeje kombëtare, që aq bukur përmblidhej me thirrjen: «Gjithçka për Atdheun!».

Brenda këtij kuadri duhet parë edhejeta e familjes së Mqedjes. Aty gjendet edhe shpjegimi se përsë nëna e tij, një grua e ve, me aq mungesa ekonomike, sakrifikoi gjithçka e i dërgoi të dy fëmijët në shkollë.

Nga 5 prilli 1877 deri në fillim të vitit 1880, Ndre Mqedjen e gjejmë nxënës në një shkollë private në Shkodër. Të dhënat na flasin për një fëmijë të mprehtë, me shumë vullnet e me rezultate shumë të mira. Jezuitët përpinqeshin të tërhiqnin në shkollat e tyre fëmijët që premtionin. Ata, duke parë aftësitë dhe talentin e Mqedjes 13-vjeçar, do ta dërgojnë të studiojë në Valencia të Spanjës, në Porto-Re, atëherë provincë e Torinos, në kolegjin «Gerolamo Vida» të Kremonës, në Krakov të Polonisë, madje pohohet që të ketë qenë student dhe në Laval të Francës e në të tjera vende. Gjatë kësaj kohe

ai ka kryer njëkohësisht edhe detyrën e profesorit, ku është shquar. Por ajo që ka rëndësi në këtë periudhë është takti që ai kurrë nuk i shkëputi marrëheniet me atdheun. Ai ndoqi me interes punimet e Jungut, atëherë misionar në Shqipëri, shtrylezoi mirë shtypin e kohës dhe bëri çmos të lidhëte korrespondencë me disa patriotë të kësaj periudhe. Me synim shkencor e patriotik ai punoi shumë për të njojur në thellësi të dy dialektet, gegë e toskë, si dhe foiklorin shqiptar, punë që e kryente me zell, sidomos kur kthehej në Shqipëri në pushimet shkolllore. Mqedja ndjek arritjet bashkëkohore të kryera në fushën e linguistikës dhe u përkushtohet studimeve albanologjike të kryera deri atëherë nga të huajt. Në këtë vështrim ai është një rilindës energjik me shumë kulturë, që pa rezerva shfaq patriotizmin e tij, duke iu përgjigjur kerkesave të mëdha të kohës, siç ishin lëvrimi i gjuhës shqipe, studimi shkencor i saj, të mësuarit e kësaj gjuhe nga populli. Që në tillim Mqedja vjen mes rilindësve edhe si poet, edhe si studiues e lëvrues i gjuhës dhe mësues.

Si poet, ai shpirtëzoi idetë më përparimtare patriotike e politike të kohës së vet, si studiues ai pati ndaj gjuhës angazhimin patriotik e shkencor, ku korrespondenca me Majerin, një nga albanologët më në zë të kohës, na e bën të qartë figurën e Mqedjes dhe qëllimet e larta të veprimtarisë së tij. Mirëpojeta e tij, e mbërthyer nga ligjet jezuïte ishte shumë e ngushtë, asfiksuese për një veprimtari kaq të rëndësishme e kaq kombëtare. Prandaj ai, pasi ishte përplasur disa herë me urdhri jezuit, duke mos i përfillur ofertat e tyre për katedra pedagogjike në universitetet e huaja, u kthye në atdhe¹.

Atëherë urdhri jezuit u hakmor, duke e ndërlidhur dhe rënduar vazhdimisht jetën e tij përmes shpifjeve dhe intrigave, duke u përpjekur ta njollose si njeri dhe ta mohonte si talent.

Mbas shumë përpjekjesh, Mqedja vjen në atdhe në fillim të vitit 1899 me plane e ëndrra prej patrioti, i sho-

1) Më hollësishët shih: R. Idrizi, «Ndre Mqedja», T. 1980, M. Gurakuqi, «Mbi veprën poetike të Mqedës», T. 1980.

qëruar nga Prengë Doçi, një nga abatët më të pushtet-shëm të kohës e një nga themeluesit e Shoqërisë «Bashkimi», i cili, siç thotë dom Ndoc Nikaj në «Kujtimet» e tij, e përkrahu në fillim atë. Lidhja e Prengë Doçit me Mqedjen dhe dashamirësia e këtij abati ndaj tij e ka burimin në marrëveshjen e tyre për të lëvruar gjuhën shqipe, për të bashkëpunuar me shoqërinë «Bashkimi». Abat Doçi pa te Mqedja aftësitetë shkencore gjuhësore, zotëruesh e dy dialekteve, të riun e talentuar, i cili ishte vlerësuar si një nga më të kulturuarit e kohës.¹⁾

Por Mqedja largohet nga kjo shoqëri, duke u bërë objekt thashethemesh e sulmesh. Famullitar i Vigut, i mbetur mes kësaj furie sulmesh e opinionesh, atij i gjendet pranë i vëllai, Lazri, ipeshkvi i Zadrimës, dhe të dy në vitin 1901 krijojnë shoqërinë «Agimi», që kishte për bazë alfabetin e Mqedjes. Mqedja, pa humbur kohë, u përpoq të vërë në jetë bindjet e tij gjuhësore, qëllimet e tij patriotike dhe të realizonte dëshirën për ngritjen e shkollave shqipe, që shprehet aq qartë në korrespondencën me Majerin, kur thotë: «Dëshiri im do të ishte me themelue atje (në Shqipëri-R. I.)... një shkollë të përsosur në gjuhën shqipe.»²⁾

Në këto vite aktiviteti i tij në çështjet gjuhësore tërheq vëmendjen e bashkëkohësve dhe ai propozohet edhe si mësues në Borgo Erizo, Zara. Por Mqedjen nuk e çuan atje. Ai ndodhet në një qerthull ngjarjesh e rrethanash të vështira. Megjithatë, i pajisur me një vullnet e këmbëngulje të madhe, ai shpejt bëhet i njojur me alfabetin e tij, i cili do të gjejë përhapje deri në Korçë e Tiranë. Mqedja punoi me ngulm që alfabeti të miratohej nga albanologë, nga shkrimitarë gegë dhe toskë dhe nga shkolla të ndryshme që ishin hapur në vend. Pranë tij qën-

1) AQSH i RPSSH; F. 41; d. 13; f. 317; Më hollësishët Shih: R. Idrizi «Ndre Mqedja», T. 1980, M. Gurakuqi, «Mbi veprën poetike të Mqedjes» T. 1980.

2) Jup Kastrati, «Dymbëdhjetë letra të Ndre Mqedjes dërguar albanologut Gustav Majer gjatë viteve 1892-1893, «Arsimi popullor», viti XXII, Nr. 1 Tiranë, janar-shkurt 1967

drojnë Xanoni e Logoreci. Dhe pikërisht një vit më vonë, më 1-6 maj 1902, në konferencën e zhvilluar në Shkodër, ku merrnin pjesë ipëshkvit shqiptarë dhe ku shtrohej çështja e përdorimit të një alfabeti, u arrit që të pranohet si më i saktë nga ana shkencore alfabeti i «Agimit» dhe librat të shtypeshin me këtë alfabet. Shoqëria «Agimi» gjatë gjithë aktivitetit të saj arriti të botojë 25 tekste shkollore.

Mqedja ndodhet tani në famullinë e Dajçit, si ndihmësfamullitar. Ai nuk pushon së punuari për gjuhën shqipe dhe çdo ditë e më fort bie në sy përgatitja e tij dhe atësitë shkencore. E në këtë kohë ai boton studimin për alfabetin shqip në një broshurë më vete me titull «Esposizione dell’alfabeto adottato nella Conferenza dei Vescovi albanesi in Scutari» (Parashtrimi i alfabetit adaptue në Konferencën e Ipeshkvive shqiptare në Shkodër), ku ai parashtri qartë pikëpamjet e veta shkencore, të cilat flisnin për studimet e thella dhe të bazuara, që ai kishte bërë në lëmin e gjuhësisë. Mqedja ngulmonte për një alfabet shkencor, ku çdo tingull të kishte vetëm një shkronjë dhe, atje ku nuk plotësohej ky parim, të viheshin shenja diakritike. Në bazë të këtij alfabeti të ishte alfabeti latin, por kurrë ai italian, siç mendonin mjaft studiues të kohës, mbasi ky i fundit nuk i kishte veçoritë fonetike të shqipes. Ai u mundua të përcaktonte kriteret e tij, duke u nisur nga arsyetimi «një sistem shkrimi» bazuë mbi natyrën e vetë tingujve dhe mbi cilësitetë e gjuhës sonë». Në të gjitha këto trajtime e qëndrime të karakterit shkencor ai ka parasysh kërkesat fonetike dhe etimologjike të gjuhës sonë, të cilat i vështron thellë në të dy dialektet, toskë e gegë. Që në letrat me albanologun e shquar Majer, ai kishte theksuar se nuk mund të shkruhej më ashtu siç shkruanin shkrimtarët e Veriut, kryesisht ata shkodranë. Në analizën shkencore që bën, të bie në sy se ai kurrë nuk përcmon, por përkundrazi është asimilues i gjithçkaje të mirë dhe interpretues kritik, gjak-flohtë dhe objektiv edhe ndaj mendimeve të njerëzve të tij më të dashur të shkencës. Vështruar kështu, nuk është rastit që Mqedja do të bëhet përfaqësuesi i atdheut

në Kongresin XIII Ndërkombe të Orientalistëve në Hamburg, në shtator të vitit 1902, ku ai mbajti latinisht kumtesën: «*Mbi shqiptimin e qielzoreve ndër dialetet e ndryshme të gjuhës shqipe*».

Suksesi i Mjedjes qe i plotë. Atë e vlerësuan albanologë të shquar të kohës e midis tyre edhe Pederseni.¹⁾

Por aktiviteti i Mjedjes nuk mund të shihet vetëm në planin e studimit të gjuhës shqipe. Ai nuk rreshti së shkruari poezi, copa leximi, nuk rreshti së luftuari politikën osmane e së mbrojturi interesat e aspiratat e popullit të vet. Të kësaj periudhe janë shpërthimet e ndjenjave të tij poetike kundër mbylljes së shkollës shqipe në Korçë, bastisjes së saj e të shtëpisë së drejtorit të shkollës, Nuçi Naçit, më 24 qershor të vitit 1902 (Vjershat «Bashkonju», «Për një shkollë shqipe mbyllun prej qeverisë otomane» (Korçë 1902). Këto poezi ishin në vazhdën e krijimeve të poezisë së fuqishme programatike, patriotike të Mjedjes. Iшин pjesë e gjithë veprimtarisë së tij, siç qe edhe hartimi i thirrjes që malësorët e Nenshatit, Mirditës, i dërgonin konsullatës në Shkodër kundër qeverisë osmane. Të gjitha këto sollën në natën e 11 tetorit të vitit 1902, arrestimin e poetit, Qeveria Osmane kërkoi ta internonte në Çanakala, por jehona e arrestimit të Mjedjes zgjoi ndjenjën e kryengritjes së popullit, sidomos të malësorëve të krahanës së Mirditës. Vala e protestave e detyroi Portën, që u ruhej në këto momente trazirave, të tërhoqte urdhrin e arrestimit të Mjedjes dhe ai lirohet.

Në periudhën 1904-1908 aktiviteti i Mjedjes lidhet ngushtë me atë të Xanonit në botimin e teksteve për shkollën shqipe, që u titulluan «Këndime për shkollë të parë të Shqypnisë» në tri vëllime, të cilat u ribotuan disa herë. Këto tekste ata i kishin ndërtuar mbi baza shkençore-pedagogjike, duke futur aty njoħuri të domosdoshme, parë nga një kënd i thellë patriotik. Shkallëzimi i njoħurive eshtë bërë me kujdes, mbi kritere shkençore pe-

1) R. Idrizi, vepër e cituar; M. Gurakuqi, «Vepër e cituar; J. Kastrati, «Gjuha, letërsia dhe historia në shkollë», nr. 4, Tiranë, 1966.

dagogjike, duke iu nënshtuar një programi të caktuar, sipas moshës së tëmijëve. Ata krijuan një lidhje organike të temave, duke rucjtur psikologjinë e çdo moshe, karakterin didaktiko-pedagogjik dhe kërkesat politike e shoqërore të kohës.

Një vend të dukshëm në këto tekste zë dhe poezia për tëmijë. Së bashku me Xanonin ai e kreu censhëm këtë detyrë fisnike.

Sot studiuesit e kanë të vështirë të përcaktojnë saktësisht se çfarë i takon njërit ose tjetrit autor në atë tekst shkollor.

Në këtë krijimtari Mqedja realizoi ëndrrën e rinisë për të qenë mësues. Këto poezi e proza dallohen për gjuhën e bukur, qartësinë e idesë, fabulës, moralit, për atë psikologji shpirtërore fëmijërore.

Aty derdhen njohuri praktike, tema morale të sjeiljes, të dashurisë për atdheun, për prindërit, për punën, të dashurisë për natyrën, aty theksohen veset dhe dëmi i tyre.

Rilindësit kontribuan të gjithë për zhvillimin e letërsisë për fëmijë. Krahas veprave të Naimit, «Gjahut të malësorëve» të Kristoforidhit, deri poezitë e thjeshta e peizazhike të Asdrenit renditen edhe veprat e Mqedjes dhe Xanonit.

Por veprimtaria e Mqedjes nuk mbërthehet vetëm në fushën pedagogjike e gjuhësore. Njihen historikisht çastet e vështira që po kalonte atdheu. Në qerthullin e trazirave të mëdha botërore, kur Evropa plakë kërkon ta kthejë Ballkanin në koloni e vatër baruti, kur konflikti turko-ballkanik prek drejtpërsëdrejti interesat e këtyre shteteve, të cilat nuk pushojnë së fabrikuari intriga, në truallin shqiptar ka shpërthyer lëvizja çlirimtare, e cila kishte marrë një karakter më të organizuar. Mqedja ishte në korient të gjitha ngjarjeve të kohës dhe do të angazhohet në lëvizjet që do të shpërthejnë në Mirditë e në Malësitë e Mbi-Shkodrës.

Ai nga 17.III.1905 deri më 15.III.1906 jetoi në Dajç dhe pas kësaj kaloi në Kukël, ku ndenji mbi 24 vjet. Kukli është lidhur ngushtë me jetën e Mqedjes. Aty

Mqedja do të vazhdojë të jetë propagandues, përkrahës i lëvizjes për liri e pavarësi. Më 1908 thirret Kongresi i Manastirit, ku do të marrë pjesë edhe Mqedja. Gjatë kësaj kohe ai ka nxjerrë gazetën «Dashamiri», e cila që në numrin e parë të saj, më 14.XI.1907, ndonëse e varfér, mundohet të trajtojë çështje imediate të kohës, kryesisht ato të gjuhës. Siç shihet, Mqedja nuk hesht përasnjë çast, pavarësisht nga vështirësitet e sulmet që i bëhen. Edhe në Kongresin e Manastirit ai dha kontributin e tij.

Ai do të vijojë punën e tij shkencore në Kukël, do të shkruajë poezi në gjirin e asaj mase fshatare dhe do të jetë biri i tyre i dashur. Si një personalitet patriotik i kohës, i njohur si kryengritjenxitës do të përkrahë lëvizjen e Mirditës dhe në Malësi të Mbi-Shkodrës në vitet 1911, do të mbrojë një vit më vonë popullin e paarmatosur, gra dhe fëmijë, pleq e plaka të Kuklit nga sulmet serbo-malazeze, duke u gjakosur vetë, duke qenë në rrezik vdekjeje dhe ashtu, pasi kryen detyrën patriotike, niset drejt Shkodrës ku qëndron në gji të popullit për të mjekuar luftëtarët e plagosur nga shovinistët serbo-malazez. Të njëjtin veprim patriotik do të kryente Ndre Mqedja edhe më 1915, kur përsëri serbo-malazeztë shkelën Shkodrën. E tillë është e tërëjeta e Mqedjes: e shkrirë në vuajtjet e popullit. Nga të gjitha këto trazira, poezia, arti dhe kultura shqiptare pësoi një humbje, sepse u dogj qela e Kuklit dhe bashkë me të një pjesë e mirë e dorëshkrimeve të Mqedjes. Dhe kjo është goditja e dytë e krijimtarisë, po të kemi parasysh arrestimin më 1902 nga pushtuesit osmanë, kur atij iu bastis shtëpia.

Në turbullirat e Luftës së Parë Botërore, Ndre Mqedja thirret në Shkodër si anëtar i Komisisë Letrare Shqipe, që krijohet në vitin 1916. Qëllimi i saj ishte krijimi i një gjuhe zyrtare. Kontributi i Mqedjes edhe këtu nijhet mirë. Që në fillim atë e emërojnë mis vepruar të Komisisë me rrögë.

Në këtë periudhë, në vitin 1917, ai mundi, pas shumë përpjekjesh, të botojë vëllimin me poezi «Juvenilja», që përmblëdh 14 vjersha origjinale dhe tri poema, me rreth

79 faqe. Në atë kohë për të u fol si për një libërth të zashkonshëm që ka për subjekt një «prendverë lulesh» e që u shërben vetëm nxënësve. Kështu e recensionoi më 1917 organi „Posta e Shqypnisë“ veprën e Mqedjes. Është një qëndrim i një rryme të tërë klerikale, rrënjet e së cilës duhen parë në Vatikan, prej ku gjithmonë sulmoheshin ata poetë, që me zërin e tyre poetik bartin shpirtin, vruilllet dhe tensionet dramatike të popullit, të kombit. Ata nuk deshën të pohonin në krijimtarinë poetike të Mqedjes shpirtin e tij patriotik dhe talentin poetik. Ky „vlerësim“ e më shumë heshtja për krijimtarinë e tij poetike më të mirë do ta shoqërojë atë deri në pragun e vdekjes. Gjatë kësaj periudhe ai do të botojë «Lissus» (1921) në shtypin periodik e më vonë si libër të veçantë më 1928, vjershën «Shypes Arbnore» më 1922, në gazeten «Elbasani», më 1928 ribotoi «Juveniljen» dhe po në dhjetëvjeçarin 1920-1930 ribotohen librat shkollorë e një seri përkthimesh fetare, që paraqesin interes gjuhësor. Në këto periudha ai merret kryesisht me studimin e shkrimitarëve të vjetër Buzukun, Budin, Bogdanin, dhe vazhdon të kontribuojë kështu në lëmin e gramatikës, të leksiokografisë (hartimit të fjalorëve) e të toponomastikës. Dhe këtë kuadër në periudhën e viteve 20 e plotëson edhe aktiviteti i tij i gjerë politik.

Shqipëria po kalonte ngjarje të tilla, nga të cilat varej fati i saj. Mbrotja e territorit shqiptar dhe organizimi e administrimi i jetës së vendit ishin çështjet e ditës. Forcat demokratike tashmë qëndronin ballë për ballë me forcat reaksionare me Ahmet Zogun në krye. Pranë këtyre të fundit shtetet fqinje dhe fuqitë e mëdha mundoheshin të luanin politikën e tyre pushtuese e copëtuese. Mqedja, si antifeudal e demokrat, bënte pjesë në krahun e opozitës dhe ishte deputet i Shkodrës dhe i Kosovës. Ai e ruajti këtë funksion që nga viti 1920 e deri më 1924. Me ardhjen në fuqi të Zogut, pas dështimit të Revolucionit Demokratik-Borgjez, Mqedja s'pranoi më të shkelte në parlament. Si deputet, ai u shqua për pikëpamjet e tij demokratike, si mbrojtës i interesave të popullit, si armik i betuar i bejlerëve, i kriminelëve, i Ahmet Zogut

e përkrahesve të tij. Në fjalimet e tij në parlament ai trajtoi probleme të ndryshme: kërkoi të merreshin masa që populli mos vuante nga uria, ngriti zërin kundër masakrave të shovinistëve serbë në Kosovë, demaskoi politikën mashtruese të diplomatëve të Lidhjes së Kombave etj. Kur u vra Avni Rustemi nga dora gjakatare, vegël e verbër e Ahmet Zogut, ai ishte nga të parët akuzues të satrapit Zog e nga ata të parë që firmuan telegramin e Protestës kundër këtij krimi. Po kështu, protestues e akuzues ndaj Zogut, gjendet firma e tij dhe në telegramin e protestës kundër veprimeve kriminale të Muhamet Bajraktarit, i cili, si qarkkomandant i Krumës, sulmon Bajram Currin. Njihet mirë polemika e ndezur në parlament për të mbrojtur trimin, «div-dragoin e Dragobisë», që kryeministri A. Zogu e quajti tradhtar dhe e nxori jashtë ligjit! Mqedja ishte dhe ai një nga kundërshtarët e Zogut e mbrojtësi i Bajram Currit.¹⁾ Po ashtu, ai nuk reshti së qeni mbrojtësi i fshatarëve të varfër, i popullit të vet, bir i të cilit ishte.²⁾

Peripecitë e ndjekin dhe ato nuk do të pushojnë edhe atëherë kur ai, si rrjedhim i nevojave të mëdha që kishte gjimnazi jezuit për arsimtarë, në moshën 64 vjeçare, emërohet si profesor në këtë kolegji, ku do të jepte mësimin e gjuhës dhe letërsisë shqipe si dhe letërsinë e huaj.

Nxënësit kanë tanë pranë mësuesin dhe poetin patriot. Në kujtimet e tyre ata shprehen për të me dashuri, duke theksuar se te ai ndien gjithnjë poetin patriot e demokrat, studiuesin e mësuesin korrekt. I thjeshtë e i dashur, energjik dhe gjithnjë i ri në shpirt, ai i ushqeu nxënësit me kulturën klasike e moderne, por mbi të gjitha me atë kombëtare. Më 1 gusht të vitit 1937 Ndre Mqedja vdiq nga një atak në zemër. Kundër rregullit të Urdhrit, i cili pohonte se «ligji jezuit asht i përvujtë e nuk don pompozitet», kundër dëshirës së qeverisë së Zogut, që donte ta kalonte heshturazi varrmin e tij, rinia shkollore e studenteske, mbarë populli i Shkodrës, kërkoi që poeti

1) Bisedime Kombëtare, Viti III, 1923, Nr. 56, f. 945

2) " " " " Nr. 65, f. 1135

të nderohej. Zëri i fuqishëm i rinisë i tronditi të gjithë. Edhe në varrim *Rinia* dhe Poeti ishin fare pranë. *Rinia* mbante në duar kurorat:

„Poetit atdhetar — „Djelmënia“. Universitarët kurorën „Universitarët — Mësuesit të vet“.

* * *

Jeta e Ndre Mqedjes, e këtij prifti shekullar patriot, në gjirin e një periudhe shumë të rëndësishme historike, pranë një morie patriotësh e krijuarish, ka qenë objekt diskutimi i pafund, pro e kundër, një polemikë ku një mori artikuqsh mbartin pohime nga më të ndryshmet. Vetëm pas çlirimt, vepra e tij u vlerësua siç duhet. Shoku Enver Hoxha për të ka thënë «Klerikët katolikë popullorë, që e kanë dashur popullin dëshiron që i kanë shërbyer këtij, siç kanë qenë Dom Ndre Mqedja e të tjerë, kanë qenë neveritir, dënuar dhe persekuuar nga Vatikani dhe agjentët e tij.»¹⁾

Me veprën e Mqedjes u mor poeti i ri i asaj kohe Lazar Siliqi, që përbledhjen e vjershave të poetit e pajisi me një parathënie studimore. Ky vëllim i vogël, aë titullohet «Vjersha dhe poema» (1953), është i pari botim serioz për këtë poet. Më pas, në vitin 1964 studiuesi Mark Gurakuqi botoi një vëllim më të plotë «Juvenilia», të pajisur me një studim të gjerë dhe në vitet 80 iu botua vepra me titull: «Vepra poetike e Ndre Mqedës». Nië varg studiuesish më në zë të letërsisë shqipe, si prof. Dhimitër Shuteriqi, prof. Jup Kastrati, prof. Vehbi Bala, historiani Injac Zamputi, prof. Rexhep Qosja, studiuesi Sabri Hamiti, Kolë Ashta, Razi Brahimë etj. e bënë këtë poet të shquar të Rilindjes objekt të studimeve të tyre dhe evidentuan vlera të reja ideo-artistike dhe pasuruan njojuritë për veprimtarinë e tij.

1) E. Hoxha, Vepra, Vell. 6, f. 208.

* * *

Në kulturën dhe trashëgiminë poetike të letërsisë sonë Ndre Mjedja është pa dyshim një poet i madh, i fuqishëm, një zë i rëndësishëm i kohës së vet. Ai jetoi në dy periudha historike: në Rilindje dhe në Pavarësi. Përmbajtja e poezeve dhe impenjimi krijues poetik i tij i përket periudhës së Rilindjes, ndërsa angazhimi i tij për studimin e gjuhës shqipe si dhe pasioni drejt gjurmimeve e njoftimeve arkeologjike do t'u përkasë të dy periudhave.

Poliglot, njohës i thellë i latinishtes e i greqishtes së vjetër, studioi mitologjinë e krijimtarinë gojore të popujve më me traditë, pa u shkëputur për asnjë çast nga studimi i thellë i folklorit shqiptar në tërë aspektet e tij. I pajisur me një kulturë të gjerë në shkencat humane, i dhënë shumë pas studimit të shkencave ekzakte, ai mbetet në gjirin e letërsisë dhe të kulturës shqiptare, figurë, erudicioni i së cilës është derdhur edhe në përbajtjen e krijimeve poetike, kryesisht të poemave, edhe në studimet e ndryshme. E gjithë vepra e tij karakterizohet nga një pasuri idesh, të rëndësishme patriotike e demokratike, nga një skrupulozitet për realizimin ideo-artistik, nga një saktësi e madhe mendimi dhe nga një kulturë e thellë.

Dihet se e vërteta e madhe e një krijimi artistik është mbërthyer në të vërtetat e mëdha të kohës, të psikologjisë së një kombi, prandaj shfrimi poetik mjedjan u kthye në një poezi të fuqishme. Portreti i tij si njeri dhe si poet, mund të zbërthehet vetëm në lidhjet e tij të ngushta me interesat e atdheut, me ngjarjet historike e momentet politike, të cilave ai iu përgjigj me tendençizitet.

Mjedja e ka ndjekur kohën e vet në çdo hap, prandaj dhe përbajtja e tërë krijimtarisë së tij është programtike. Duke u ndalur në të kaluarën dhe në të tashmen historike, ai, si ideologët e poetët e shquar patriotë, solli në krijimtari shqetësimin e rilindësve për liri, pavarësi për të mësuarit e të përhapurit e gjuhës shqipe. Ai evidentoi aspiratat, karakterin, interesat, shpirtin e popu-

llit dhe nënvizoi elementët e rëndësishëm që ka një komb, një popull: Liri, Atdhe, Tokë, Nënë.

Shqiptarin ai e pa punëtor dhe trim, të mençur dhe të durueshëm, luftëtar të rreptë dhe të paepur, njerëzor dhe besëmadh, adhurues deri në flijim të tokës mëmë, fisnik në dashuri e nderues deri në shenjtëri të familjes.

Të gjitha këto e bënë poezinë mjedjane të derdhet nga mbresëvëzhgimet historike në përfytyrimet historiko-politike të së ardhmes, nga ngacmimet dhe shqetësimet shoqërore në trajtëme dhe vështrime filozofike-sociale e psikologjike, nga intimja e hidhur, munduese në të përgjithshmen optimiste shpërthyese, nga dhimbja e melankolia subjektive në çlirim e buzëqeshjes së fshehur e të vrulleve të fashitura. Pra, në krijimtarinë poetike mjedjane nuk është vështirë të vërehet tensioni filozofik poetik, i cili e ka burimin në vetë formimin shpirtëror-kultitor të Mqedjes dhe në prirjen politike ndaj çështjeve patriotike-shoqërore-filozofike («Vaiji i bylbylit», «Lissus», «Scodra», «Andrra e jetës» dhe lirikat).

Tematika e gjithë poesisë së tij ka një fokus të fuqishëm – Atdheun. Që në shpërthimet e para lirike ai është poeti kryengritës, rebeli romantik i lirisë individuale e shoqërore, individi aë proteston dhe që i kundërvihet realitetit ku jetonte dhe ku punonte. Pesa e mërgimit, drama e ijetës së myllur të shkollave fetare katolike, plot net të shqetësuara, malli i pafund për atdheun, përi nënën, për atë grua të vuaitur, të rropatur, vëtmia e tij trazimet e dialogët e mëdheni shpirtërorë, idetë dhe ëndrrat rimore u shkrinë me rënkimet e popullit të tij dhe ii derdhën në varacie, krveideja e të cilave ishte: aiithçka për atdheun. Në kriimet e tij është romantik kur e shaetësojnë shpërthimet lirike nostalgjike e dhembiemëdha («I mbetuni», «Shteqtari», «Andërr», «Shqynes arb-nore», «Violca» etj.), është klasik dhe i thellë, kur siell erudicionin e gjerë dhe ka të bëjë me zigzaqet e kohëve prehistorike e historike të lashta, me mitet, legjendat (poemat: «Lissus», «Scodra»), është filozof dhe artist i emocioneve të fuqishme në interpretimin psikologjik të

ndjenjave («Andrra e jetës»), është piktor i përsosur i peizazhit, artist i vargut dhe i figurës.

Periudhën kur rron frysëzimi i tij poetik e jep me një lajmëmotiv: «Bashkoniu». Ai është këngëtari i luftëtarëve të lirisë, është grishësi i tyre, është satirizues e akuzues për këdo që prek atdheun.

Lirika e Mqedjes mbart në motivin romantik një gërshtim të rëndësishëm dhe fort për zemër. **Nëna** dhe

Atdheu, që vërehet, në të gjithë poezinë e vendlindjes dhe është karakteristikë për shumë poetë të romantizmit. Këtë temë letërsia jonë e Rilindjes e ka trajtuar me originalitet, të lidhur ngushtë me kërkesat e idealet e atdheut. Ndaj në këto lirika dhimbja dhe malli zgjojnë betimin, zgjojnë shpresën, veprimin dhe jo pritjen. Duke mbartur edhe një revoltë të fuqishme lirikat si „Andërr“, „Malli për atdhe“, „Mikut tem Pol Moretit“, „Mikut P. Moreti“, „Në dek të shoqit tim Gj. S.“, „Nji shoqit që kthehet në Shqipni“ etj., fiksojnë kështu edhe *al`valitetin* e kohës.

Kohën e vet ai e ka parë të lidhur ngushtë me të kaluarën, sidomos me poemat «Lissus» e «Scodra». Në këtë theks historik ai përcakton poetikisht tiparet e këtij populli, që e bëjnë atë të fuqishëm, punëtor dhe armëmbajtës. Jeta e tij ka qenë e begatshme me kulturë dhe dije. Armët e mbrojnë atë, i sigurojnë lirinë dhe paqen. Në këto poema vështrohen damarët e kombit, ku rrjedh gjaku i pashtershëm i tokës mëmë ku lavdia dhe krenaria kanë një kurorë, heroizmin, ku mençuria dhe veprimi kanë një domethënje, bashkimin. Historia në veprën e Mqedjes i shërben thellësisht kohës kur ai jetonte. Lashtësia shqiptare, e cila është bërë tashmë vjetvetja, ia thithin shpirtin poetit. Mitet, legjendat, historia dhe koha e tij jetojnë të lidhura në vjershat e poemat. Për Mqedjen lashtësia, figura dhe periudha e Skënderbeut është treva e shqetësimeve të mëdha, që e mbëstolli atë në gjirin e vet dhe i përpunoi ndjenjën, mendimin, e ushqeu atë shpirtërisht dhe e bëri zë të fuqishëm të kohës.

Prandaj dhe nuk është e rastit të shohësh në lirika

që flasin për gjuhën shqipe, bashkimin e popullit shqiptar («Gjuha shqype», «Bashkoniu», «Për një shkollë shqypë...», lavdinë e dikurshme, të ndiesh revoltën, satirën shpërthimin për kryengritje. Mjedja, si të gjithë rilindësit, e rroku gjuhën si element të fuqishëm shpirtëror të kombit dhe iu përkushtua asaj. Vetë ideali i Lirisë jeton në idenë e madhe të Bashkimit, ku gjuha është një element bazë. Himni për gjuhën shqipe është kthyer në një armë luftarake të fuqishme kundër gjithë rreziqeve të invadimit e të synimeve grabitqare pushtuese. Lidhur ngushëtë me historinë e këtij kombi ai ka theksuar në këto lirika se tiranët janë munduar gjithmonë që ta vrasin gjuhën e kombit për të vrarë popullin, porse duhej t'i mësoje atij të hiqte armët, që të mund ta bëje atë të harronte gjuhën, duhej të hiqje atij fushat, malet, lumënjtë, diellin e vendit të tij, që ta bëje atë të harronte gjuhën, duhej më në fund që t'i ndërroje atij gjakun, ta bëje atë memec e të shurdhër që të mund të zhdukje gjuhën e tij dhe ta sundojë atë.

Mbrojtës i flaktë i lirisë, poeti gjithmonë vë në qendër të krijimtarisë së tij popullin, këtë forcë të madhe patriotike dhe heroike, të vetmin mbrojtës të atdheut, duke ia kundërvënë elementeve reaksionarë, feudalëve, tradhtarëve. Kështu u bë ai edhe kryengritës antifeudal te «Liria», dhe «Mustaf pasha». Si himn i një shpirti liridashës, në këto lirika shprehen èndrrat e dëshirat e poetit për një Shqipëri të lirë, të gjuar e të drejtuar prej shqiptarësh. Ato përbëjnë testamente të ndjenjave patriotike e të energjisë krijuese mjedjane.

Shpirti i thellë i poetit arriti të analizonte me mprehtësi kohën. I pajisur me intuitë të mprehtë politike e shoqërore, ai di të dallojë mirë përbërjen e forcave lëvizëse të kohës. Lirika «Liria», duke u ngritur mbi fakte historike, mbi lidhjen e fortë midis së kaluarës me të tashmen, duke u futur në psikologjinë e kombit, mbërthehet fuqishëm në idenë «Liria mbi gjithçka». Kurse në figurën e Mahmud pashës, lirika motivon thirrjen: të gjithë në luftë, në dallim nga lirika «Mustafa pasha në Babunë», që është satira dhe urrejtja, mallkimi dhe dënim i tradhtisë nga i tërë kombi.

Mqedja, ky poet i hëistorisë dhe i vitalitetit të popullit të vet e dha jetën e njerëzve të thjeshtë edhe përmes një trajtimi filozofik. Poema «Andrra e jetës» ka si lëndë jetën me konkreten e të veçantën e saj, me idealen dhe imaginaren, me lindjen dhe vdekjen e elementeve të saj, me vazhdimësinë e saj, me atë që quhet pavdekshmëri apo dialektikë e jetës. Në këtë shtrirje është nënvizuar e zakonshmja dhe e mrekullueshmja, e rëndonita dhe e madhërishmja, e keqja, dhe e mira, e bukura tek individi dhe te natyra, ritmika, harmonia e vetë jetës ideja iluministe për ta gjuar jetën këtu mbi dhë. Ai ngrihet mbi të rëndomtën, nuk mbetet te momenti, e motivon pasionin në funksion të arsyes, e sundon të tashmen në funksion të së ardhmes, pra e koncepton jetën në mënyrë materialiste. Prandaj vepra e tij është përparimtare, tendencioze dhe ai mbetet përfaqësues i romantizmit përparimtar.

Gjithë kjo rrrokje e jetës shqiptare, e kohës së tij, e së kaluarës së lavdishme të këtij kombi ka folur përmes një figure artistike sa origjinale aq dhe të fuqishme, që na sjell përpara nesh vetë botën. Dhe të gjitha këto varen prej forcës së shprehjes së ideve në konceptimin poetik dhe në figurën letrare.

Subjekti dhe figura artistike mqedjane nuk janë përpjekje letrareske, por një trupëzim i një ideali patriotik revolucionar hovçues në fryshtë e lirikës. Ndjaja e tij dhe koha janë vazhdimisht në dialog. Te Mqedja subjekti dhe figura artistike lidhen ngushtë me idealin patriotik, me problemet politike të kohës.

Mjeshtër i simbolikës, i portretit dhe i polemikës, stilist i censhëm, zot i gdhendjes së karaktereve, peizazhit dhe shpirtëzues i natyrës deri në imtësi që hasen në të përditshmen e të zakonshmen, Mqedja, krahas mallit e dashurisë për historinë e lavdishme të popullit shqiptar, solli në poezi atë patriotizëm kushtruar, akuzues dhe anti-feudal, ku zuri vend zbërthimi filozofik, shoqëror e psikologjik i individit, familjes, kombit.

Ai e zbërtheu idenë artistikisht, duke e kthjelluar e thelluar figurën artistike. Dhe kjo duket që në krijmet

e tij të para, që me poemthin «Vajin e bylbylit», ku shtrirja poetike tigurative i ngjan dialogut me nëntekste psikologjike-autobiografike sa akuzuese, aq edhe optimiste, sa rrëtimtare, aq edhe sintetizuese. Në këtë poemth kemi ndeshjen me një realitet të caktuar, që e ka bërë unin poetik të luttojë me vveteten dhe me mjedisin. Në këtë dialog me vveteten, i cili në fakt është monologu i tërë dhembjeve dhe vuajtjeve të tij, Mqedja zërthen në një mjedis të huaj ëndrrën, pikësynimin, përkushtimin dhe së tundi shpresën. Vvetetja është çliruar poetikisht përmes figurës simbolike të bilbilit, që është një thelb i kredos poetike, pohim i shfimeve të papërmbajtura poetike, që do ta ndiejmë në çdo krijim të tij. Nga kjo pikëpamje poemthi «Vaji i bylbylit» i është nënshtuar një rregulli klasik, që kushtëzohet nga natyra krijuese e poetit.

Realiteti e ka përfshirë atë në tërë momentet e frymëmarrjes poetike, ia ka shqetësuar e ushqyer shpirtin, e ka bërë të vrullshëm, hidhnak, satirik, luftëtar e ekzekutues, i ka dhënë krahët e lirikut dhe e ka mbësh-tjellë me dashurinë për njeriun dhe vendin. Krijimet: «I tretuni», «Andrra e jetës», «Vorri i Skanderbeut», «Mahmut pasha», «Mustafa pasha në Babunë», «Gjuha shqype», «Bashkoniu», «Mikut tem Pal Moreti», «Për një shkollë shqype mbyllë prej qeverisë otomane», poemat «Lissus», «Scodra», «Liria» etj. kanë në vvetete atë sintezë vitale shpirtërore, e cila duke evidentuar një realitet të caktuar historik, na bën edhe ne sot ta ndiejmë të gjallë këtë realitet. Ndihet pra, fuqishëm në poezinë e tij ai largim nga ëndërrimet pasive. Kështu lexuesi përfton atë jetë të brendshme të poetit të formuar e të rritur në një realitet të caktuar historik, të shkrirë në shpërthimet poetike të ndjenjave dhe të dëshirave, të ideve dhe qëlli-meve të tij, ndryshimet e mëdha të të cilit sjellin jo rrallë heshtjen poetike. Ja pse poezia romantike, përparrimtare e demokratike e Mqedjes është një poezi patriotike, luf-tarake, tendencioze, me mjaft probleme sociale e filo-zofike. Mqedja i botoi vonë veprat e tij, por pavarësisht nga koha e botimit ai mbetet poeti i Rilindjes Kombë-tare, i ushqyer në ngjarjet dhe problemet e saj.

Duke ndjekur ecurinë poetike mjedjane vërejmë qartë se ai tensionohet vazhaimisht në krijime për ta atëne sa më të arrirë idenë që lidhet ngushtë me konen e vet. Në krijimet poetike ai derdh energjinë e tij shpirtërlore, kthjellon gjykimin artistik të tij, përcaktion vërveten mbi tisionominë kohore, lidhet mirë me elementet historike. Këto tipare dallohen që në «Vajin e bylbylit», ku realiteti vepron drejtpërdrejt në ndjenjat dhe në ndërgjegjen e artistit dhe lexuesi tutet në to, komunikon menjenerë me fenomenet dhe me vetë artistin.

Poemthi ka një kredo: «Fillo me gëzue», kredo e poetit kjo e cila vihet re në krejt krijimtarinë poetike mjedjane dhe lidhet me çlirimin e vërvetes dhe me luttën për një atdhe të lirë.

Prandaj në poemth nuk shohim thjesht poetin e munduar më pas të çliruar, dhe as edhe një fakt biografik, por vërejmë një akuzë për të gjithë ata që shtypin, grabisin dhe kënaqin tekat e tyre të pushtetshme në të gjitha fushat. Në këngën e fundit shpërthen shpirti kryengritës, i paepur me vargjet:

Shpend tjerë burgosi sa herë mizori
E rishtas jashta dikur i nxori
Ndër fushë e male janë tui flutruar
Fillo me gëzue.

Bylbyl, ky shekull orë e ças ndrrohet,
Bijnë poshtë të naqtit, i vogli çohet
Edhe natyra po don m'u ndrrue
Fillo me gëzue.

Pra poema merr një shtrirje më të gjerë problematike – politike, ku tingëllon i fuqishëm mendimi demokratik.

Kjo kthesë shpirtërore në ide shoqërohet mirë e bukur dhe në formë. Në kalimin nga strofat katërshe 5,7 e 8-rrokëshe, mendimi bartet në 10-rrokëshin që pushon me një 5-rrokësh kredo allegro.

Në krijimtarinë e Mqedjes spikat larmia e formës artistike, që shoqëron vërshimin e tij poetik, të ngjizur në atë lidhje të ngushtë të individit të shqetësuar brenda një realiteti të caktuar. Ndaj themi se origjinaliteti

krijues i Mqedjes ka sjellë një hop cilësor në gjirin e poezisë shqipe. Ky poet diti t'i përligjë me art dhe fuqishëm mendimet dhe ndjenjat, përndryshe do të nijnim në veprën e tij vetëm teknikë e ftohtësi dhe aspak shpirt krijues. I tillë është ai edhe në përkthimet ku vërehet më tepër krijuesi se përkthyesi.

Poezia e tij rritet në rrjedhë të viteve në ide, në përbajtje dhe në formë.

Kështu, ndërsa Mqedja te «Vaji i bylbylit vajton fatin e vet, fat i përgjasur më së fundi me fatin e atdheut, në shumë poezi të tjera ai do të jetë poeti i mallit të thellë e të pafund pér atdheun, përpara të cilit gjithçka bierret. Dialogu poetik ka një shfirim krenarie: «Si gjyshërit kërkoni lirinë». Shpirti rebel i poetit do të shpërthejë me forcë në çdo tingull si kushtrim, në çdo bisedë poetike si e vërteta e kohës.

Është pér të vënë re te Mqedja se si mjeshtëri i përshkrimit historik ai kulmon motivet më energjike të kombit dhe ndalet pastaj në më të njojurën, më konkreten, më të historizuarën e të përfuarën në art, në figurën e Skënderbeut.

Poemat historike «Lissus» dhe «Scodra» janë sinteza të atyre shpërthimeve shpirtërore të poetit që, të dhëna në sonete, kanë së jashtmi *ngjyrimin antik*, por të shtjelluara në bazë të idesë nxitëse pér zgjim, e kthejnë lashtësinë në shërbim të kohës kur jeton poeti, pra i shërbejnë në tërësi zgjimit të ndërgjegjies kombëtare.

Në këto poema Mqedja mendon thellë, krijon harmoninë ritmike e jep pëershkrime plot ngjyra me një strukturë të paracaktuar me tendenciozitet patriotik. Romantizmi këtu bart një frymë historike, që strukturalizohet nën kërkosat e kohës, kur merr e jep poeti.

«Lissus» mban përgjegjësinë e atij pasqyrimi që përblidhet në idenë krenari kombëtare, sepse liria, begatia, mbrojtja e tokës nga armiqëtë, e kanë mishërimin e tyre në shpirtin, mendjen e popullit.

Ideja zhvillohet duke u nisur nga peizazhi i atdheut, trimëria ilire, kushtrimi pér luftë dhe zgjerohet me sakrififikat e flijimit pér atdheun, duke përfunduar me qëndre-

sën dhe krenarinë kombëtare. Kështu soneti mqedjan është rrëfim artistik me një formë klasike, ku në çdo strofë gjen një përfundim poetik.

Poema «Scodra» ka një tjetër përceptim ideo-artistik. Veprimi, në sonetet e kësaj poeme, kalon nga pasthirrat emocionale plot tablo madhështie e veprimi, në kënaqësitetë dhe lumturinë e kamjes, të dwersës, mundit të një populli punëtor e paqedashës (soneti II), Ndërsa në sonetin e dytë dëshmohet trimëria e patriotizmi në mbrojtje të trojeve të atdheut. Duke gërshtuar historinë me mitologjinë, poeti na sjell dialogun epik të botës së lashtë, ku populli është forca e forcave dhe zoti i zotave.

Kështu, ndërsa dy sonetet e para përbajnjë bukurinë dhe paqen, popullin që di t'i mbrojë pasuritë e veta, punën e vet, te soneti i tretë, përmes një tregimi analistik, jepen frytet e punës së një populli autokton, forca e njerëzve si transformues të natyrës së vendit të tyre. Tabloja mbushet me këngën, melodinë e fyellit, karakteristikë e improvizimit të shpirtit artistik të këtij populli. Kjo tablo është në unitet me tërë mjeshterin e gjallë e të begatshëm, me kënaqësinë e këtyre njerëzve. Në këtë tërësi poetike për të mbajtur masën e këtij kulmimi poetik, poeti sjell një motiv po të atij mjeshter, nga më të veçantët, gjarprin, duke i atribuar këtij mahnitjen nga bukuritë e këtij vendi, ngajeta e këtij populli, pra e çon këtë gjallesë-simboli deri në tjetësim të vvetes. Mjeshtër i figurës, i tablove, gdhendës emocional i portreteve mitike, evidentues i mprehtë i detaieve jetësore, krijuar i fjalës poetike plot nerv, Miedja nxjerr prej mjeshterit baritor ato elemente, ku me lirizmin e tij poetik ushqen mrekullisht tablotë e sonetit, vetë idenë ku figura bëhet krejtësisht funksionale. Miedja është i dehur nga toka amfare dhe rron në çdo varg me emocionet e sai. Poema ka spontaneitet e frivlezim. Asociacioni i këtij frymëzimi ka sjellë edhe një nerv trishtues e të shaftësuar. Miedja edhe në këtë poemë gien vend të akuzoië pushtuesit. aë lakmojnë pasuritë. begatitë, vlerat, e këtij vendi. Iliria, pra Shaipëria, si nië vend i pasur e stratejik, ka ngrallur lakminë e të tjerëve. Në sonetin e katërt, duke nënvi-

zuar smirën, poeti nënvizon interesat e të huajve për vendin tone. Por nderkaq themson se populli ynë kurre nuk ka qenë agresiv. Ai ka dashur paqen, rrojtjen e llore në trojet e veta. Në sonetet e tjera poeti e jep arritikun nëpermjet kuçedrës, simbol i së keqes në përrallën shqiptare dhe po aty jep historinë tragjike dhe luttën heroike të popullit tonë, që nuk e shkel gjakun e derdhur, por përkundrazi lind lurtëtarë të rinj. Betimin konkret për atdhe poeti e përdor si pedalje për veprimin e mëtejshëm, për mobilizimin, grishjen për luftë. Dhe malet ushtojnë.

Në poemë realja e mitologjikja lidhen me njëratjetrën. Beteja dhe fitorja, flujimi dhe vazhdimësia e sakriticave për atdhe, bashkimi dhe gatishmëria për të ndërtuar qytetin e kryeqytetin e ilirëve, e këtu Shkodrën, u flasin drejpërdrejt momenteve kur atdheu kërkon që bijtë e vet të luttojnë në mbrojtje të tij. Kjo ide jepet në sonetet IX, X, XI, ku nocionet aktuale historike lidhen me nocionet legjendare. Atdheu hidhet i téri në provën e sakrificës, të vetëmohimit. Mqedja e aktualizoi legjendën nëpërmjet motivit të sakrifikimit për atdheun. Figura artistike ka përfthuar në këtë poemë edhe hapësirën e tingujve. Aty sikur dëgjohen zhurmat dhe tronditjet e universit përmes bashkëtingëlloreve, zulmat e bëtejave përmes tingujve onomatopeikë, frushullues, ulëritës e shqetësues, dhe të duket se male e fusha e anekënd gjithësia po shqyhet nga kjo grindje njerëzish e perëndish (Soneti IV, V). Përmasat mitologjike zgjidhen me veprime ngjethëse, të përbindshme. Toka nën peshën e këtyre qenieve gjigante lëviz e shkundet. Gjithçka vlon si lava e vullkaneve. E tërë poema «Scodra» nderet mbi këtë përceptim, e prandaj larmia figurative e fjalës ka sjellë dhe përfytyrime e nuanca kuptimore të reja. Ajo është një krijim i thellë original, është poemë e sakriticave e flujimit, e fitores dhe e zhvillimit të vendit. Ajo është poema e krenarisë kombëtare, e historisë dhe e miteve, legjendave, e kohës së vet dhe e së ardhmes, e paqes dhe e mbrojtjes së saj. Mqedja nuk mund ta shkruante më atë. Rinia e poetit e zgjonte

dhe e përjetësonte Shkodrën. Poeti i moshuar, po të mundohej ta shkruante përsëri, do t'i zëvendësonte shpërthimet plot pasion me arsyetime, sepse fryshtimi nuk mund të përsëritet.

Rilindësit, pa përjashtim, e bënë Skënderbeun heroin kryesor të veprave të tyre, në të gjitha gjinitë. Emri i tij u shkrua e u dëgjua kudo, që nga memorandumet e tribunat diplomatike e deri te vjershat e librave të këndimit.

Mjeda depërtion në figurën e heroit gjithmonë përmes një perceptimi artistik origjinal, duke iu shmantur vizatimit drejtpërsëdrejtë të portretit. Vjershat «Vorri i Skënderbeut», «Shqypes arbënore» etj. sjellin Skënderbeun si element të fuqishëm të zgjimit dhe të bashkimit kombëshmëria, të shpërthimi i një akuzë. Përse nuk kafen armët e patriotik.

Te «Vorri i Skënderbeut» poeti sjell të tashmen e kohës së tij historike. Ai motivon një shpërthim të linshpërthimi i një përfundimtar. Dhe të shporret armiku?

Në dukje, i nisur nga një perceptim statik i figurës së Skënderbeut, ai shënon vlerat e këtij prijesi, e merr dhe e zbërthen në një plan shoqëror-psikologjik. Me figurën e Skënderbeut, me varrin e tij, poeti rrit thirrjen e qortimin. Ballafaqimi që poeti i bën kohës së vet me Skënderbeun tregon më në fund se për një ndërgjegje patriotike ai është shembull, është tempull vjershës po me të njëjtin titull, përfthimi i figurës së Skënderbeut jepet përmes shqypes arbore. Zbritja e saj nga hapësirat e malet e larta me borë të përhershme ka një motivim mitik, hyn në legjendë.

Nga betimi e flijimi përpara veprës dhe emrit të Skënderbeut, Mjedja kalon te Skënderbeu si fryshtues luttarak i ndërgjegjes kombëtare. Në lirikën «Bashkoniu» përmblidhen dy idetë e sipërme dhe përftohet himni i luftëtarëve të rreshtuar, që presin vetëm komandën për

t'u hedhur në luftë. Jo pa arsy, kjo ide është dhënë në formën e këngës, me vargje të prira për recitim, me kadencat e brendshme qëndrese e betimi, me thirrje luftëtarësh të sjellë në fushë të betejës, me monolog prijësash, që sqarojnë atmosferën kohore. Të Mqedja forma është një veshje materiale e idesë, në unitet me të dhe jo si diçka e jashtme, si mantel a si një cipë, e pra ajo është po aq origjinale e kombëtare sa dhe përbajtja e veprës së tij.

Duke iu kundërvënë realitetit obskurantist osman, shpirti poetik i Mqedjes i pasqyron me një fizionomi të re lëvizjet shqiptare, siç janë ato për dije, kulturë, përmësimin e gjuhës shqipe etj.

Në lirikën «Për nji shkollë shqype mbyllë prej qeverisë otomane» (Korçë, 1902), duke sjellë artistikisht forcën që thith një komb nga të njohurit e gjuhës së vet e të kulturës së tij kombëtare, njëkohësisht edhe demaskon vepërën kriminale, masakrat që bëhen nga osmanët kundër atyre që mësojnë gjuhën shqipe. Po këtu ai sjell gjithashtu figurën e Skënderbeut me tensionin e kryengritësit të rebeluar.

Poeti s'e duroi dot masakrimin e shkollës. Dënim i osmanillinx për këtë vepër është i katërciptë. Vendosia e ferishteve në qendër të poezisë është një gjetje artistike e realizuar mrekullisht. Ferishtja, fëmija në luftë me një perandori ka sa dramë, sa tragjicitet, aq edhe akuzë. Lirika merr notën e kryengritjes imediate dhe është konceptuar si një realitet ku lëvizja kombëtare në Shqipëri ka shpërthyer me forcë, me etje për fitore, ku në 'giirin e kryengritjeve jetojnë fatosat me kryefatosin, Skënderbeun. Artisti dha dramën e jetës dhe po aty thelbin tragjik të një Perandorie dhe të cdo shteti pushtues dë lufton për shkombëtarizimin e nië vendi. Po mbi një kënd shqetësimi të thellë krenarie kombëtare shfaat Mqedja edhe në lirikën: «Mikut tem Pal Moretit». Në letërsinë shqipe ky dialog poetësh është i nivisur, por te Mqedja ai është dhënë me një origjinalitet. Madhështia e atdheut, vlerat e tij shpirtërore, morale, peizazhike nënë vizohen konkretisht në portretet e Skënderbeut dhe të fa-

tosave të tjerë, duke i dhënë ata të mençur, të kulturuar dhe kryetrima e strategë në një atmosferë pagane.

Këtu s'kemi të bëjmë me një dehje romantike, por është dhembja dhe malli, është tronditja dhe revolta e patriotit pér atdheun e munduar, është krenaria e ligjshme e birit të thjeshtë të popullit të vet, që e shtrydh shpirtin dhe me gjak nënvizon dhimbjen dhe revoltën. Ky lajtmotiv grishës e tronditës, në lirikën tjetër «Mikut tem Pal Moretit» merr formën e një shpërthimi akuzues pér qëndrimin armiqësor të Evropës ndaj Shqipërisë si edhe pohimin se ishte kjo Evropë që, e frikësuar nga dyndjet osmane, britte «Rrnoftë Skanderbegu!» Mqedja e shpraz akuzën sa kundër intrigave diplomatike evropiane, aq edhe kundër rrebeshit e ngjarjeve në trevën ballkanike. Duke i dhënë shtetet evropiane si mbrojtëse të pushtuesit osman, ai i quan ato më kriminele dhe e paraqet drejt atdheun, përballë shumë zjarresh. Evropa e shpëtuar prej Gjergj Kastriotit është bërë armikja më e betuar e Shqipërisë. Me këtë demaskim poeti i pret rrugën çdo iluzioni pér Evropën lakmuese, imperialiste, mosmirënjoheše dhe hedh idenë e shtrëngimit të radhëve të luftëtarëve, të bashkimit, ide që shprehet me aq forcë edhe te poemthi «Liria» edhe në krijime të tjera të Mqedjes.

Shqipëria kishte nisur të tronditej nga kryengritjet ende të veçuara. Mqedja, pér të zgjuar edhe tek më i fundit shqiptar në ndërgjegjen kombëtare, e shkruajti poemën «Liria» me fryshtë e qortimit të ashpër dhe të kushtimit më të shpenguar, që jep edhe fryshtë kryengritëse të kohës. Figura e Skënderbeut këtu përfytyrohet si një hije perceptim si te lirika «Mikut tem Pal Moretit», por me një duke u ndalur te heronjtë e saj, arrin një theks tronditës emocionalo-psikologjik kur mbërthehet te Nëna, të cilën e sheh në kuadrin e tërë botës shqiptare, kur ai thekson se mohimi i saj është mohimi i gjithçkaje, se nëna përfaqëson jetën dhe vazhdimesinë e atdheut. Te «Liria» shpirtin luftarak, pavdekësinë e atdheut. E barazuar me

tokën shqiptare, nëna jepet si ushqyesja e frysës së lirisë Ajo jepet këtu sa epike, aq edhe lirike dhe lidhet me idenë se liria do të fitohet e se këtë popull nuk mund ta shkëputesh nga kjo tokë.

Kusht esencial i ekzistencës së personalitetit krijues është që ai të mos marrë shtytje prej spontaneitetit të rëndomtë, prej formalizmit, prej pozave dhe shqetësimeve tëpër intime. Poetët e mëdhenj të Rilindjes ditën të pinë ato burime ku derdheshin dhimbjet e atdheut, duke dhënë kështu përkrah karaktereve shqiptare edhe dinamikën shpirtërore të popullit në situata të rënda dhe kryqëzime kritike të historisë kombëtare.

Mqedja është vëzhguesi, perceptuesi dhe së fundi poeti që konkludon një realitet të caktuar historik përmes ndërgjegjes së tij poetike. Në qoftë se figura e nënës zgjohet në fisionominë luftarakë te «Liria», ajo jepet thjeht si nënë te «Vaji i bylbylit», «I tretuni». E ndërsa te «Vaji i Bylbylit» ajo shërben si element k拉斯imi për gjendjen shpirtërore të bylbylit – poet (si vajton nëna përfëmijë, vajton artisti përliri e krijim); në poemën «I tretuni», ajo është nëna e të mërguarit, e skamnorit, është pritia dhe vetmia, është èndrra dhe shpresë e mjegulluar, është pleëria që kërkon ngushëllim, shërbim, çmallje. Porse në fund të këngës së pestë dhimbja shkundet, intimja zgjohet e zhvishet nga perdja e lotëve, shpërthen më e madhia dhimbje; ajo për atdheun e robëruar e të vuajtur dhe varqu krijon himnin: «Nana jote ë Shqiptaria». Dhe lidhja e tokës mëmë me nënën është një esencë e motiveve mqediane.

Kulmin e kësaj figure, në nië shtrirje të gjerë me diapazon filozofik e shoqëror Mqedja e jep në poemën «Andrra e jetës».

Nëna është trupëzimi i jetës, por në trajtimin miedjan ajo është para së gjithash përfaqësuese e një miedisi të caktuar shoqëror, psikologjik e filozofik. Ky miedis përniban tablonë ekonomike, e cila evidentohet si bleqtorale, e prapambetur, e vuajtur, e mjerueshme, diku larg në Veri, në fshatra të vecuara, në një shtëpi të veçuar. Mjedia zbërthen rrënjet e ekzistencës së një jete dramatike ku

bashkëjeton lindja me vdekjen, ku personazhet përshkohen nga dinamizmi i brendshëm i një jete tipike malësore. Mjedja na ka dhënë, pra, një sintezë vitale shpirtërore të këtij mjedisit, duke na bërë ta ndiejmë thellësinë e këtij realiteti, por gjithmonë në planin psikologjiko-filosofik. Nëna gdhendet këtu si vetëjeta. E lidhur me këtë mjedis, ajo funksionon në dy pamjet: si nënë që lind, rrit, ushqen e mbron jetën familjare dhe si njeri që lufton, reziston dhe që arrin të triumfojë mbi jetën e vështirë.

Në planin e parë Lokja është nëna që kujdeset për fëmijët. Personazhet zbërthehen në motivet e tyre shpirtërore, brenda mjedisit romantik, të mbështjella me ndjenjën e dashurisë, që është ndjenjë që mban tërë poemën. Poeti, duke dhënë lidhjen e fortë të kësaj familjeje, ka shprehur idenë e fuqishme se vështirësitë, vuajtjet, mundimet e jetës ushqejnë dashurinë, nderimin e sakrificën për njëri-tjetrin. Te njerëzit e thjeshtë Mjedja, duke depërtuar në thellësi të jetës së tyre psikologjike, ka zbuluar pikërisht forcën lëvizëse shpirtërore, ka zbuluar shqetësimin tronditës të Lokes, që detyrimisht të çon në shqetësimet e dy personazheve të tjera, Në zgjimin e tërë vrulleve dhe pasioneve shpirtërore të personazheve qëndron edhe e bukura e kësaj poeme. Vetë ëndërrimi i Zogës është ndricimi i inkoshiencës nga ndienja erotike. Aty, në atë real, por shihet qartë si inkoshienca çliron ndjenjën erotike.

Me talentin e tij Mjedja ka arritur të gërshtetojë lirizimin e bukurinë e një mjedisit bukolik, me tragicitetin e jetës reale e të botës shpirtërore të personazheve në vepër. Zoga ëndërron dhe s'realizon, por krijon jetë. Nëna vdes në vetmi, duke lënë pas vazhdimin e një jete. Prandaj ka një lidhje të ngushtë midis Lokes dhe Zogës, sepse Zogën e shohim në rini e Loken në pleqëri, por gjithnjë duke pasur të qartë se është e njëjtë jetë, e njëjtë rrugë, pra shohim te Zoga rininë e Lokes të Lokja fundin e Zogës.-Poeti nuk e ndien frikën e vdekjes. Dhe personazhet e tij ashtu e shohin atë. Prandaj ajo nuk lind

në poemë tragjedi. Madje, ajo vjen aq natyrshëm, ashtu si dhe dashuria që i lind Zogës.

Andrra e jetës është lufta për jetën, luftë për ta fituar atë, për ta mbrojtur, luftë për ta jetuar, për ta gëzuar, luftë për të pasur mundësi për ta ëndërruar atë. Tablotë kanë një rritje dhe në sintezën e tyre pasqyrojnë dhe akuzojnë. Vepra e krijuar nga Mqedja vibron në morinë e ndjenjave, të momenteve. Ky krijim nuk dallohet siç është thënë, dikur për konstatimet, për përshkrimet, por për atë pushtet krijues që i bën të flasin elementët e jetës që nga momenti i perceptimit artistik e deri në momentin kur krijimi poetik kullohet e çlodhet, jeta dhe artisti shkrihen.

Mqedja në këtë poemë nuk pasqyron, nuk na jep atë që sheh, por thelbin, domethënien shoqërore, politike e filozofike, të gjithçkaje reale. Prandaj mendimi i tij vjen energjik, i thellë e plot pasion. Ai kalon nga e thjeshta deri tek e madhërishmjë, nga konkretja, e prekshmja tek e ndërlikuara edhe e pakapshmja.

Ndre Mqedja, ky mjeshtër i zërthimit të karaktereve, në shpirtin dhe filozofinë e tyre ka dhënë edhe përshkrim klasike, të cilat fiksojnë mqedise të fuqishme. Ato jepen në krijimtari me tone të ngrohta e të ashpra. Ai e jep natyrshëm në më se një formë: si peizazh i atdheut, si një paraleлизëm të botës shpirtërore të personazheve, si një frymëzim dhe tundim shpirtëror («l tretuni»; për mërgimtarin, si krenari kombëtare, si krijim i vizionit të botës, ku merr e jep poeti e tërë krijimi i tij artistik. Arti i Mqedjes është i lidhur ngushtë me natyrën e mprehtë vëzhguese të tij. Çdo figurë e tij lind nga një vëzhgim konkret real. Çdo interpretim i përshtypjeve të tij lind nga një mjeshtër i përcaktuar psikologjik e shoqëror. Po të pranojmë tek arti i Mqedjes këto tipare, kuptojmë dhe ndjejmë shpejt se përse krahasimi, paralelizmat, metaforat e hiperbolat përbëjnë një portret të gjallë të poezisë së tij. Në fillimet e veta Mqedja është poeti që, për të realizuar idenë, punon me tablo dhe ngre elementet e veta artistike. Njohës i mirë i poezisë popullore të Veriut

e të Jugut, ai e ruan perifrazën shkodrane, por e gjallë ion dhe e rinon atë, duke tutur aty dridhje të thella shpirtërore. Figura e tij në këtë kohë ndihet të ketë lindur nga një atmosferë e shqetësuar e shpirtit të tij, nga një mjeshtës i caktuar, i përpunuar gjatë në thekset e një mbrese të fuqishme. Kështu vargjet:

*«Cice! Shka ka sot Trinka
Qi po priton m'u çue,
Zgjoje me dalë me mue
Me lëshue baktinë e vet..»*

pohojnë stoicizmin e një populli, i cili e pret jetën dhe vdekjen me të njëjtën qetësi, por ndërkaq, tingëllimi dhe forma pyetëse e vargjeve sjellin menjëherë një botë inoçente. Mjedja është edhe poeti i imazheve të fuqishme, tablove origjinale tronditëse. Në poezinë e tij fjalë vendoset gjithnjë me një ide të caktuar dhe përfton nuanca të fuqishme përmes strukturës ideoemocionale e tingëllore të vargut.

Kështu natyra dhe ndërtimi i figurës poetike janë në një lidhje të ngushtë. Në çdo çast ai krijon me peizazhin dialogun e gjallë e të shkathët, ku evidenton mendimet dhe ndjenjat e tij nëpërmjet impulsesh poetike energjike.

Imazhet poetike të tij janë simbole të luftës shpirtërore. Aty imagjinata krijuese vjen e rritet së bashku me idenë që ai kërkon të shprehë.

Në krijimtarinë e Mjedjes një vend të rëndësishëm paraqet lirika e fuqishme antifeudale «Mustaf pasha në Babunë». E parë në një plan socialo-politik, tek ajo kemi një përputhje të plotë të formës dhe përbajtjes. Aty janë pleksur patriotizmi, dashuria për vendin, guximi, trimëria dhe heroizmi i popullit, i malësorëve tanë me përbuzjen dhe urrejtjen ndaj tradhtarit dhe feudalit. Ngjarjes historike poeti i ka bërë edhe një zërthim politik e shqëror. Personazhi historik merr nuancat e sunduesit dhe si tipik rraket e përplaset jashtë atdheut me uturimën e një urrejtjeje të shprehur fuqishëm e thjesht në vargjet e lirikës.

Rilindja ishte periudha e një tensioni të fuqishëm patriotik dhe arti u derdh me këtë tendenciozitet, duke krijuar një pasuri ligurative që s'ndien lodhje as tashitje në krijimet shumëvjeçare. Këtu është edhe kyçi i veprës poetike të këtij poeti. Figura, ideja, ndërgjegjja artistike, e ushqyer në burimin e mjesdit, ekuilibri i veprimit të brendshëm, ajo rregullsi e lindur nga harmonia e raporteve në kohë dhe në hapësirë, forma artistike e dhënë përmes një ritmi dhe simetrie të graduar në funksion të së tërës së krijuar janë tipare të rëndësishme të krijimit të tij. Ritmi me shumëllojshmérinë e tij është te Mqedja organizues i strukturës semantike e i melodisë së vazhdueshme të fjalës, kurse simetria ruan sigurinë e figurës në funksion të lëvizjes e të zhvillimit të idesë artistike.

Mqedja është krijuesi i ndërgjegjshëm dhe i vullnetshëm. Artin e tij e gjen të mbushur me logikën e ngjarjeve, të mbërthyer në të thjeshtën e në të kuptueshmen. Në vetvete ajo është e vërteta e perceptuar dhe e vendosur në krijimin artistik, është ajo që përcakton ëndërrimin apo imagjinatën poetike, është më së fundi këtujeta me luftën dhe sakrificat, është ai identitet i kënaqësisë shpirtërore me atë natyrore.

Mqedja e përdor figurën si fjalë dhe tingëllimin e saj plot pasuri kolorike e kuptimore, gjithnjë në funksion të psikologjisë e problematikës kohore. Kjo bën që poeti të jetë dhe i larmishëm në tone lirike, lirike-elegjake, liriko-epike. Kështu në kapitullin e Zogës vargu shtrihet, fiton kadencën pëershkruese, kalon ndën një penel të freskët, rinor, ku gërshetohet tensioni jetësor me ëndrrën rimore, ku peizazhi malor hyn si ndjenjë në botën e brendshme të Zogës, ku e zakonshmja dhe e përditshmja e lodhur kalamendet në pasionin erotik në formën e një ëndrre, ku vetëjeta e përfytyruar është zgjuar si puthja e agimeve në mugëtirën e zgjimit të ditës. Poeti përbledh te Zoga momentet e dridhjes që i jep ndjenja.

Vargjet ku Zoga jeton dridhjet e ndjenjës:

«Herë n'atë gjumë tuj qeshun dukej
Si m'u falë herë dorën çote,
Herë përmallshëm n'vedi strukej
E n'fëtyrë 'gjaku t'tanë i vëlote.»

e pohojnë këtë mendim. Mqedja e organizon figurën artistike mbi mbresën e gjallë. Kështu Kënga e Irinës, e përtuar në një varg elegant, sjell hapesirë tingujsh, çaste psikologjike bukolike, ekstazë lindjeje e ngazëllim tëmijëror. Vargjet kërcejnë e këndojnë nën ritmin e këtij ngazëlliimi natyror dhe me onomatopenë e tyre japin elementet e së tèrës. Ndihet rezonanca e fjaleve, muzikaliteti brenda fjalës dhe në lidhjet e fjalëve me njëratjetërën!

Në këngën e dytë të Zogës 10-rrokëshi thurret me pesërrokëshin dhe fiton një tjalë poetike të re që mban dhe shqetësimin e personazhit. Këtu emocioni poetik ka thyer vargjet, ka kapërcyer nga strofa në strofë fjalinë dhe, ka krijuar portretin kompleks plot èndrra të shqetësuara e aq folës të botës shpirtërore të Zogës. Fjala ka një përbajtje depërtuese, tingujt e hapët flasin pér shpresën e një ndjenje dhe ankthin e saj, rimat përbajnjë dëshira grishëse, plot ahje, ndërsa fundi i këngës së dytë formon korin e ndjenjave rinore me tingujt zanore y dhe oj në vargjet:

Nuk erdhi djali: veç dy bylbyla,
Nji n'drandofille, nji ndër zymbyla
Përmallshëm thrasin, e shoqi-shojnë
Me kangë gazzmojnë.

Por, kur poeti jep çastin final të ndjenjës, kur e zbërrthen atë në elemente konkrete, kur e shtjellon dhe e nënvizon èndrrën në botën reale, si artist ai lë jashtë çdo pamje tjetër anësore e përqendrohet në thelbin e idesë së rrahur, pikërisht në lindjen, Këtu vargjet hyjnë në tingullin e ninullave të ndjenjave, në djepin e përkundjeve, në dallgët e pasioneve të nënës dhe Zoga-vajzë përfudimisht kalon në Zogën-nënë. Kënga IV derdhet mbi një botë tingujsh nanuritës, ku duket vallëzimi i harmonishëm i ndjenjave të nënës, ku duket mbarsja me lumturinë e lindjes ku dhe vetë natyra, qelli përligj ngazëllimin e vet.

Vargu pikon drithë e kaltërsi, derdh buzëqeshjen e fillave të gjelbërimit, merr ngazëllimin e nënës si burim jete, nënës lumturidhënëse, nënës frymëzim shprese. Dhe këtu poezia përfshin lindjen e të vërtetave të shpirtit të

poetit me shpërthimet e tij të panjohura, të padukshme, aq jetëmbajtëse. Vjetvetja e zgjuar në këtë shkallë e trondit dhe e çudit edhe vetë artistin e madh.

Arti i Mqedjes, pra, përshkohet nga gjithë kjo dinamikë krijuese. Vetë Lokja e zberthyer psikologjikisht në detaje karakteristike të moshës e të gjendjes së saj mban tregimin e një jete që ka në thelb qëndresën. Qëndresa nderet në dy shtrirje: në energji e veprim konkret dhe e dyta; buri jete dhe krenari. Këtu elemente nën-vizojnë te Lokja stoicizmin, që e çmon jetën aq sa duhet. Kjo qëndresë e shpërfill vdekjen, prandaj çasti i fundit i saj pohon vetëm përfundimin e një jete. Rënim i Lokes është drama e një populli. Në shpirtin e tij jetojnë të pavdekshme energjia, vullneti, shpresa dhe dashuria për jetën. Durimi i Lokes është stoicizmi i malësorëve dhe në këtë qëndrim kemi të bëjmë me grumbullim energjish dhe jo me apati apo tërheqje. Vetë ëndrra është vatra e dëshirave që mbështeten gjithnjë në tokë. Poema duket sikur thërret deri në fund jetë, lindje.

Mqedja është poet i fryshtuar nga trazime të mëdha kohore. Muza e tij është e thellë, jashtë çdo kapriçioje artistike, e përkthyer në simbole e figura mahnitëse, e derdhur në vargje plot tension, të cilat janë të lidhura ngushtë me jetën dhe artin shqiptar. Për të gjithë veprimtarinë patriotike, letrare e gjuhësore Ndre Mqedja zë një vend të nderuar në historinë e kulturës shqiptare.

Poetët tanë të shquar kanë pasur shumë pak kohë për t'iu kushtuar poezisë, sepse u është dashur të punojnë në shumë drejtime për atdheun, duke qenë në radhë të parë patriotë, sepse në fund të fundit u është dashur të luftoinë shumë në jetë e sidomos kundër raprezalieve e ndiekjeve. Dramatike ka qenë është e tyre dhe ende e pashkruar plotësisht, kurse vepra u mbeti e shpërndarë për shumë kohë.

Edhe Miedia është në këtë qerthull.

Ndërkaq ky botim i veprës letrare të tij e nxjerr më në nah e më të qartë krijimtarinë e këtij poeti të shquar të letërsisë sonë.



Nëna e Ndre Mqedjës

JUVENILIA*)

*) Botimi i vjershave të Mqedjes renditet sipas vëllimit
D. Ndre Mqedja «Juvenilja». Në Vjenë, Shtypshkroj' e
Gj. M. Vernay 1917,

D. NDRË MIEDIA.

JUVENILIA.

Në Vjenë
Shtypshkroj e Gj. N. Vernay
1917.

Faksimile e kopertinës së veprës «Juvenilia»,
botuar në Vjenë në vitin 1917.

VAJI I BYLBYLIT*)

Po shkrihet bora,
Dimni po shkon;
Bylbyl i vorfën,
Pse po gjimon?

Pushoi murrlani¹⁾
Me duhi²⁾ t'vet;

*) Poemthi «Vaji i bylbylit» është shkruar më 1886 në Porto-Ré, kur Mqedja ishte 20 vjeç. Poemthi është i ndarë në katër pjesë dhe është alegorik. «Vaji i bylbylit» shpreh protestën e pakënaqësinë e tij individuale ndaj realitetit ku ai jeton. Në këtë poemth Mqedja derdh shfrimet e sinqerta të tronditjeve të tij rinore, të èndrrave, të dëshirave, të mallit për atdhe. Poemthi ka dy personazhe lirike. Njëri simbolik, bilbili, dhe tjetri real, njerëzor velvetja; i pari i shërben plotësisht zërthimit të të dytit. Poemthi thekson protestën e poetit kundër rregullave, moralit dhe edukatës së shkollës e shoqatës jezuite. Poemthi është dhe një protestë kundër çdo lloj zgjedhe.

Ky poemth u bë shumë popullor. Në ato vite ai këndohej në Shkodër si këngë atdhetare. Dëgjohej shumë nëpër dasma. Muzika ishte krijuar nga Gaspër Jakova.

1) murrlani — erë e ftohtë, që fryn nga verilindja
2) duhi — stuhi, furtunë, tufan

Bylbyl i vorfën,
Çou, mos rri shkret.

Gjith' fushët e malet
Blerimi i mbëloj;
Livadhi e pema
Gjithkah lulzoi.

Ndër pyje e ograja¹⁾,
N'ma t'mirin vend,
Me rreze dielli
Po e gjëzon gjithkend.

E tuj gjimue
Shkon rrëth e rrëth
Nji prrue që veret²⁾
Rrjedh nëpër gjeth.

A³⁾ çilë kafazi,
Bylbyl flutró;
Ndër pyje e ograja,
Bylbyl, shpejto.

1) *ograjë* – pyll i vogël i rrëthuar, prozhëm, bashtinë, vend për kullota

2) *veret* – gjatë verës

3) *a* – formë e shkurtuar e foljes *asht* (është)

Kurrkush ma hovin
Atje s'ta pret;
Me zeher hajen
Kurrkush s'ta qet.

Kafaz ke qiellin,
Epshin¹⁾ pengim;
E gjith' ku t'rreshket²⁾
Shkon fluturim.

Nëpër lamie³⁾,
Ke me gjetë mel;
Për gjith' prendverën
Njajo buk' t'del.

E kur t'zit edi⁴⁾
Ndër prroje pi;
Te njato prroje
Që ti vetë di.

Tash pa frikë çerdhen
E ban n'ndo'j lis;
Nuk je si 'i nieri⁵⁾
Që nuk ka fis.

1) epshin – këtu: dëshirën

2) t'rreshket – këtu: të teket, të pëlqen

3) lamie – lëmenj.

4) t'zit edi – të nxit etja

5) nieri – njeri

E kur t'vij' zhegu,
Kur dielli shkon,
Ti ke me këndue
Si ke zakon.

Rreth e rreth gjindja¹⁾
Me t'ndie rri;
Prej asi vendit
Ndahen me zi²⁾.

A cilë kafazi,³⁾
Bylbyl, flutro;
Ndër pyje e ograja,
Bylbyl, shpejto.

Ndër drandofille,
Ndër zambakë nga;
Ku qeshet kopshti,
Idhnik mos mba.

1) gjindja — njerëzia

2) me zi — me vështirësi (ndahen me vështirësi)

3) Bilbili jeton rrëzë maleve, afër ujërave, ndër kaçuba të vogla. Ai këndon në mëngjes dhe në muzg deri natën vonë. Autori thekson se këtë këngë nuk e kuption dhe nuk e ndien ai që e kalon jetën nëpër qytete, në zhurmën e në luksin e tij. Autori menjëherë i jep bilbilit rolin poetik, figurativ. Me këtë rol mylllet kënga e parë dhe nis kënga e dytë.

Po shkrihet bora,
Dimni po shkon;
Bylbyl i vorfën,
Pse po gjimon?

||

Por vaj! se 'i dimën tjetrë
Paske, o bylbyl i shkreti;
Pa da¹⁾ ty zemra t'treti²⁾)
Mbas vajit që t'rrethon.

Me lulzim t'vet prendvera
Ty s'ta përtrin gazmenden:
Jo kurr s'e njifke shendin³⁾),
Bylbyl, që po vajton.

A thue po kjan, se çerdhen
Ta ka shkatrrue skyfteri?
A thue po kjan, o i mjeri,
Se me rrnue⁴⁾ gjallë s'ke mel?

-
- 1) pa da — pa pushim
 - 2) treti — humbi, u molis nga vaji
 - 3) shend — gëzim, hare
 - 4) me rrnue — rroj, jetoj

Ndrrojn' edhe stinët e motit,
E për gjithë ças¹⁾ ndrron era.²⁾
Mbas dimnit vjen prendvera,
Mbas borës blerimi del.

Veç ti me idhnime t'tuja
N'zemër gjithmonë po pihe.³⁾
E ditë e natë po shkrihe⁴⁾
Mbas vajit që t'mundon.

Kur a tuj ardhun drita
Ndihet tuj këndue shpendi,
E n'kangë i duket shendi
Që zemrën ia gazmon.

Njeti⁵⁾ ndër pemë, ndër lule
Shkon e flutron bylbyli;
N'at erë që nep⁶⁾ zymbili
Vjollca e zambaku nget.

Por ty, n'kafaz t'shtërnqueshëm,
Ty t'paška ndry mizori,⁷⁾

1) e për gjithë ças – çdo herë

2) era – koha

3) pihe – ngrin, mpihesh; Hidhërimi mpin zemrën si acari që mpin duart.

4) po shkrihe – po fikesh, po vdes.

5) njeti – gjetiu, tjetërkund

6) nep – jep

7) mizori – katili, sunduesi, i pushtetshmi

E kurnjiherë nuk t'xori
Me t'lshue ku zemra t'hrret.

Ti kurr, nji kangë s'ia kändove
Diellit kur nadje¹⁾ çohet;
Zemra me vaj t'coptoheret
E me pajtue nuk don.

Ndoshta kujdesi i t'tujve²⁾
Gjith' ket idhnik ta qiti,
E shendin ta shutiti³⁾
E vshtira që i mundon.

T'burguem i bani gjindja⁴⁾
Veç përse donë me ndie
Njat za që lëshojnë me hije
Që t'knaq e që t'ban rob.

Çdo krajl i madh ndër shpija
Ty t'mba m'u thanë i veti;
Vetë bukuria, o i shkreti,
Kenka për ju nji kob.

1) nadje — mëngjes

2) i t'tujve — i familjes sate

3) ta shutiti — ta mphiu, ta shuajti, ta shugati, ta zhduku
4) Dy strofat: t'burguem i bani gjindja..., dhe «Çdo krajl i madh ndër shpia»..., theksojnë gjendjen psikologjike — autobiografiqe të Mqedjes të mërguar. Këto dy strofa katërshe nënvisojnë idenë e fuqishme: Talenti zhvillohet dhe merr forcë në gji të jetës, në gji të popullit, në gji të atdheut.

Përse tu ndeja¹⁾ e t'mëdhajve
Nji shpend i vogël s'ndalet;
Shpendit i kande malet,
Çerdhen e t'parve do²⁾.

Me at zanin tand t'përmallshëm
Ndoshta ti ankon këto t'vshtira;
Derisa t'kthejn' e mira,
Bylbyl, papra gjimo.³⁾

III*

Por njaj vaj që je tuj lëshue,
Bylbyl, zemrën ma copton;

1) tu ndeja – te selia. Kupto: shpendi nuk rri në shtëpi, nëpër banesa të kujdo qofshin këto, e aq më tepër të të mëdhenjve.

2 Çerdhen e t'parëve do. – Vendlindjen do

3) Vargu «Bylbyl, papra gjimo», është një grishje për liri, për të shpërthyer kafazët e mërgimit, edhe atëherë kur mund të ndihesh mirë. Nuk ka si atdheu. Vargu është një konkludim dhe akuzë për të gjithë ata që zhvishen nga ndjenjat atdhetare dhe u nënshtronen miklimeve e favoreve të të huajve. Vullneti është vetë forca e shpërthimit të këtyre kafazeve.

* Kënga e tretë është një ankim e përmban aspekte të një autobiografie të jetës së poetit në shkollën jezuite. Ajo krijon portrete paralele të të mërguarve, të cilët evidentohen nëpërmjet robërisë së bilbilit. Që këtej del qartë ideja se mjedisi jezuit është një burg dhe jeta që bëhet aty është një jetë e ndrydhur e padurueshme, shtypëse, skllavëruese, sfilitëse.

Ditë e natë rri tuj prigjue,¹⁾
Vaj për mue! Kush mund t'ngushillon?

Gjama jote a porsi ankimi
I nji fëmijës që vetun²⁾ mbet;
Gjama jote a si shungllimi³⁾
I nji t'zezës që gja s'e pret.

Porsi dnesë me futë⁴⁾ në krye⁵⁾
Nana e shkretë që mbet pa djelm;
Njashtu tine⁶⁾ rri tuj shfrye
Njat idhним që t'u ba helm.

Puna jote, o i mjeri, m'mbyti
E kurkund nuk m'len pushim,
Shkoi nji muej, po shkon i dyti
T'zezat t'tua s'kanë mbarim.

Tash ndër arë lulzoi qershia
E me borë dimni po shkon:
Kurr s'mbarojn' t'zezat e mia,
Gjama jote kurr s'mbaron.

1) me prigjue — vështroj, mbaj vesh, rri duke dëgjuar.

2) vetun — vetëm

3) shungllim — ushtim

4) futë — shami

5) I gjithë vargu ka kuptimin. — E qarë me ligjërimë, me lemjë, me gulçim a rënkim të thellë, zakoni i popullit, sipas të cilit mbulohet koka dhe qahej me ligje.

6) tine — ti

Si t'burguemit n'ishull t'detit,
Ku tallazi thekshëm¹⁾ vrret²⁾;
O t'vijë t'ftoftit, o t'vijë t'nxetit,
Vaji zemrën ia pëlset;

E papra n'ankime t'veta
Vajton fisin që larg la;
E tu fëmija i shkon si zgjeta
Mëndja e shkretë se mbet pa ta;

Njashtu ti rri tuj vajtue
N'njat³⁾ kafaz që shungallon;
Fisin tand rri tuj mendue
T'zinë atdhe që s'e harron.

Për fat tand, për zogj që kishe
Ndoshta zemra, i mjeri, t'dhemb;
Me e pas dit' të mjerët ku rrishë
Kërkue t'kishin gemb mbi gemb

Me e pasë ndie njat za që lëshoshe,
Me e pasë ndie njat vajin tand,

1) thekshëm – me hov, turrshëm, furishëm

2) vrret – thërrret ulërin

3) njat – në atë

Kishin ardhë kudo që t'shkoshe,
T'kishin lypun kand e kand¹).

Njat vaj tandin tuj kujtue
Pa mbyllë syt' kan' shkue sa net;
Pvetshin hanën tui gjimue,
Pvetshin hyjt për prind të vet.

Por aj kob që hana e diti
E njaj vaj që ylli pau,
T'shkretve n"vesh kurr nuk iu mbrriti,
E kurr zemra nuk ju ndau²).

Me ditë hyjt me bisedue,
Me pasë sy që me derdhë lot,
Vajin tand ju kishin prue
T'kishin kja për jet' e mot.

Nëpër fush' e nëpër shpija.
Me ziti³) që s'nep afat,

1) kand e kand – qoshe më qoshe; skaj më skaj, anembanë, gjithkund

2) Nuk ju ndau – Nuk i pushoi vaji, zemra mbeti në vaj, me mallin për të afërmit, pa u dëgjuar prej tyre.

3) ziti – kujdes i madh

Rreth e rreth t'kish ardhun fëmija,
Kjamun t'kishte i ngriti fat¹)...

IV

Por ça ka toka, bylbyl, ndrron moti;
Ankimi e vaji nuk asht i zoti
Përgjithmonë zemrën me na coptue;
Fillo me gëzue.

Mbas boret t'dimnit çilet prendvera;
Nji ditë nuk gjindet që s'po ndrron era;
Sendet që patmë janë tuj mbarë;
Fillo me gëzue.

Tuj dnes' i vorfni se e mbluene t'kqijat,
Me ankime t'veta mbush rrugët e shpijat;
Lecim²⁾ por s'mbramit³⁾ gjen tuj punue;
Fillo me gëzue.

1) I ngriti fat – e zesa, e mjera grua. – Jepet me kuptimin grua, familje.

Fundi i kësaj këngë është një gërshetim i dhembjes dhe i dëshirës së të mërguarve, të cilët vuajnë larg atdheut, i përvëlon malli pér të. Ata duan patjetër të kthehen përfundimisht në atdhe. Kënga e katërt është një shfrim romantiko-filosofik, ku optimizmi pér lirinë e Atdheut është i lidhur ngushtë me optimizmin pér lirinë e vetyes. Në këtë këngë shprehet me forcë besimi i madh pér titoren, pér shporrjen e pushtuesit turk.

2) lecim – lehtësim

3) s'mbramit – më në fund

Kjajnë fëmijn e dekun prindë e shkretnuem
Me 'j vaj që duket se s'ka t'pajtuem!
Por zemrën moti jau ndrron tuj shkue.¹⁾
Fillo me gëzue.

Ndër ishuj t'detit kjan i burguemi
Për fmij, për grue që s'shef i shuemi,
Por prap durimi ka me ja prue²⁾,
Fillo me gëzue.

Shpend tjerë burgosi sa herë mizori,
E rishtas jashta dikur i nxori;
Ndër fushë e male janë tuj fluturue;
Fillo me gëzue.

Flutrojnë ndër male, flutrojnë ndër lule,
Flutrojnë ku çerdhen motit³⁾ e ngule,
E kangët e parshme⁴⁾ nisin me këndue:
Fillo me gëzue.

1) Por zemrën moti jau ndrron tuj shkue. — Me kalimin e kohës plaga, dhe ojo më e rënda, mbylllet.

2) Por prap durimi ka me ja prue. — Durimi do t'ia sjellë pas njëfarë kohe mundësinë që t'i shohë fëmijët, gruan e të afërmit. Kjo ide lidhet me strofen tjeter; Shumë të mërguar nga ndjekjet e raprezaljet e Perandorisë Osmane janë kthyer më në fund në atdhe dhe vazhdojnë luftën e tyre për lirinë e atdheut.

3) motit — dikur

4) kangët e parshme — kangët e hershme, të dikurshme, të vjetra.

Ndër zogj që kishe ndojherë do t'hasin,
Ndër pemë, ndër lule bashkë me ta ngasin;
Për ty t'vorfnuemit rrijnë tuj shpnesue:
 Fillo me gëzue.

Bylbyl, ky shekull or e ças ndrrohenet:
Bijnë poshtë të naltit, i vogli çohet;
Edhe natyra po don m'u ndrrue:
 Fillo me gëzue.

Krajlnit¹ ma t'moçmet ndrrohen me t'reja
E nji mij' popuj ranë porsi rrfeja;
Po kthen motmoti²) që pat mbarue:
 Fillo me gëzue.

Porsi motmoti ndrrojmë dhe na vetë,
Herë-herë gazmohna, herë rrijmë të shkretë,
Për vaji e anëkimi kanë për t'u shue;
 Fillo me gëzue.

Mbas vajit t'tashëm ka me t'ardhë shendi,
Ka me ta shëndoshun zemrën gazmendi;
Për mall, si motit, zanë ke me e lëshue:
 Fillo me gëzue.

1) Krajlnitë – Fjala krajlështë përdorur me kuptimin mbret.
Edhe sulltani me këtë emër quhej. Po kështu edhe mbretëritë e Evropës kështu i quanin.

2) motmoti – koha

Kur t'shkojsh ndër fusha, kur t'shkojsh ndër
male,
Afër shpisë seme hovin tand ndale;
Mahnit'¹), at zanin tand tuj prigjue²),
Kam për t'u gëzue.

Porto-Re — 1886

1) mahnitë — i mahnitur, i mrekulluar

2) tuj prigjue — duke dëgjuar

Strofa e fundit e poemtit është porosia e poetit për të afërmit e tij dhe njëherazi optimizmi i tij se luftën për liri, edhe pse ai do të jetë edhe i burgosun nën rregullat jezuite, dikush do ta vazhdojë, e kjo e gëzon. Poeti në këngën e katërt i ka derdhur shqetësimet individuale në më se një aspekt.

I T R E T U N I *)

|

Me shi pshtjellun¹⁾ acaria²⁾
Përmbi bjeshkë po shungullon;
E prej maleve stuhia
Ujët e detit e përvëlon^{3).}

*) Ky poemth mbart në motivin romantik një gërshetim të rëndësishëm, fort për zemër të Mqedjes, Nëna dhe Atdheu. Duke e vështruar këtë krijim poetik si një zërthim të botës shpirtërore të të mërguarit, vihet re se notat e thella elegjiakë, plot dhimbje, ku mënia përmban edhe protestën, lidhen drejtpërsëdrejti me Atdheun. Poemthi përshkohet nga një përmallim i fuqishëm, nga shpërthime të një dhimbjeje të madhe patriotike, sa individuale që edhe sociale. Kjo dhimbje, që nderet në krejt lirikën, është një dhimbje herë-herë pa krye e herë-herë shpresë-pritur, derisa dhimbja dhe malli zgjojnë betimin, zgjojnë veprimin për liri.

Poemthi është i ndarë në pesë pjesë.

- 1) pshtjellun – mbështjellë, përzier
- 2) acaria – cingërima
- 3) përvëlon – kuptim figurativ; Deti duket si uji që zien, sepse stuhia formon valë. Kemi një asosacion artistik.

Mal e re, porsi dy zdapa¹⁾
Ngrehin luftë që gja s'e pret²⁾,
Gjimon moti e par' e mbrapa,
Mnershëm rreja po kërsset.

Po kjo gjamë që ban natyra,
Kjo duhi që s'ka pushim,
E kësaj zemre a pasqyra,
A pasqyra e vajit tim.

Porsi 'j ujk që natën turret
E mbas deleve luron,³⁾
Kërkon mal e kërkon shkurret
Derisa ndo'j vathë e rrmon;⁴⁾

Kenka thanë me pshtue fajtori,
Mbi krye temin pa nji faj;

1) zdapa – viganë, në kuptimin të mëdhenj, të frikshëm, të përbindshëm.

2) Ngrehin luftë që gja s'e pret. – Po bëjnë luftë të ashpër që nuk mund të ndalohet nga askush. Vargu shërben si një zbërthyes i vargut të parë të kësaj strofe, pikërisht nominativit mal dhe re. Mjedja, si poet romantik dhe i frysmezuar, ngrë në përfytyrim legjendar peizazhin, natyrën dhe me të bën zbërthimin shpirtëror, psikologjik të vvetvates. Natyra shtjellon kështu gjendjen psikologjike të të mërguarit, duke reflektuar fuqishëm dhimbjen e tij dhe mallin e të mërguarit për atdhe. Gjëmimi i motit-bubullëma, shkreptima, vajtim i natyrës është vetë vajtimi i poetit.

3) luron – ulërin

4) rrmon – rrëmon, rrëmih, gjen, – zbulon vathën.

Kenka thanë me pshtue fajtori
E me hupë kush s'a si aj.¹⁾

E me lanë njat vend që dritën
E këtij shekulli m'përftoi,²⁾
M'u largue prej asish që m'rritën,
Që kurr zemra s'i harroi.

O ti diell, që pa një hije
Mbi Bjeshkë t'Nemuna³⁾ shkëlzen,
Për mue ndoshta ata shkambije
S'ke me i shndritë kah shkon e vjen.

Valë e Drinit rrrotullore
Që për mal e fusha bje;
E ti e Buenës rrjedha qetore,
Jo, s'do t'm'shifni kurr atje.

Por si re që tret duhia
M'ikë, o Shqype, vendi jot;

1) E me hupë kush s'a si aj – Humb ai që s'është fajtor.

2) Vargjet: E me lanë njat vend që dritën
e këtij shekulli m'përftoi

duhen kuptuar: Të lësh atdheun, vendlindjen, ku ke parë së pari
dritën (m'përftoi – këtu: më dha, më dhuroi; shekull – duhet
kuptuar jetë, bota), pra e kësaj jete, e kësaj bote.

3) Bjeshkët e Nemuna – gjenden në Veri të Shkodrës, në Shkrel
e Kelmend. Fjala të nemuna, të namuna, të mallkuara, është një
epitet që i është ngjitur, sepse janë të zhveshura, s'kanë drurë
dhe ujë.

E kurrma ndër ditt e mia
Ndoshta n'ty nuk piqem dot.

Lamtumirë, o mori Shkodër!
Lamtumirë, o ti Cukal!')
Zhduket Buena nën nji kodër,
Zhduket Drini nën nji mall!

Lamtumirë, o ti nanëshkreta,
Që me t'vshtira m'rrite kaq,
N'kohë ma t'mirë për ty unë treta,
Kur pleqnia kërkon paq.

Veshkn'ju²), lule, që ju vuna
Me kujdes n'at' kopshtin tem,
Tretni, zogj, që 'j ditë ju xuna
Tuj flutruet gemb mbi gemb.

1 Cukal – mal në verilindje të Shkodrës.

Kjo strofë është një nga ato pëershkrimet mjeshtërore të Mjedjes ku, me pak penelata, ai arrin të gdhendë tablo të fuqishme. Është sintezë e tërë e një peizazhi.

2) Veshkniu – Fishkuni ju. Të vihet re ai intonacion recitativ e figurativ edhe përmes apostrofit: veshknju. Fjala mban një theks shqetësues, një ngërç në grykë, një të mekur, një dhimbje të thellë. Kështu, vendosja e një hieze merr funksionin e zbërvihimit poetik, psikologjik të gjendjes shpirtërore të vetë poetit..

È ti grunë, që mbuell buqari¹⁾
Me djersë t'ballit e t'punoj,
Thaj²⁾ për hanë, o të mbloftë bari,
Se un' ty kurr ma nuk t'kérkoj.

Por ju, dele, që blegroni
N'bjeshk' e n'vrrri me tuba shpesh,³⁾
Shton'ju, shton'ju⁴⁾ e larg m'i çoni
Për tregtarë do bashka lesh.⁵⁾

Hapi n'bjeshkë, çetinë mbretnore,⁶⁾
Hapi gembat kand e kand;
Trashu, shpardh,⁷⁾ me trup e lëvore,
Lëshoju, bré⁸⁾, me at' shtatin tand,

1) buqari – bujku

2) thaj – thahu. Janë shfrime e mallkime të poetit, gjithnjë në funksion të gjendjes psikologjike të të mërguarit, i cili, i tronditur, shfren pa shpresë duke e vënë veten në gjendjen e mërgimtarit të përjetshëm, që ai e thekson në vargun: «Se unë ty kurr ma nuk t'kérkoj».

3) vrrri – vend ku malësorët kalojnë vjeshtën, dimrin; me tuba shpesh me tufa të shpeshta dhensh.

4) shtoniu – Të vihet re se si në këtë rast hieza përdoret në kuptimin e një shtytjeje dhe shpreh çastin e një shpërthimi për t'u çmallur. Këtu kemi padurimin poetik për t'u lidhur me një send që i përket atdheut.

5) bashkë – lesh i qethur i një deleje,

6) çetinë – lloj pishe

7) shpardh – një lloj lisi me gjethë të gjëra

8) bré – bredh

Ndoshta 'j ditë n'nji breg tē thyeshëm
Ndo'j lundric¹⁾) o 'j barkë shtegton;
Drunin iuej, pér shej t'mallëngjyeshëm
Barka o lundra ma difton.

II

O terr i kësaj shpellës,
O hekra t'shtrëngueshme,
Ju falem! ma t'kthellës²⁾
Ndër gropë t'shemptueshme,
I falem, se shqimit³⁾
Ju m'hiqni trishtimit.

1) lundricë – lundër e vogël

Në këto strofa tē fundit vihet re dëshira e poetit që tē prekë e tē shohë diçka nga atdheu i tij. Pritja e tij, shpresë e tij pér tē parë ose pér ta prekur drurin e një barke, dru i atdheut tē vet, duke kriuar një përfytyrim poetik, krijon po aty dhe një bisedë psikologjike shpirtërore tē brendshme tē autorit. Me çdo kusht kërkon një shenjë tē atdheut. Dhe këtu e kanë burimin foljet shtonju, hapi, trashu, lëshoju (kupto: merr hov përpara), tē cilat janë elemente tē fuqishme tē përmallimeve poetike patriotike dhe tē padurimit pér tē parë atdheun.

Kënga e dytë është një përshkrim i vendit ku jeton i mërguari. Në këtë rast vihet re shpërfytyrimi që poeti i bën këtii vendi. Ai theksón aty dhimbjen e madhe tē tē mërguarit, aq sa i duket se është në burg. Poetit s'i hyn në sy asgjë përpara atdheut tē tij.

2) t'kthellës – së thellës

3) shqimit – fare, krejt, kryekëput

Ky diell, që këtu shifet,
S'a dielli i Shqypnisë
Kjo dritë, që këtu njifet,
A fundi i terrsisë!).
Nuk flet, jo, shqyptari
Si ndihet këtupari.

E kandshme si vera,
Kur çilin bylbylat;
Përmallshem si era
Që napin zymbylat,
Ndër lufë ma s'parit²⁾)
A gjuha e shqyptarit.

Bylbyla, që s'ndihni³⁾)
N'kët' t'mjerën shkreti,
Zymbyla, që shkrihni⁴⁾)
N'ket t'madhe thati
Pa muejtë me lulzue,
S'a vend ky për jue.

1) terrsi – errësirë

2) ma s'parit – Është fjala për lulet e para. (Zymbili çel i pari në pranverë) E mbi lumturinë e ngrohtësinë që të jep lulja e parë e pranverës është gjuha shqipe, stina e stinëve.

3) s'ndihni – nuk dëgjoheni

4) shkrihni – shkriheni. Këtu me kuptimin e një animizimi duhet kuptuar: Nuk arrini dot të rriteni e të lulëzoni, thaheni, vyshtkeni para se të lindni. Hiperbclizimi poetik mjetjan, me nota të fuqishme romantike, evidenton qartë kontrastet midis atdheut dhe këtij vendi ku jeton i mënguari. Kemi perceptim psikologjik-autobiografik.

Ju njeti galdoni¹⁾
Ku â flladi i pëlqyeshëm
Ku qetas del kroni,
Ku gurra del rrmbyeshëm,
Zymbyli n'kopshëtije
Tërbohet nën hije.

Ograja bleroshe,
Kodrina t'lulzueme,
Ti njeti kërkoshe,
O shpez' e bekueme,
Njat kangë, jo, me shfrye
S'a vend ky për tye.

Këtu vaji e trishtimi
Veç ndihen ndër shpia.
Këtu ndihet... tingllimi
I hekrade t'mia,
E gjama e nji t'shkretit
Që merr vala e detit.

1) Ju njeti galdoni – Në vend tjetër gjëzohi. Kuptimi i vargut është që vendi më i përshtatshëm për të gjitha këto lule është Shqipëria, ku për poetin stinët janë të bukura, natyra me elementet e saj është gjithnjë në shpërthim, në hare, e dehur.

Po këndon nji djalë te bregu¹⁾)
 Përmallshëm si tuj kja;
 As muzgu i natës as zhegu
 S'munden andej me e da,
 Si vaj gjithkah i shkote
 Zani nëpër shkambij.

•

Pshtetun mbi bërryl, kah dedi
 Ku s'shihet gja me sy
 T'përlotshmen kqyr, e n'vedi
 Duket se do me ndry
 Nji send që mbrendë i vëlonte
 Si gretha, o si gjarpij²⁾)

Këndote nji fushë t'punueme
 Me grunë e me barishta;
 Këndote nji shpi t'vorfnueme

Kënga e tretë është një konkretizim i shpërthimeve të përmalluara të të mërguarit që shihen në të dy këngët e para. Dialogu është nostalgik, grishës, me tone autobiografike të fuqishme.

1) te bregu – te bregu i detit; shih vargun e fundit të këngës së dytë: Vala e detit, që lidhet me vargun e parë të këngës së tretë.

2) Strofa e dytë – Jepet çasti kur i mërguari, i cili nuk e sheh dot atdheun nga bregu i detit, ku dergjet, humbet në lot e mundohet të mbajë të ndrydhur shpërthimin e vajit, mallin, i cili e bren.

Ku vajton mbrëndë ferishta,¹⁾
Vajtojnë dy goca t'mjera
Me nji kunatë t'pafat.

Ndihej si 'j za që fiket
Letas n'gjith' at shkreti;
Si nji përcjellë muziket
Dukej ankimi i tij;
Si za lahute që era
E tret prej kësollet m'shpat.

Ah! pash at vaj që t'grini!²⁾
Mos e ndal kangën, djalë.
N'zemër nji gjësim m'pértrini!³⁾
Njaj vaji yt, nji fjalë
'Tambël si ndesha e mikut
Që zemrën ta gazmon.

Për atdhe tand ti, vetun
Nëpër shkreti t'këtij vendit,
N'zemër pëlset, i tretun,
Larg shpisë e larg gjith'sendit,

1) ferishte – kërthi, fëmijë i njomë.

2) grini – copëtoi, thërrmoi

3) Vaji i të mërguarit i përrtu gjësim poetit, i dha forcë, sepse ishte vaj malli për atdhe. Krahasin, që qartëson idenë e tij, e jep me vargjet e mëposhtme, që përcillet si një këngë, poeti e konsideron atë si fjalë të ëmbël që i ngjason pëershëndetjes së një miku. Është një monolog romantik i poetit, i shpirtit të tij.

O djalë, e n'frymë t'denikut,¹⁾
N'furi t'kësaj erës, vajton.

Janë xhevahira, o i mjeri,
Lott që t'kullojnë përdhé:
E përmbi mjaltë a vëneri
Që t'turbullon n'at fe;²⁾
Jan' ar e gur t'paçmueshëm
Pér nji kunorë n'krye t'at.

Ndoshta 'j tallaz, që avitet,
Tash merr prej lotsh nji pikë,
E valë mbi valë prej dritet,³⁾
Me ngjallë nji uzdajë⁴⁾ që a fikë,
Kalon e 'j shej t'lakmueshëm⁵⁾
I çon t'shkretnuemit fat.⁶⁾

1) denik – Kështu e quajnë shirokasit erën e fortë që sjell shi, e cila fryshtat prej Plavnice (Mal i Zi).

2) n'at fe – në atë mënyrë, në atë shkallë shqetësimi

3) prej dritet – në të dalë të dritës, duke u afruar drita

4) uzdajë – shpresë

5) shej t'lakmueshëm – shenjë e dëshiruar, e aqpritur

6) Strofa e fundit e këngës së tretë e ngritur; mbi një detaj poetik, krijon lidhjen e nostalqjisë midis të mërguarit dhe atdheut gjendjes së tij në atdhe. Loti, që do ta mbartin valët, do të jetë shpresa për familjen e të mërguarit, që ndodhet në një qytet bregdetar; do ta njoftë grua e tij (nënvizuar me fjalën fat), e cila është shpresëhumbur.

IV

O lejlek, o shpend udhtar,
Që prej s'largut je tuj mbërri,
Pash njat frymë që merr e t'bar¹⁾
Ndalu 'j herë n'njiket²⁾ shkreti,
Nji fjalë t'vetme due me t'vetë.³⁾
O lejlek, o shpend i shkretë!

Ndoshta ti kah je tuj ardhë
Atdhen' temin e kalove,
Fushat tonë me krahë t'bardhë
Kodrat tonat i kërkove;
Ndoshta n'Dri ke la ato fletë,
O lejlek, o shpend i shkretë.

Edhe un' n'kopshtije t'mia
Nji lejlek dikur kam pasë;
Për gjith' ditë tuj m'ardhë te shpia
Para deret e kam hasë,
Vite let⁴⁾ te e mjera nanë,
Vite e lypte 'j send me ngranë.

Kënga e katërt është ndërtuar mbi figurën e njohur poetike të lejlekut, i cili zgjeron e konkretizon detajin e lotit që shihet në këngën e tretë.

1) Pash njat frymë që merr e t'bar – (me bartë). Kupto: të bën të fluturosh. Perifrazimi është i barabartë me frazeologjinë, pér shpirtin tand; pash njat shpirt, ndalu;

2) n'njikët – në këtë

3) me t'pvetë – të të pyes

4) letë – lehtë, ngadalë, si me druatje

E nanzezë nuk prito
Tqinit t'vet') me ja mbajtë besën;
E përditë me çà i teproto
Zogut t'bardhë i shtrote truesën;)
Hate e pite ashtu gjith' verës
Aj lejlek, e u falte ndërës.

Une vetë me njat fatzi
Nd' oborr t'shpisë sa herë kam ndejun;
Rishe e luejshe nëpër shpi
Pa u mërzitë e pa ia mejun.³⁾)
Nji pecë⁴⁾ t'kuqe i patë qepë
N'kambë t'errmaktë⁵⁾ që kishte repë.⁶⁾

Oh! me e pa nji ditë n'këto vende!
Me dit' aj i mjerë për muel
Me 'j mijë t'pvetuna e mijë sende
Kishe i mjeri me e rrethue.
Kish ta shof nji herë... aj vetë
Kenke ti, lejlek i shkretë.

Mirë se vjen! Vetë Perëndia
T'paska prumun ndër kto vende;

-
- 1) fqinit' t'vet — lejlekut, ishte bërë zog i shtëpisë
 - 2) truesën — tryezën
 - 3) pa ia mejun — pa rreshtur; pa pushim
 - 4) pece — copë
 - 5) t'errmaktë — të majtë
 - 6) repë — rrjepur

Se me ty lgjith' Shqyplaria
Fluturim mue m'erdh, e n'mende
T'tanë mejherë njaj dhé m'përtrihet,
O lejlek, ku shqypja ndihet.¹⁾

Ah! m'kallxo, kallxo t'vertetën,
A len dielli edhé mb'at anë?
A xhixhlojnë, si paras²⁾, n't' shkretën
Shqyptari e hyj e hanë?
A lulzojnë me lule t'ershme³⁾
Mal e fushë si n'kohë t'athershme?

Për njat plakë që me bukë t'rri, t'rriti,
M'difto, zog, a mund t'qëndrojnë?⁴⁾
A thue kambën jasht' e qiti
Ndër kopshtije që lulzojnë,
Rreth e rreth tuj lypë me sy⁵⁾
Diç që n'zemër ka pa shfry?

1) ku shqipja ndihet – ku flitet gjuha shqipe

2) si paras – si dikur, si më parë, si përpara

3) t'ershme – erëkëndshme

4) A mund t'qëndrojnë? – A mbahet, thua, nëna, a është ende
ajo në gjendje që të lëvizë, të dalë nga pragu i shtëpisë, të dalë
nëpër kopshtije?

5) Vargjet: Rreth e rreth tuj lypë me sy – Kërkon djalin nëpër
kopshtije, ku punonte, duke duruar dhimbjen, mallin e duke ndry-
dhur shëpurtin, dënesat.

Gjamët¹⁾) e saja tuj ushtue
A i kë ndi nëpër at shpi,
Kur shkon ditën tuj ankue
Nji djalë t'shkretë që e la n'pleqni?
Nji djalë t'shkretë që e mjera bori²⁾
Që n'dhé t'huej ka tretë mizori.³⁾

Atje prap n'at çerdhen tande
Ke me kthye, lejlek, n'prendverë;
Njato vende që t'i kande
Ke me i pamun edhe 'j herë!
E n'atë shpi ku askurr s'u tremë
«Fal me shëndet» m'i thuej nanës seme,

Thuej se e pashë n'udhtime t'mija;
Përtë detin n'nji shkreti;
E kurrgja n'ankime t'tija,
Përpos nanës, nuk i kam ndi⁴⁾
Thuej: për ty veç kishte drojë⁵⁾
Thuej... por çä? ti je pa gojë?

-
- 1) gjamët – rënkimë për djalin e mërguar
 - 2) bori – humbi, kurse folja e tretë në vargun tjetër merr kuptimin «zhdukur pa lënë gjurmë».
 - 3) mizori – i huaji, pushtuesi, çdo pushtues
 - 4) Përpos nanës nuk i kam ndi – Në ankime nuk kam dëgjuar veç për nënën.
 - 5) droje – frikë. Kishte frikë për nënën se mos vdiste pa e parë

Nuk kalon nji nat' e n'andërr,
 Porsi zhgjandërr,
 E shoh nanën këtu përbri;
 Me krye vjerrtë!), me lot për sy
 Rri tuj shfry
 Njat idhним që don me e gri²⁾

Ndejun m'duket prapa' te votra,
 Ku me motra
 N'dritë t'kandilit qepte e arnole;
 Por njat gaz nuk ka që i shndritte
 Kur goditte
 Petkat djalit e shendote.³⁾

Kqyrë njat vend ku mbramje rrishe,
 Kur nuk kishe
 Fije idhniimit nëpër ftyrë,
 E ngurron si t'kenke gurit,

Kënga e pestë na jep figurën e nënës. Çdo figurë zberthehet nga kënga në këngë. Përfylyimi është i fuqishëm dhe me të tjera intonacione krijojnë një kulminacion lirik, poetik prej artisti të madh të portretit të nënës e të përmallimit të tij. Të vihen re vargjet tetërrokësh dhe kombinimi me katërrokësha, të cilët krijojnë çlodhjen e dënesave poetike të të mërguarit.

- 1) vjerrtë – varur, me krye ulur
- 2) Njat idhним që don me e gri – Atë hidhërim që po e copëton, po i ha shpirtin.
- 3) shendonte – gëzonte. Kuptimi i dy vargjeve është: Nuk e ka gëzimin kur kishte djalin pranë e i rregullonte petkat.

E, pshtetë murit,
Lott i dalin rrkajë tuj kqyrë.

T'kishe dekë ma mir, o i mjerë,
Thote sa herë,
Afër nanës që t'deshë e t'ruejti;
T'kishe mbyllë me duer të mia,
Këtu te shpia,
Njata sy që mordja shuejti.

Afër vorrit tand nanshkreta,
Porsi bleta,
Ishte sjellun tuj gjimue;
E n'at bar që kishte qitë,
Për gjith dité
Ndonji lule kish kërkue.

Po nji lule, o dashtni,
Që kish bi
Për mjedis të zemrës sotë¹).

1) sote – sate, liri poetike

Shënim: Strofat: Afër vorrit tand nan shkreta

...

...

Po nji lule, o dashtuni

janë vendosur këtu sipas botimit të veprës «Juvenilja», Vjenë 1917, që ka qenë kontrolluar nga vetë autorë. Këto dy strofa mungojnë në botimin «Juvenilja» dhe vepra të tjera», mbledhur dhe redaktuar nga Mark Gurakuqi (Shtëpia botuese «Naim Frashëri», Tiranë 1964), dhe në botime të tjera, të bëra më pas. Ka mundësi që studiuesi Mark Gurakuqi të jetë bazuar në materialin e daktilografuar që ndodhet në AQSH, por kjo kopje nuk është dorëshkrimi i Mqedjes, por një kopjim nga të tjerët.

Kishe mbledhë nji fije bimet,
Që prej dhimet
M'ishte dukë se djali m'çote.

Kjo pëlhirë që vetun mbëlova¹⁾
E punova
Nat' e ditë kurr pa ja mejun,²⁾
Kishte mbëlue kocijt e mi;
Por përbri
Djalit tem i kishe ndejun³⁾

E mandej, si del nji krue
Tuj bumue⁴⁾
Rreth e rreth prej brijes s'malit,
Rrkaj' i ulen lott për rrudha.
— Nuk asht udha⁵⁾),
Nanë, m'u idhnue për t'zeza t'djalit.⁶⁾

Kur n'kët shekull n'dritë e qite,
Kur e rrite
Me njat mund që nep hitia,⁷⁾

1) Kjo pëlhirë që vetun mbëlova — Që në vetmi, mbasi e enda, e mbështolla në shul. Veprimi që bëhet fill pas endjes.

2) pa ja mejun — pa reshtur

3) i kishe ndejun — do t'i kisha ndenjur, qëndruar djalit pranë

4) tuj bumue — duke gjëmuar, duke rrjedhur vrullshëm.

5) nuk asht udha — S'është vendi të qash, s'është mirë që vazhdimesht të biesh në vaj, të jesh në hidhërim. Duro, se ka një shpresë që djali mund të kthehet, prandaj mos i zmadho të vezat, fatkeqësitet e djalit.

7) hitia — këtu; kujdesi i madh, frika se mos harrohet atdheu, por ka dhe kuptimin: nxitim, ngutje.

«Nji nanë tjetër, thoshe, ke,
Bir, n'kët' dhé,
Nana jote a Shqyptaria,

Mend e zemër për të shkriji,
E përtëriji . . .
Nam e lavd kur t'i vijë dita»')
Mbas fjalësh t'uua përherë shkova,
E t'ndigjova;
Shqyptarinë nuk e korita.?)

-
- 1) Kur t'i vijë dita – Kur t'i vijë dita që të fitohet liria,
të ngrihet lart nomi, lavdia,
 - 2) Shqyptarinë nuk e korita – Emrin **shçiptar** nuk e turpërova.

-ANDRRA E JETËS¹⁾

TRINA

I

Molla t'kputuna nji deget,¹⁾
Dy qershia lidhë n'nji rrfanë,²⁾

*) Në këtë poemë është mbërthyer filozofia për jetën. Lënda që i shërbu Mjedjes është vetëjeta me konkreten e të veçantën e saj, me idealet dhe imaginaren, me lindjen dhe vdekjen e elementeve të saj. Poeti, duke ndier thellë misionin e tij, duke i rënë ndesh misticizmit kristian, ngriti idenë iluministe për të gjuar jetën këtu mbi dhë. Në realitetin ekzistues Mjedja e ndjeu se e bukura dhe e shëmtuara janë pranë; ai pa vuajtjen dhe gjëzimin, pa dhimbjen dhe dashurinë, pa vdekjen dhe lindjen, pa rrininë dhe pleqërinë, pa nënën dhe foshnjën. Midis të kundërtave ai zgjodhi të bukurën, atë që krijon jetën, që shpreh vazhdimësinë e jetës, lindjen. Mjedja e pa jetën në një zhvillim organik. Pavarësisht nga momentet e vështira që kalon njeriu në jetë, ajo sjell progresin. Ngacmimin për këtë poemë, autori e mori nga një grua e ve, që banonte në jerevi të tij në Kukël.

1) Strofa I sjell një figurë poetike, metaforike shumë të goditur. Me pak fjalë jepet vendi dhe përbërja e familjes. Kemi një vrojtëm filozofik. Këto dy pemë që lindin frytet e tyre kanë një proces jetësor të ngjashëm me njeriun: lindin, rriten, vdesin. Por Mjedja, me anë të kësaj figure, shpreh një kuintesencë shpirtërore për jetën në përgjithësi, zbërthen jetën familjare me një strukturë dramatike e poetike.

2 rrfanë – veshë, vegjë, pupa, bishti i qershisë

Ku fillojnë kufijt e geget¹⁾
Rrinë dy çika²⁾ me nji nanë.

Kreckë³⁾ e bre përzie me lisa
Riten rrotull me çetinë,
Plepa t'but' e qeparisa,
Mbëlojnë e veshin atë ledinë.

S'ushton mali prej baktiet,
S'frym murrlani me duhi;
Paq i kthelltë prej Perëndiet,
Paq prej njerit⁴⁾ e qeti⁵⁾.

Gurra⁶⁾ e lugut veç ushtote
Si lahatë me kangë kreshnike;
E ndër pemë bylbyli këndote
Valle darsmet e fisnike.

Ngreh, bylbyl, n'at hije valle,
Ushto, gurre, trimneshë, n'shkambije;
Bulk⁷⁾ i natës, kungallë, që talle
Nëpër gemba e për lamije,

1) Geget – e gegëve

2) çikë – vajzë

3) kreckë – një lloj panje

4) njerit – njeriut

5) qeti – qetësi

6) gurre – krau, burim

7) bulk – kandërr që këndon natën, bulkth, që nxjerr një zë si
të gjinkallës

Këndoni, këndoni. Veç prej stanit
T'ardhmen Trina mbramje n'shpi,¹⁾
Tuj blegrue nji kij²⁾ mbas zanit
T'deles nanë keni me ndi.

Veç prej plehut gjel kokoti,³⁾
Me njat za që s'ndrron kurrherë,
Ka m'u igjegjë se a tuj ndërrue moti,
Se a tuj çue nji tjetër erë.

II

U ndie nji za te shtegu:
Cice!⁴⁾ del se erdh Murgjina,⁵⁾

1) T'ardhmen Trina mbramje n'shpi – Me të ardhur Trina në mbrëmje në shtëpi.

2) kij – qengj

5) gjel kokoti – Gjel që këndon bukur e gjatë. Kokoti është një epitet krahinor për këta lloje gjelash. Gjelat e parandiejnë ndërrimin e motit. Po këtu ka një kuptim figurativ, është si një paralajmërim i asaj që do të ndodhë në strofen e dytë, sëmundjes së Trinës.

Në këngën e dytë jepet ardhja e Trinës me bagëtinë. Trinë është e sëmurë. Bagëtia, e kënaqur nga kullota, lodron. Në këtë atmosferë jete, poeti evidenton bukur dhe me forcë shqetësimin dhe kujdesin nënës për vajzën e sëmurë. E gjithë kjo tablo është dhënë me ngjyra të forta e të fuqishme poetike, ku dashuria dhe mjerim i kësaj familjeje janë dhënë qartë. Është një çast blegtoresh, në muzg.

4) cice – nënë, e fofur dialektore. Në malësi të Veriut kështu, me emrin e gjirit, i thérresin nënës fëmijët.

5) Murgjina – lopë e murrme

E mbrapa po vjen Trina
Me j'qingj te Sykes¹⁾ ngryk.

E duel me mjelcë²⁾ te burgu³⁾
Lökja, nxuer viçin jashtë,
E Shega⁴⁾, e letë si kashtë,
Tuj kcyemun e bërlyk,⁵⁾

Iu suell oborrit rrotull
Tu u hqedhë me bisht përpjetë;
Derisa plaka vetë
Rrshanë⁶⁾ tu Murgjina e çoi.

Moli, tuj këndue, lopën,
Tuj pritun viçin prorë;⁷⁾
E tambli, bardh si borë,
Përbrenda mjelcës ngufoi⁸⁾,

1) Sykë – emri i deles që ka sytë të qarkuar nga një rreth i zi ose fytyrën me shenja

2) mjelcë – enë e drunjtë për të mjelë dhentë, enë ku hidhet qumëshти

3) burg – ahur

4) Shega – emër lope, lopë me brirë të kthyer përpëra. Këtu ka kuptimin: viç.

5) u bërlyk – u zhgërrye përtokë duke bërtitur

6) rrshanë – zvarrë

7) Tuj pritun viçin prorë – Duke ndaluar viçin gjithnjë (për çdo çast)

8) ngufoj – gufoi, u çua përpjetë

Mandej muer krijin pezull,
E u vu me Syken n'sanë,¹⁾
Sa çote tamblin anë²⁾)
Zoga me nxe dopak.

Muer edhe krande³⁾ e cokla⁴⁾
E Trinkën muer përbri;
Ish lodhë: i dhimbte nd'ije,
E kishte mollzat gjak.

Vuni do krande n'votër
E fryni n'zjerrm që ish ndalë;⁵⁾
Thei⁶⁾ pshesh me tambël valë,
E mbushi kupat plot.

Pshesha me kollomoqe,
T'mirë edhe për zotni,
Kur don për rob e shpi
Me i fal' i madhi Zot.

1) sanë – bar i thatë

2) anë – dhoma e zjarrit

3) krande – karthje të vogla, shkarpa

4) coka – copëza drush, ashkla

5) ishin ndalë – ishte në të fikur e sipër, vetëm me prush.

6) – thej – thyej. Kjo fole e përdorur këtu në vend të foles thërr-moj është shumë e ashpër, por shumë e goditur, shumë domethë-nëse. Ajo flet për një bukë të fortë misri, për një uri, për një varfëri të plotë

É hángri Žoga shishém,
Por Trina s'hangri gja,
As Lokja, që ishte vra,¹⁾
Mbas çikës, nuk hangri dot.

Por tirte ndejë te votra,
Tuj kqyrë me zemër t'plasun;
Tuj nduk' at shllungë të rrasun
Lu mbushshin syt' me lot.

Kur nji mbas nji pranë zjerrmit
U lodhne gjumit fëmija,
U çue, e t'dy, si kija,
Mbi t'shtruemen²⁾ i vendoi.

E tirte prap te votra;
Pej tirte pér xhubleta,³⁾
E i dukej se tu këneta,
Se n'shpella me drangoj,

Tirshin dhe shtojzovallet
Tuj luejtë pa mejun gishtat;

1) ishte vra – ishte merakosur, ishte trishtuar pér Trinën e sëmurë

2) t'shtrueme – shtresa

3) xhubleta – Fund i trashë leshi që veshin gratë e malësisë.

Siellshin me pleq ferishtat;
Ndoshta edhe fëmijnë e vet?¹⁾

E shkoi me i pa, tuj pritun
Dritën e pishës me dorë;
Ngrykas, si dy qiellose
Me krahë pa pupla, i gjet.²⁾

III

Cice, shka ka sot Trinka
Që po priton m'u çue?
Zgjoje me dalë me mue,
Me lëshue baktinë e vet.

1) Strofa e parafundt ka një motiv bestyrtie, sipas së cilës shtojzovallet kanë në dorë fatin e njerëzve. Kur këputet peri, ata vdesin.

2) Strofa e fundit është një pikture mjeshtërore artistike e një familjeje, pjesëtarët e së cilës, ndonëse në mjerim, i lidh një dashuri e fortë familjare. Detaj i hollë i kësaj tabloje, ku Lokja pret, mbulon me dorë dritën që mos u prishë gjumin fëmijëve, kur vdekja peshon mbi Trinkën. Ndërkaq përfytyrimi i Trinkës si engjëll mënjanon fjalën vdekje, që Mqedja artist do t'ia lërë vetëm Lokes. Përqafimi i të dy vajzave që ngrohin njëra-tjetrën, është një tablo ekspressive dhe domethënëse. Trinka vdes në krahë të Zogës në gjumë. Tablo ngjethëse mjerimi, pafajësie dhe dashurie. Në këngën e tretë jepet zgjimi i Zogës, e cila pret të ngrihet edhe e motra, si çdo ditë. Por Trinka ka vdekur. Zoga nuk e kupton dot këtë humbje. Mbi këtë naivitet fëmijëror është zhvilluar tërë kënga. Këtë pjesë Mqedja e ka shkruar më 1890 me titull: «Po shkon me bujtë te Zoja», të cilën e ka futur në mbylljen e pjesës së parë të poemit me titull «Trina».

— Bij, mos e prek, se njomja
Tash a tuj folë me Zojën;¹⁾
Len zan²⁾) e mos cil gojën
Se e lumja Zojë t'bërtet.

Qe prifti, nanë, qe dajat
Mbas tij, me qiri, n'dorë;
Katundca³⁾ me malcorë
Sa shpia nuk i nxë.

— Rri, bij, se sunte⁴⁾ Trinka
Po shkon me bujtë⁵⁾ te Zoja;
Merri këto lule e çoja
Së lumes dhunti për të.

1) Zoja — Shën Mëria

2) len zan' — mos fol, hesht

3) katundca — fshatarë, malësorë

4) sunte — sonte

5) me bujtë — shkoj mysafir, për të ndejë disa kohë.

Z O G A *)

I

Npër ograјë po këndoјnë bylbylat
Si tu' u prallë¹⁾ me shoqi-shoјnë,
Drandofillave zymbylat
T'kandshmen erë dhunti u çojnë.

E nalt n'qiell ma e bukur hana
Reze t'paqta shkon tuj shkri;²⁾

Kjo pjesë është e perceptuar në katër këngë, të cilat kanë një bosht, jetën dhe vazhdimësinë e saj. Në këngën e parë dhe të dytë jepet ëndërrimi i Zogës për dashurinë dhe mërtesën, ndërsa në këngën e tretë dhe të katërt jepet martaşa dhe familja, pralindja e fëmijës. Kjo pjesë është një pasqyrim i fuqishëm i ndjenjave rinore, ëndrrave, dëshirave të Zogës; është një shpërthim harmonik i pasioneve rinore në ekstazën e dashurisë.

Në këtë këngë jepet pranvera, ardhja e saj si një paralelizëm me shpërthimin e ndjenjave të Zogës.

1) si tu' u prallë — si duke u çmallur, duke u përkëdhelur në çuçurima.

2) tuj shkri — duke u derdhur, përhapur

Maje bjeshkve fillon zana
N'valle shoqeve m'u pri.

Lodhë prej vegjësh¹⁾, prej rranjesh²⁾ shpijet,
Si u ba natë, ndej Zoga n'votër;
Ndej m'u nxë me dru dullijet
Që kish ba npër mal, pa motër!

E kuvendte me nanë locen,
Si përgjumshëm, ndonji fjalë,
Derisa bri votrës gocën
E muer gjumi dalkadalë,

Fjet bri votrës; e kur shkëndija
Shdritte at fëtyrë të patravajë,³⁾
Ejëll⁴⁾ prej qiellet ulë te shpija
Dukej faret fëtyra e sajë.

Herë n'at igjumë tuj qeshun dukej,
Si m'u falë herë dorën çote;
Herë përmallshëm n'vedi strukej
E n'fëtyrë gjaku t'tanë i vëlote.

1) vegësh — vegjët e tezgjahut

2) rranjesh — (nj. rangë, shumësi i rregullt — rrangët) punët e shtëpisë.

3) e patravajë — e pafajshme

4) ejell — engjell

(Ngrimun n'ar, mbi 'j pullali¹)
Nën balkue nji beg²) kish dalë;
Hollë e i gjatë porsi selvi
N'rrugë nën gardh ish dukë nji djalë.)

E nanbardha tuj shikjue:
«Flej me engjuj, thote, o bi',
Pusho shtatin me i ndimue
Lokes sate nëpër shpi.»

||

Prej nën nji tjegllet kish dalë si 'j tra,³)
Ku nji mij' tesha⁴) vëloshin pa da;
Përmbi shpi ndihej tuj rrahun troka⁵)
E ushtote toka

Prej kambësh t'baktive. Ka dalë Harapi⁶)
Heret, e shpatit delet ia hapi;

1) pullali – kalë i larmë pulla-pulla

2) beg – në kuptimin: djalë fisnik, i hijshëm, i veshur bukur
Kënga e dytë e jep Zogën më të rritur, me një ndjesi e
ëndërrim më të fortë erotik.

3) Vargjet 1, 2 të strofës së parë japid figurën e depërtimit
të një rrezeje dielli nëpër një tjegull të thyer të çatisë, e cila
ngjan si tra. Si rrjedhim, aty edhe duket pluhuri, grimcat e sen-
deve që lëvizin. Ky shkumë drite theyn atë gjysmëerrësirë dho-
mash malësore.

4) tesha – sende, pluhur, grimca

5) troke – këmbona e deleve

6) Harapi – embër bariu i dhenve

Ka dalun Mica¹⁾) me lopë të mëdhaja
Nëpër ograja.

Kur u zgjue Zoga vojt te balkoni,
E pau se bleta vëlote te zgjoni;
Pau se n'at nade²⁾ poshtë nji lavruer³⁾
Kish ba nji shpuer.⁴⁾

Tuj sjellun krahnin këndote me vedи,
E i rridhte krahve si nji valë dedi,
Ku shndriçëm dielli lëshote si zhgjeta
Rrezet e veta.

Reze, flakë arit, Por rrrotull fëtyra⁵⁾
E fushës kish ndrrue; kish ndrruemun zyra⁶⁾
E bimës e e pemve; përmbi balkue
Deri kish ndrrue

1) Mica – baresë e vogël. Kuptimi është figurativ. Të dy, bariu dhe baresha pohojnë një çift, ashtu siç pohon tundim e dashuri zymbili e trëndafili. Pra, të gjitha këto flasin për ëndrrën dashurore të Zogës. Pohojnë bashkimin e saj. Një paralelizëm. Element i natyrshëm idilik, fshatarak.

2) nade – mëngjes

3) lavruer – bujk

4) Kish ba një shpuer – Kishte përfunduar një rrip toke të punuar. (një shpor uji, do të thotë: ujë sa të ujitetës një tokë të vogël.)

5) Strofa..., Por rrrotull fëtyra / E fushës kish ndrrue::: – jep një moment psikologjik. Gjithë ky ndërrim në natyrë ka sjellë dhe një ndërrim te vetë Zoga. Përparrë syve të vajzëds tanë natyra përftohet ndryshe. Ajo e sheh atë me ndjenjat dhe kënaqësinë e vetvetes, të ndjesive të saj.

6) zyra – puna

Erë filcigeni¹⁾ po i vite 'j tjetër
Erë: porsi makthit²⁾; E rruga e vjetër
Nën shpi, mbas gardhit, por si një dritë
Shkote tuj qitë.

Nuk e kish vrumun³⁾ kurr ndër dit' t'veta⁴⁾
At rrugë n'balkue. Ktheshim me çeta⁵⁾
Asajt⁶⁾ katundsit tuj dalë papra
E ajo s'kish pa.

U nis te puna mërziçëm.⁷⁾ Nisi
Ndër pej sovajkën,⁸⁾ e shpata⁹⁾ krisi,
Cirlikne¹⁰⁾ rrrotllat poshtë e përpjetë
Nën kambë të shpejtë.

1) filcigeni – borzilok. Për të kuptuar edhe më mirë figurën e dy luleve: filcigenit e makthit, duhet të theksojmë edhe dallimin e tyre. Filcigeni mbahet në saksi, për hijeshi dhe erë të mirë, kurse makthi mblidhet fushave, futet në mes të teshave në arka, sidomos aty ku ka filluar paja. Prandaj vargu – Po i vite 'j tjetër / Erë porsi makthit..., flet për Zogën në përftimin e ndjenjës së dashurrisë.

2) makthi-lloj luleje e verdhë e me aromë e ngjashme me trëndelinën. Në malësi e vënë nëpër arkat e rrobave për aromë. Është parfumi i nuseve malësore.

3) vrumun – vënë re

4) ndër dit t'veta – asnjëherë

5) çeta – grumbuj

6) Asajt – andej, nëpër të, andej parit

7) mërziçëm – Fillon të punojë e mërzitur; sepse ëndrra s'po i realizohej.

8) sovajkë – meçik, gjepi i tezgjahut

9) shpata – krehri ku futen penjtë për të bërë pëlhirë

10) cirlikne – folje, onomatope që jep krismën që bën vegla kur punon.

E vojt n'dritore prop. Ndoshta begu
Ka mbërri te rruga e prêt te shtegu
Veshun me t'arta, mbi 'j pullali
Për bukuri.

Nuk ishte begu: nën diell t'valtë
Veç dy dallëndysha bajshin do baltë,
Balt' e kashtare për çerdhe t'vet,
Se shën Ejëlli a nget.¹⁾

Ndoshta po avitet nji djal' i ri,
I holl e i gjatë porsi 'j selvi,
Me rryp rrëth brezit, me nji gjashtore²⁾
E' j kacatore.³⁾

Nuk erdhi djali; veç dy bylbyla,
Nji n'drandofille, nji ndër zymbyla,
Përmallshëm thrrasin, e shoqi-shojnë,

Me kangë gazmojnë.

-
- 1) Shën Ejëlli a nget – Shën Engjëlli është afër, pra fillon pranvera (dita e 24 marsit, dita e rrushajave).
2) gjashtore – revole me gjashtë fishekë. Nagant.
3) kacatore – pushkë e gjatë

III

Vijnë dallëndyshat porsi era
 Përte' det¹⁾ te çerdhja e vet;
 Vijnë bylbylat ku prendvera
 N'pyje t'veshuna po i thrret.

Se qe pemët kan endun lulet,
 E u vesh fusha me blerim;
 Letas prroni malit ulet
 Da prej borës që i nep ushqim.

E, i dishruem, bje për fushore
 Me rritë bimën për gjithë vend,
 Ku 'j erë akullit mizore
 Kishte hupë²⁾ lulzim e shend.

Edhe ti pre' asaj që t'rriti
 Ndaju, vash', e mos vajto;
 Me nji veshë, që kurr' s'ta shndriti
 Paras³⁾, shtatin hijesho.

Në këngën e tretë jepet martesa e Zogës. Këtu ndihen shpërthime poetike, ku shpaloset pasioni e gjëzimi. Vargjet lidhen përmes një note urimi prindëror, ku plekset dashuria, malli, dhimbja e ndarjes dhe njëherazi gjëzimi. Kënga përbën edhe nota intime familjare edhe gjësim të gjithë mjedisit, fshatit ku është rritur vajza.

1) përtë det – përtej detit

2) hupë – humbë

3) paras – më parë

Bashkë me lule len dashtnia,
Me kangë t'shpredit që galdon;
E prendverës bukuria
Bashkë prej gjumit t' t'anë i zgjon.

Del, o bijë, prej shpijës sate,
Del prej t'vorfënit katund;
Njajo flakë që n'zemër pate
Do t'përcjellin tjetërkund.

T'pret nji zemër flakë e shkëndija,
Pret me tandem m'u ba nji;
Sa jetë t'apin Perëndia
Mos m'u damun kurr prej 'si.

T'lypë nji bes' e ta nep t'ndershme
Dora e unaza që t'ven n'gisht;
E ndërmjet pr' at besë t'gjithhershme
A dorxanë i Lumi Krisht.¹⁾)

Sogjetarë, porsi furia
E nji rrëfesë që qetat²⁾ shpon,
Janë të qiellit nalt ushtria
E n'dorë shpata ju veton.³⁾)

1) dorxanë – garant. Moment i ceremonisë së martesës sipas botëkuptimit fetar të kohës.

2) qetat – shkëmbinj

3) Vargjet 3-4 strofa 9 mbrojtësit e dashurisë së dy të rinjve janë engjëjt, që nuk e falin tradhtinë bashkëshortore. Janë ruajtës të saj.

E din idhun regj Daviti¹⁾
E dinë lott që papra qet,
Kur shef morden se kositi
Anembanë krajlninë e vet.

IV

E kandshme asht hana.
Kur del me zana,
E n'tokë me dritë përndaret.
Hyzit që shndrisin
E që shëtisin
Npër quell, janë t'bukur faret.

Kur del agimi
E rrizuullimi
Me 'j dritë kuqloshe mbëlohet,
E përmbi kashta
Shndrit pika lashta,²⁾
Zemra për mall gazmohet.

Asht i madh shendi,
Kur ndihet shpendi

1) Davidi – mbret i Izraelit i cili e tradhtoi të shoqen. Mbretëria e tij u shua nga ky shkak.

Në këngën e katërt jepet Zoga – nënë. Është lindja e jetës dhe vazhdimësia e saj, është himni i ndjenjave më të pastra. Këto vargje mbartin dashurinë dhe mallin e fuqishëm për familjen, mall edhe i vetë poetit.

2) lashta – vesa

Ndër pyje tuj pingrue;¹⁾
E knaqshme a 'j lule
Kur ju përkule,
O fllad i let, me e lmuë.

Por s'i giet qelli,
Nuk i giet prilli
As fllad që shëtit lulet
E me erna veshet,
Foshnjës që i qeshet,
Nanës, kur mbi të përkulet.

1 pingrue – duke kënduar

LOKJA *)

I

E n'balkue mbaruene lulet:
Shurdh' a vendi¹⁾ e shpia tytë²⁾;
Jo, me Loken nji e dytë
Nëpër shpi ma nuk u gjet.

*) Kjo pjesë ështëjeta e Lokes pas largimit të Zogës. Vëtmia dhe vdekja e saj përbëjnë një linjë të natyrshme e jetësore. Ajo vdes, si rrjedhim i një jete që mbaron, porse familja e saj nuk shuhet, sepse ajo jeton përmes Zogës që lind

Kënga e parë na jep vetminë e Lokës, po aty dhe dëshpërimin e saj, sepse nuk ka fëmijë me shtëpia. Këtë gëzim do t'ia jep te djali. Tani, më shumë, se kurrë, ajo ka nevojë për t'i shërbbyer dikush. Lokja ka nevojë ta harxhojë kohën me një shërbim të vlefshëm karakteristik: të rritë fëmijë. Edhe toni i poezisë dhe vargu ëhtë i ndryshëm, ka një notë stoicizmi dhe dhimbjeje, por jo përkulje, thyerje. Përkundrazi, është një dashuri për jetën.

1) Shurdhë vendi – Rreth saj nuk dëgjohet gjë. Vëtmi e plotë.

2) tytë – e zbrazët boshe. Jo vetëm në këtë strofë, por në gjithë këngën jepet ideja se s'ka gjë më të rendë, kur në një shtëpi mungojnë fëmijët.

Vetun zbardh e vetun erret
Me krye n'hi e shuemja¹⁾ plakë;
Nji dorë krande me i ba flakë
Përmbi votër kush s'ia qet.

E disprohet me vetvedi
Që nuk bani currnji djalë:
Sot e reja²⁾ i kish dalë
Bashkë me dritë³⁾ për dru në shpat.

Kish mbajtë zjerrmin ndëre mbi votër,
la kish njomë njat buk' e mjera;
Edhe Lokja me gjith' tjera
Kishte dalë me petka n'shtat.

Kish shkue motin si prendvera
Me ndo'j fëmi tu' e kalamendun;⁴⁾
Ishte knaqë tuj e përmendun⁵⁾
Tash e tash ferishta⁶⁾ n'djep.

E disprohet ke i ve mendja
Or' e ças te Trina, e shkreta!
la lyp mordës n'ankime t'veta,
Por mizorja nuk ia nep.

1) e shuemja – e mjera, e gjora

2) e reja – nusja

3) Bashkë me dritë – në agim

4) me kalamendun – përkund kot, vë për të fjetur

5) me përmendun – thérres, zgjoj prej kujtimeve, ia heq vëtminë

6) ferishta – njomëzak kërthi, foshnjë

II

U shty vjeshta e krisantemi¹⁾
Vetun vorreve lulzon;
Landët e pyje²⁾, gjith ku kemi,
Tuj fry veri po i cungon.

Ndrron prej dimnit landa veshen,
E lëshon gjeth që para pat;
E, për mëshirë, duhitë³⁾ që ndeshen
la çojnë t'vorfnit me i ba shtrat.

Bite borë e fryte veri
Tuj çue akull për gjithë vis;
Nalt orteku ushton për mneri⁴⁾
Tuj fundue⁵⁾ çetinë e lis.

Me dy cokla n'votër plaka
Rri gjithë natën e vajton;

Kënga e dytë është dhënë në peizazhin dimëror karakteristik të bjeshkëve, që në përgatit për vdekjen e Lokes. Ajo krijon një paraleлизëm të gjetur dhe të jep tablonë e atij fundi tragjik, i cili është përherë pohues për vazhdimësinë e jetës.

1) krisantemi – bimë, lule e larme që rritet zakonisht nëpër varre dhe del në vjeshtë.

2) landët e pyje – lëndët e pyjeve

3) duhi – erë e fortë

4) mner – tmerr

5) tuj fundue – duke fundosur

Rri me duer kah ndezet flaka
Porsi nieri kur uron.¹⁾

E shikjon nji dritë t'venitun,
Vron²⁾ pasqyrën e jetës s'vet:
E larg Morden tuj kositun
E kujton e pran' e thrret.

U ndie 'j frymë³⁾ përbrenda shpijet
Porsi erë që vjen pa shkas;⁴⁾
E, n'at muzg, nji vegim hijet⁵⁾
Lokes n'votër let' iu qas:

Përmbi plakën krahët i uli
E ngryk t'shuemen e shtrëngoi;
Buzët t'shpulpueme⁶⁾ n'ball' ia nguli;
U ndal drita e ajo mbaroi.

1) uron — në këtë rast: lutet; Zjarri po fiket e ajo s'ka fuqi t'i shërbëj, l mbetet vetëm lutja që të mbajë sa më gjatë zjarrin.

2) vron — Vrojton jetën e saj të mjerë, të venitur, si flakë e qiriut.

3) frymë — përfytyrimi i vdekjes si një frymë (e padukshme)

4) pa shkas — pa shkak

5) vegim hijet — mortja

6) buzët e t'shpulpueme — buzët që s'kanë më mish (Vdekja përfytyrohet si skelet, koka e saj si kafkë), eufemizëm.

I MBETUNI*)

Edhe shtaza po gazmohet,
Edhe bari mungullon;!¹⁾
N'shend natyra gjith' po çohet,
Veç ti, i mjeri, po gjimon.

Kang' e valle tuj bashkue
Shend prej gojet gjithkush qet;
Veç i vorfni tuj dertue²⁾
Porsi i huej a n'gjini t'vet.

Tuj ankue për t'zeza t'veta
Për gjith'derë tuj lypë kerset;
Për të t'dhimtun kurrkund s'gjeta³⁾;
Porsi i huej a n'katund t'vet.

*) Vjersha është shkruar në 1888 në Kremona. Varianti i parë titullohej «Jetimi». Pastaj «I vorfni». Në botim poeti e titulloi «I mbetuni». Motivi i lirikës është imagjinar dhe vetë lirika është sentimentale. Është botuar për herë të parë te «Shahiri Elierz» prej J. Jungut.

1) mungullon — mbin

2) tuj dertue — duke u ankuar

3) t'dhimtun — dhimbsuni. Njerëz që të kenë dhimbsuri nuk gjeta.

Lodh' e unshëm, kur vjen nata,
N'prehën t'nanës me shkue kujton;
Edhe nana i diq e ngrata,
E kush t'vorfnin s'e ngushllon.

Bob', oh! babë sa herë ndo 'j trimit¹⁾
Do me i thanë tuj derdhun lot;
Por për tene²⁾ a fjalë trishtimit,
A nji fjalë që përmend kot.

Për dhe t'vet tuj dalë n'ushtri
Rebtë qëndroi i ati e diq;³⁾
Sot i vorfni askun nji shpi,
Nji copë buk' s'e gjen ndër miq.

Ah! ti njome, o njome⁴⁾ e mjera,
Dit' e natë që po vajton:
Kund ndër miq nuk t'çilet dera,
Kurrikush vajin s'ta pajton.

Dit' e natë pa bukë e shpi
Shkote i vorfni andej e këndeje,
E prej t'pasunish zotni
Nji fjalë t'mirë kurrikush s'ia kthej.

1) trim — burrë në zë, i njohur për karakter e burrëi

2) për tene — për të; për atë

3) I ati është vrarë për atdhe. Fëmijët e tij kanë mbetur pa kujdesje. Rilindësit e kanë pasur objekt të shkrimeve të tyre këtë problem.

4) njome — fëmijë i vogël, ende i parritur mirë

Jetimi). (ll. 1. 2 ~~mbetuni~~;

Lëtë shqip që gjyqtar.

Lu keni ~~zgjedha~~.

Në shtësi nati është që kthehet,

Përballë d'vini që gjemini.

Ding e vole lë bëhet
~~lu keni zonja gjemini; jas~~

Përditë ~~zot~~ që e vole

~~gjatë gjatë~~ që e vole.

Ezni mëtë që ~~lë~~ që e vole
~~zot~~ që e vole, që e vole po qend.

~~zot~~ që e vole që e vole;

~~zot~~ që e vole, që e vole;

~~gjatë gjatë~~ që e vole.

Faksimile e një dorëshkrimi të Ndre Mqedjes

(Tri strofat e para të poeziës «Jetimi» që u titullua më vonë «I mbetuni»)

Ku ke babën me t'ndimue?
Ku ke nanën me derdhë lot?
Ty gjith' robi¹⁾ t'ka harrue,
Kurrkush s'do me t'dalun zot.

Tuj ra borë, tuj fry murrlani.
Mjet²⁾ dy vorreve si 'j lis,
Afër gropës që vet' e bani
Djali i vorfën u molis³⁾).

Afër nanës u shtrue me fjetun,
Afër babës kërkoi pushim;
Kurrgja t'ngritin⁴⁾ s'ka me e gjetun,
T'nxet; e t'ftohtë s'kan' me pasë ndrrim.

.....
.....
.....
.....

Kremona, 1886

1) robi — njerëzit, gjindja

2) mjet — në mes

3) molis — u venit, u mek

4) t'ngritin — të ngratë, të shkretë

S H T E G T A R I *)

Nëpër male e nëpër fusha
Pa pushue, pa xanun vend,
Përpin rrugën si harusha
Nji shtegtar me gjith' gazmend.

As katundi ma i pëlqyeshëm,
As qyteti nuk e pret;
Porsi 'j zog merr rrugën rrëmbyeshëm
Shpejt e shpejt për vend të vet.

Dit' e natë thekshëm¹⁾) tuj shkue
Nëpër dhena mbetun shkret,

*) Lirika «Shtegtar», shkruar më 1888, pasqyron skamjen e njerezve të thjeshtë. Megjithatë, tragjiciteti i kësaj poezie tingëllon i kërkuar. Por qoftë lirika «Jetimi», qoftë lirika «Shtegtar» janë të lidhura me katundin, me atdheun, me dashurinë e pakufishme përvendlindjen.

1) thekshëm — me ngut, me të shpejtë

Kurrgja s'mujti me e hetue¹⁾
Tuj ba rrugë për vend të vet.

N'pikë të zhegut nën ndo'j hije
Ndej prej s'nxetit që e pëlset;
Por me t'shpejtë u vu për fije²⁾
Tuj ba rrugë për vend të vet.

Bajshin darsma nëpër shpija,
Lutshin festa për katund:
S'ju di darsmave hitija,³⁾
S'e pret festa jo kurrkund.⁴⁾

Fest' i dukej ndër ma t'mirat
Shpia e vogël që dishron
Shend⁵⁾ i baheshin të vshtirat
Tuj shpejtue për shpi që don.

Mbas nji fushës e përtë malin
T'mjer' shtegtarin shpia e pret;

1) Kurrëga s'mujti me e hutue – Përpara atdheut, atij s'i hyri në sy asgjë nga ato që hasi në vend të huaj.

2) për fije – në kuptimin që mundi çdo vështirësi, çdo lodhje, e mori veten.

3) hitia – nxitimë

4) S'e pret festa jo kurrkund – Nuk ia presin rrugën dot festat.

Është një varg që pohon largësinë e shtegtarit në distancë dhe në kohë.

5) shend – gjëzim

Tuj e pritë, të dera dalin
Për gjith' mbramje robt e vet.

E shikojn' gjithkah merr syni¹⁾
A po duket baba kund;
Dersa nata mbrendë i ndryni,
Kur xhixhlojshin dritët n'katund.

Ec, hitat²⁾, shtegtar i ngriti,³⁾
Se mbas fushës që mbaron,
Shpia jote gati mbërriti,
Shpia jote që flakron.

N'buzë të mbramjes për një breshtë⁴⁾
Aj shtegtar pa dijt⁵⁾ u gjet.
Kur për s'larg ndër lisa t' shpeshtë
Za i venitun n'vesh i vret.

Vojt e syni⁶⁾ kah del gjama
Pa medue për shpi të vet;
Nji grue shëtri ku u çilte lama
E dy fëmijë përbysun gjet.

1) kah merr syni – nga të gjitha anët

2) hitat – shpejton, nxito

3) i ngriti – i mjeri, i gjori

4) breshtë – pyll bredhash

5) pa dijt – papritur

6) vojt e syni – mësyni u drejtua me të shpejtë

Zemërdhimbshmi tuj u afrue
Kqyr kush ishin me kujdes:
Lu muer fryma, n'fëtyr' u ndrrue
E ra n'tokë porsi kush des.¹⁾)

Shum dit pritne ani²⁾ prej fisit³⁾)
Me i dalë para u nisne truç;⁴⁾)
N'rrugë mbet grueja bri nji lisit,
Edhe fëmija ranë Imuç.⁵⁾)

Tuj ba rrugë ne e nesre shkotë
Nji zotni për at t'zi vend;
Gruen e fëmijt përbys i mbëlote
Njaj shtegtar pa gojë pa mend.

1888

1) Porsi kush des – Si bie një njeri i vdekur

2) ani-pastaj

3) prej fisit – njerëzit e fisit

4) truç – grumbull

5) Imuç – përbys, pikë e përdhe

VORRI I SKANDERBEGUT*)

Diq i Madhi¹⁾): askund n'ushtri
S'e shef ma jo kurr mizori;²⁾
Reptë si para s'shndrit, Shqypni,
Njajo shpatë që sa herë xori.
Frik' e mnerë kurkund s'na mbeti
Qyshse ne na u rrxue qyteti
E gjith' fisin e rrënoi.

*) Lirika «Vorri i Skënderbeut» (1886-1891) ka në qendër figurën e Skënderbeut dhe është një grishje për luftë kundër pushtuesit si në kohën e lavdishme të shek. XV. Evokimi i së kaluarës heroike të popullit tonë, kryesisht periudha e Skënderbeut, ishte për të gjithë rilindësit tema bazë e veprave të tyre.

1) I Madhi! — Skënderbeu i Madhërishëm.

2) mizori — turku.

Ðiq: vorfnisht n'njat vorr a mbëlue')
 Pa lumni ma i madh luftari;
 Fisi jonë me të u rrënue,
 Me të diq për luftë shqyptari:
 Bashk' n'at vorr a mbëlue Shqypnia
 Derisa ta thrrasin mnia²⁾)
 Me e tha dorën që e turpnoi³⁾)

Si krismë luftet gjith⁴⁾ u hapte
 Nëpër fushë të njatij vorrit;
 Kush për terr andej u kapte⁵⁾)
 Ndijtë 'j duhmë si duhmë toborit,⁶⁾)
 Shoqe m'shoqe shpata kristë,
 E kalorë, ushtri që u niste,
 Merrshin hovin për at vend.

1) Konceptimi i Vorrit të Skënderbeut si zemra e kombit, theksimi i forcës e i lavdisë së tij, përbënë gjithë kuptimin e strofës së dytë, e cila është një ballafaqim që autori kërkon t'i bëjë asaj periudhe kryengritëse dhe periudhës kur jeton ai dhe lëvizja e popullit shqiptar është e fashitur. Autori për ta vënë periudhën e tij historike në sedër përpëra epokës së Skënderbeut, përdor figura të tillë: «Fisi (kupto: kombi) jonë me te u rrënue. Me të diq për luftë shqyptari» dhe vjen pastaj në një përfundim të fuqishëm: Bashkë n'at vorr a mbëlue Shqypnia» duke theksuar kështu në superlativ idenë: «Çohuni! Rrokni armët»

2) Derisa ta thrrasi mnia – Derisa të lindë e të bëhet e fuqishme urrejtja për armikun.

3) Me e tha dorën që e turpnoi-Derisa ta shkatërrojë armikun, pushtuesin.

4) gjithë formë e shkurtueme: gjithkah

5) Kush për terr andej u kapte – Ai që kur errej gjendej ose qëndronte aty.

6) Ndijtë 'j duhmë si duhmë toborit – dëgjonte një duhmë si duhmë (gjëmim) ushtrie.

Edhe u dukte se luftole
 Shpirt me shpirt për ato fusha;
 Trupi n'vorr ndoshta u shkote!¹⁾
 E ata u hidhshin si harusha.
 Lypshin luftë për vende t'veta,
 Për djelmnji çalltore²⁾ si zhgjeta
 Tym e flakë lypshin me shend.³⁾

Larg e larg do britma ushtoshin:
 Varza e gra me flokë të shprishun
 Afër vorreve u rrethoshin
 Tuj ba vaj e tu' u dermishun⁴⁾
 Kjajshin t'mjerat se temeli
 I atdheut u tund e i shkeli
 Kombi i huej nën kambë të vet.

E nget⁵⁾ vorrit t'Skanderbegut
 Rrite 'j zojë⁶⁾ me futë në krye;
 Prej mesnatet e n'pikë t'zhegut
 Shqyptaria rri tuj shfrye;
 Tuj derdhë lot e tuj vajtue

1) Trupi n'vorr ndoshta u shkote – De të vdisnin duke luftuar.

2) çalltore – të shkathët, të hedhur, të zgjuar.

3) Tym e flakë lypshin me shend – Djem që shkojnë në luftë me gëzim. Këtu nxjerr në dukje një nga tiparet karakteristike të shqiptarit: trimërinë.

4) T'u u dermishun – Duke gjërvishtur fytyrën për të rënët

5) nget – pranë

6) zojë – Është përfytyrimi i Shqipërisë. E tillë është dhënë në letërsinë e Rilindjes Shqipëria.

Rreket¹⁾ t'dekunin me zgjue
Që ka n'ball': *lumni, pushtet.*²⁾

E prej vorrit t'ktij farë trimit
Merrte uzdajë për vedi e mjera.
Te ky Iter³ i dashunimit
Niste djelmt për luftna tjera.
Njitu shpesh u cil ushtria,
Njitu i njifte trimënia
Komb't e huej me i ndalun n'cak.⁴⁾

Rreth e rreth ma e kandshmja erë
Drandoilleve u ndihej,
E n'kët' vorr t'shugruem⁵⁾ n'prendverë
I natyrës gazmendi shihej:
Lott e shendin e Shqyptarit
Njiky vorr i dite s'parit,
Njitu shfryte i ri e plak.

Çou, o trim, e mbi t'tu vllazën
Sielli sytë që xhixhiloshin;
Kqyr sa kobe n'ta po shprazen;

1) rreket – përpiqet, mundohet

2) Vargjet e fundit të strofës 6: Shqipëria të zgjojë Skënderbeun (të rënët), në ballë të të cilit është shkruar: Lavdi, Pushtet

3) Iter – altar

4) n'cak – në kufi

5) t'shugruem – të konsakruar

Kqyr sa kombeve që t'droshin
Sot mbi ne ju mbet paria.¹⁾
Jo, t'baj be, s'a kjo Shqypnia
Që ti rrite me krah tand.

Sado²⁾ mue ma rrit trimninë
Forcon krahin me luftue;
'e gjak tem une Shqypninë
Prej kso kobesh due me pshtue.
Me kët' parzëm un' anmikun
Do ta pres, derisa t'fikun
Ta shofë bota kand e kand.³⁾

1886- 1891

1) Sot mbi ne ju mbet paria — Sa kombe që të kishin fri-kën, mbi ty mbetën të parë.

2) Sado — sadoqoftë

3) Ta shofë bota kand e kand — Autori në këtë varg shpërthen si poet dhe si luftëtar që është gati të bëjë çdo sakrificë e të marrë pjesë në luftë për lirinë e atdheut.

MAHMUD PASHA^{*)}

në Mal të Zi

M'kamb' o Shkodrë, o nan' e drangojve,
Lé prej grykës t'martinës,¹⁾ prej çelikut!

^{*)} Mahmud pasha është i familjes feudale të Bushatllinje. Mendohet të ketë lindur rrreth viteve 1749-1754. Që nga 1776 ai ka drejtuar Pashallëkun e Shkodrës për afro njëzet vjet. Synonte për shkëputje nga Turqia. Ai kishte marrëdhënie me shtete kryesore të Evropës si me Austrinë, Rusinë, Francën. Fuqinë e mori pas vdekjes së të vëllait të madh, Mehmet pashës. Ishte prijës i një ushtrie që numëronte mbi 30 mijë këmbësorë. Energjik, i aftë, ai mbetet një nga figurat e rëndësishme të kësaj periudhe. Lufta e zhvilluar në Mal të Zi u përket viteve 1776. Në këtë luftë Ibrahim pasha me forcat mirditore nuk arriti t'i vinte në ndihmë në kohë. Kara Mahmud pasha luftoi me trimëri për të dalë nga rrrethimi, po nuk shpëtoi dot. Ai mbeti i vrarë. Kjo ndodhi më 20 shtator 1796.

1) martinë — Lloj pushke e fabrikuar në fabrikën «Martino» prej nga ka marrë dhe emrin.

Maje bjeshkve, ndër shqype, e n'fund t'shtoje,¹⁾
Ku buqari²⁾ shqyptar avallon,³⁾

Qit kushtimin: O Lekë⁴⁾ kundra anmikut
Me një hov, me një zemër përmblidhn' ju;
Përté Cemin⁵⁾ si j' nieri tanë hidhn' ju⁶⁾
Shqyptaria, o fatosa, ju fton.

Porsi bisha prej ujet ia rrini
N'megje tonë, që s'preken, i hueji;⁷⁾
Mb' ta, sokola! kah bjeshka e kah vrrini
Hapi kthetrat, o Shqype, mbi ta.

Çart⁸⁾ e idhname ndër vedi,⁹⁾ deh shueji
Para Iterit t'atdheut, o Malci:

1) shtoje – fushë e gjerë, rrafshinë

2) buqari – bujku

3) avallon – nga lodhja djersa i avallon

4) Lekë – me këtë emër njihen të gjithë banorët e Hotit dhe të Grudës.

Por këtu autorri emërontë gjithë banorët e Veriut."

5) Cemi – Lumë që buron në Kelmend, kalon në mes Grudës dhe Hotit dhe derdhet në liqenin e Shkodrës.

6) Si 'j nieri tanë hidhniu. – Të hidhem si një trup i vetëm.

7) Vargjet 1-2 të strofës së tretë: Porsi bisha e uritur, ia mbërriti i huoji në (megje) kufirin tonë, në tokat tonë, të cilat janë të paprekshme.

8) çartë – grindje, prishje miqësie, zemërimë

9) ndër vedi – ndërmjet njëri-tjetrit

Me gjak t'zemrës, me krye përtri¹⁾
Trashigimin që i pari na la.

E flamorin, që i shndritshëm ushtrive
Sa kjejeta ju prini ngadhnjime.²⁾
Nxierne, o Hoten, kulshedra e malcive,
Nxierne, hija e t'dekunve e pret.

Dersa t'rreket³⁾ me dhun' e tradhtime
Me i vu kambën i hueji shqyptarit;
Sa kujtojn' se ndër pronjet⁴⁾ e t'parit
Nji kind⁵⁾ t'vetun përdhuni na shklet,

Kjoft' mallkue kush merr nuse të shpia,
Kush ven berret përpara t'kullosë,

1) Vargu: Me gjak t'zemrës me krye pertri – është sakritikimi për atdheun, duke derdhur gjakun, duke lënë kokën, që atdheu të përtërihet, të ringjallet, të bëhet i lirë e i fortë, siç ka qenë, siç e janë trashëgim të parët.

2) Vargjet 1-2 strofa IV: Flamuri që u prindë beteja gjithmonë ushtrive, për jetë të jetës; deri në fitore. Në botimin e «Juveniles» 1917, vargu është «Se kjejeta...» duhet të jetë «Sa kjejeta...»

3) t'rreket – të përpinqet, të mundohet

4) pronjet – tokën që na kanë lënë të parët.

5) nji kind – cep, anë xhakete. Këtu dy vargjet e fundit të kësaj cope i jepin kuptimin që i huaji përpinqet të shkelë edhe një copë tokë të vogël, sa të fusë këmbën. Autori vazhdon mallkimin grishës në katërshen e mëposhtme.

E kush qet' i mbërthen ndër holla,
E kush vaden¹⁾ ndër t'mihuna²⁾ lëshon,

Pushk' e shpatë janë parmendë e janë kosë;
Me eshtna t'huejve do t'mbillet kjo tokë,
Me gjak t'huejve tuj rrjedhun do vokë
Ngrija e mordes që rrethas zotnon.³⁾

Çou, o Grudë, e trimnin' e përherershme
Njalle sot kundra anmikut, e shtyji,
Shtyj djelmoçat, stuhin' e përmnershme,⁴⁾
Me rroposë çka Shqypnia mallkoi.

Se nji za shunglloi ku rri Hyji:
Delni, o t'huejit, prej vendeve tonë;
Tjetër ligj e flamur, jo, nuk dona:
U betue shqyptari e ngurroi.⁵⁾

1) vade – vijë uji

2) t'mihuna – të punuara

3) Vargu «do vokë ngrija e mordes» – duhet të nisë të ngrohet ngrica e vdekjes, «Ngrija e mordes që rrethas zotnon» krijon konkluzionin e mendimit të tij përmes një sinteze poetike të fuqishme, duke krijuar në të njëjtën kohë dhe epikën e tablosë së luftës. Vargu ka kuptimin e një beteje për jetë a vdekje.

4) stuhinë e përmnershme – stuhinë e tmerrshme. Për Mqedjen rinia është forcë e madhe, e fuqishme, rroposëse, përmby-sëse, ajo që mban bërën e luftës. Ajo është një forcë e madhe shkatërruese për armikun që Shqipëria e mallkon.

5) ngurroi – u bë gur, nuk luajti nga fjala, ngull këmbë, u bë shkëmb i pakapërcyeshëm

O Kastrat,¹⁾ porsi reja mizore²⁾
Rrebtë n'ushtrina t'anmikut ti ndeshe,
E dërrmove, rrufé bumbullore,
Gjithçka hase n'at rrëmbyeshmin udhtim.

Orët e malit bërtasin; oh njeshe
T"rgjantën³⁾ shpate që kje trama⁴⁾ e gjithkujt;
Rreth e rreth nëpër çetat e t'hujit
Sielle morden, siell gjamë e mjerim.

Se prej thepash⁵⁾ t'shkallmuem⁶⁾ t'Veleçikut
Synojnë shkrelsit⁷⁾ atdhenë, e nji gojet
U betuene gjithmbarë kundra anmikut
Burr' e fëmijë me luftue tejet⁸⁾.

Xhixha-xhixha ndër sy si shqypojet,
Maje bjeshkve Kelmendi u rreshtue,
E n'breg t'Cemit me gisht tuj shenjue;
«Vorri i t'huejvet a ktune» bërtet.

1) Kastrat — banor i viseve të Veriut

2) Në strofën: O Kastrat, porsi reja mizore... të vihet re intonacioni luftarak, ndërtimi onomatopeik i vargut nga Mqedja, deri dhe në fjalë të tillë si bumbullore.»

3) t'rgjanten — t'argjendtëن

4) trama — frika

5) thep — majë mali

6) t'shkallmueme — shkallë-shkallë

7) shkrelsit — banorët e Shkrelit

8) tejet — deri në fund, deri ku të mos të ketë më. O fitore, o të shuhet.

Por kush ecë para ushtrive tuj lëshue!¹⁾
Flakë prej shpatet, si rrfeja kur shkrepet
Mbi Bjeshkë t'Nemna, vesh' arit t'kullue
Porsi dielli kur vete n'prendim?

Suka e male kalon e nuk epet,
Kalon prroje t'përlyem me gjak t'huejve;
E tuj vremun rrezikun e t'tuejve
Mb'tene, o Shqype, vrapon fluturim.

N'rrethe t'Pejës e tu Shkambi i Kavajës.²⁾
Prej Prishtinet e n'breg t'Adriatikut,
N'fusha basa³⁾ e ndër kerzha⁴⁾ t'bungajës⁵⁾
Vraçi i tij prej ngadhnjimit hinglloi.

Para Iterit t'Shqypnisë kundra anmikut
Rrahi benë⁶⁾ porsi burrat e ngrini

Vargjet: Por kush ecë para ushtrive tuj lëshue... Në këto vargje duhet të kihet parasysh figura e Mahmud Pashës, emri i të cilët del në strofen e 19-të. Prijës, gjithnjë në krye të ushtrisë, me shpatë zhveshur që tek flakëron u përngjan rrufeve që bien mbi Bjeshkët e Nemuna. Vetë ai është veshur në ar, tamam një kalorës, dhe ashtu i pruar e i përflikur, i ngjan diellit në perëndim, një perëndimi të përshkëndritur. Figuracioni poetik në përcaktim të kësaj figure është çliruar në një frysëzim epiko-romantik. Në vargjet e shtrofave të mëposhtme ai vazhdon zbërthimin e figurës.

2) Strofa: N'rrethe t'Pejës: jep vendet që zotëronte Kara Mahmudi.

3) basa-pjellore,

4) kerzha – pyllishte

5) bugajë, – pyll me bunga

6) Rrahi benë – Dha besën si burrat.

Rrfen' e luftës që Francën përtrini,
E tallaze rrreth Bosforit çoi.

Mahmud pasha!... Qe n'vorr Skanderbegu¹⁾
Ngrehi kryetin te kisha e Shën Nkollit,²⁾
Kqyri nipin luftues, ndejë te shtegu,
E lumnói, e ndoq gjumin e vet.

E Karl Topja³⁾ rrreth bregut t'Devollit
Kérkon rrashët që i hoq Shtrashimirit,⁴⁾
E për çerpet⁵⁾ tu' e rrokë «njatij nierit
Ktu t'paçë lanë për theror unë» i flet.

Por pse u zbut ajo ftyr' e terrtisun⁶⁾
Si grykë detit kur hullet⁷⁾ shtërgata?

1) Strofa: «... Qe n'vorr Skanderbegu
Ngrehi kryetin te kisha e Shë Nkollit,
Kqyri nipin luftues ndejë te shtegu,
E lumnói, e ndoq gjumin e vet.»

Poeti nge në piedestal historik trimërinë e Mahmud pashës.
Vetë heroi legjendar Skënderbeu ngrihet nga varri dhe, tek sheh
këtë trim e këtë trimëri fle i qetë, pse Mahmud pasha është një
trashëgimtar i shpatës së tij.

2) Kisha e Shën Nkollit në Lezhë – Vendi ku është varrosur Skënderbeu.

3) Karl Topja – Karl Topia, i cili thërriti turqit kundër Balshës II.

4) Shtrashimir Balsha – djali më i madh i familjes Balsha në
vitet 1340. Më 1362-1372 bëhet prijës i Principatës së Balshajve. Si
kryeqendër patën Shkodrën.

5) çerpe – gërs het

6) e terrtisun – e errët, e ngrysur

7) hullet – avitet

E ndër male kaq rryeshëm¹⁾ tu' u nisun
Pse sot врачи mzi²⁾ gjurmën e ndërron?

Herë mbi prehën t'fatosit bje shpata
Kpuçëm³⁾, si mbas nji luftet t'padame;
Herë përmallshëm tuj kqyrë, si degame⁴⁾
Vetë me vedi me ngrehun fillon⁵⁾.

Me kosë n'krah, mbi nji kal' si vetima
Kish pa morden se u qaset shqyptarve,
e lakmueshëm⁶⁾ ndër gjithë ata trima
Zgjedh për vedi kë date ma trim.

-
- 1) rryeshëm – ngadalë, pa hov
 - 2) mzi – me zor, mezi, me vështirësi
 - 3) kpuçëm – këputshëm, lodhshëm
 - 4) degame – grindje, shamatë

5) Vargu Vetë me vedi... – Fillon të shamatohet, të grindet me vveteten.

6) e lakmueshëm – ka qenë e lakueshme, pra gabim shtypi. Në botimin e parë dhe të dytë hasim fjalën të shkruajtur: lakueshëm: për lakmueshëm. Në një dorëshkrim të një nxënësi të Mjedës e gjejmë lakmueshëm, fjalë që është më bindëse dhe që zbërthen idenë e poetit se rreziku në këtë rrethim ishte shumë i madhi. Këtë gjë e përforcon dhe vargu i mëposhtëm:

«... ndër gjithë ata trima
Zgjedh për vedi ke date ma trim..»

që fiton shpjegimin se përlleshja më e rreptë bëhej aty ku ishin trimat, ata që ishin më në shenjë.

Pau¹), e njitas mbas t'nismi t'ushtarve
Shtegton pasha, e i përkrahet mizores;²)
N'flakë t'lëtinës,³) ku i biri i malcores
Korr anmikun, ia beh fluturim.⁴)

«Nana morde, po i lutet, se t'tuejit⁵)
Jena t'gjith' qysh m'at ditë që u përftrueme;⁶)
N'prag t'gjith' dyerve⁷) e n'votër t'gjithkuejit
Hieja jote mbretnore zotnon,

Nana morde, nji gjam' e shëmptueme
Prej ferishtash kah ti qe po siellet;⁸)

1) pau-pa

2) I përkrahet mizores. — I afrohet mortjes. Nuk i ikën rrezi-kut, nuk i shmanget, përkundrazi është në qendër të betejës.

3) t'lëtinës — pushkë latine, italiane.

4) ia beh fluturim — hidhet fluturimthi.

5) Strofa «Nana morde», po i lutet se t'tuejit
Jena t'gjithë qysh m'at ditë që u përftrueme;
N'prag t'gjithë dyerve e n'votër t'gjithkuejit.

Hieja jote mbretnore zotnon.»,

e cila pasohet nga strofat e tjera, është një bashkëbisediu i pashës me mortjen, duke marrë kështu nuanca të një balade. Karakteri baladesk është në funksion të idesë që kush ka lindur do të vdesë, por mënyra se si duhet të vdesë përbën thelbin e jetës së njeriut. Pasha e thërrret mortjen në çastin e një luftimi heroik. Është një episod që evidenton strategun dhe sakrificën e tij, krenarinë e një lavdie për hir të ushtarëve të tij.

6) që u përftrueme — u krijuam

7) n'prag t'gjithë dyerve — Vdekja ndodhet kudo, e aq më tepër është e pranishme në luftë.

8 Prej ferishtash kah ti qe po siellet — Nga fëmijët drojt teje po vjen vdekja.

Vashë, dje nuse, sot n'futa po pshtjellet,
E pleqnis' sot urojma mbaron.¹⁾)

Për ta vetun therore unë ty t'kjoshë
Për jetë t'tyne që temen pëlqeje;
Edhe mujsë, i koritun u vosha³⁾)
Mos ma kqyri shkëmbim kët' nderë si po t'ftoj».

Dau se u zbut ajo tymen gjith' neje⁴⁾
Kqyri pashën tuj qesh', e llastore
E muer ngryk. Por n'at kosën gjaksore⁵⁾
Ndeshi qafën e n'tokë rrakolloi.⁶⁾

1) Vargjet: Vashë, dje nuse, sot n'luftha po pshtiellet,
E pleqnis' sot urojma mbaron.

kupto: Vajzat, nuset me të zeza vishen dhe urimi i pleqërisë për
të pasur djalin në shtëpi, mbaron.

2) Vargu: Për ta vetun therore un ty t'kjoshë — Për ta; për
këta djem bëhem unë theror, o mortje.

3) Vargjet — Edhe mujsë, i koritun u vosha
Mos ma kqyri shkëmbim kët' nderë si po t'ftoj.

Kupto: Edhe në qoftë se do të dal mujsë (mundës) fitues, edhe
po të dal i koritun, i turpëruar, pra sidon që të përfundoj, kërkoi
që të mos ma quash si nder, por si detyrë që ka prijësi për
të mbrojtur ushtarët e tij.

4) Vargu: Dau se u zbut ajo tymen gjithë neje — U duk
se u zbut ajo fantazmë prej tymi gjithë nyja, është përfytyrimi
i një shtrige në formën e tymit, që pëson gjithë ato shtrembe-
rime.

5) n'at kosën gjaksore — Përfytyrimi i mortjes është me ko-
së në dorë. Mqedja e ka përdorur këtë figurë dhe në poezi
të tjera.

6) Vargu: Ndeshi qafën e n'tokë rrakolloi — Duart e mortjes
prekën qafën e Mahmund pashës dhe kosa gjakësore e rraku-
llisi në tokë.

MUSTAF PASHA^{*)}

në Babunë

E prane¹⁾ vallet ndër male unji,²⁾
E ushtima e pushkve ndër lugje mejti;³⁾

*) Mustafa pasha është i fundmi i derës së Bushatllinje. Është djali i djalit të Mustafa pashës, vëllait të madh të Mahmud pashës. Ndonëse njihet si një feudal që nuk iu nënshtrua sulltanit, ai nuk arriti t'i bënte ndonjë shërbim atdheut. I dhënë pas orgjive dhe interesave pa skrupull, Mustafa pasha e humbi luftën rë Perlepe, luftë e zhvilluar me Mehmet Reshit pashën e Manastirit. Tri ditë e tri net Mustafa pasha ra mbas qejfave dhe nga kjo gjë përfitoi Mehmed Reshit pasha, i cili e shpartalloi atë në Malet e Babunës. Këtë moment kritik, ku u vranë e u shuan aq shqiptarë, poeti e bën subjekt të kësaj poezie dhe njëherazi e bën Mustaf pashën prototipin e feudalit që, për interesat e qëllimet e veta, sakrifikon popullin. Në këtë poezi shpërthen akuza për feudalët, të cilët autori i përcaktion si pjella të korrupzionit dhe të poshtërsive më të shfrenuara. Nga fillimi deri në fund ajo është një akuzë e pamëshirshme që i bëhet klasës feduale, si bartëse e shkatërrimit dhe e rrënimit të vendit.

1) prane — heshtën

2) unji — në të gjitha, krejtësisht

3) mejti — pushoi, u shua

Ndër festa e t'kreme n'fush' e n'malci
Burrnimi u dejti;¹⁾

E djerr a toka: krrut²⁾ ndër livadhe
Shkon kau, e avllin që del prej arve³⁾
Erton⁴⁾, e nepet pér stinë të madhe,
Pér rreth t'kularve.

Por m'zgjedhë mbërthye kulartë pushojnë
Vjerrun nën trena, e rri n'gardh parmenda:
E n'mal pa nieri berret firojnë⁵⁾),
O dridhen mbrenda

Vathit, ku unshëm⁶⁾ siellet ulkoja,
E rrmon me kthethra dyert që baria

1) dejti – këtu: mbaroi, u zhduk, në kuptimin figurativ i humbën sikur të mos kishin qenë kurrë. Folja është u de, u de bora – u shkri bora. Kuptimi i strofës së parë është që në atë vend nuk ka mbetur më asnjë burrë, ka rënë qetësia, sepse burrat kanë shkuar në ushtri, me pashën.

2) krrut – krrusur

3) vargjet: Shkon kau, e avllin që del prej arve
Erton, e nepet pér stinë të mëdha
Pérreth t'kularve

japin çastin kur kau pret të zotin që të vijë në punë, tanë që ka ardhur koha pér të punuar tokën. Momenti psikologjik i stinës së madhe pér bujkun; stina e verës jepet me kaun që e pret me padurim me rreshk këtë stinë, ndërsa vetë toka, arat nxjerin avullin. Por fshati është shkretuar.

4) Erton: që merr erë, ndien vrumulisjen e tokës

5) firojnë – mehin, pakësohen

6) unshëm – të uritur

Dikur përtrini, sot hull¹⁾) e zoja
Pa burrë te shpia.

Mbas tejet, Shqype, burrat flutruene
Ndër male t'reja, n'nji lugje t're;²⁾
Ngadhnjim o deken tuj lypë u lëshuene
T'gjith' për atdhe.

E luftojnë rrebtas: nën breshën plumbit
Që karajfilet³⁾ lëshojn' e bershanat,⁴⁾
Turren, o Shqype, si rrjedha e lumit,
Trima si zanat.

E pasha, ndejun mbi thasë t'florive
Ndër valle jevgash, n'lodër dudumash,⁵⁾
Tallet i knaqun prej zanit t'fqive
Si qen mbas trumash^{6).}

O pjell' e keqe! o dhun⁷⁾, o kore!⁸⁾
Qe shtozavallet, pa e dijt', po kcejnë

1) hull – e zbrazët, sepse mungon burri
Këtu fjala ka një përdorim të gjetur poetik, sepse në tingujt që ka jep idenë e zbrazësirës, të boshillëkut.

2) Vargu: Në male t'reja n'nji lugje t're – Në vende të panjohura prej këtyre luftëtarëve. Ata luftuan në afërsi të Perlepës, në Babune.

3) 4) karajfilet e bershanat – Iloj pushkësh të gjata me çark. Bershanë vjen nga «Brescia» – krahinë në Italinë Veriore.

5) dudum – eunuk

6) trumë – bushtër.

7) o dhunë – o turp i turpeve, vetë dhunimi

8) kore – turp

Me ly e zgärdhien, e 'j kangë mortore
Nën za shpërthejnë.

Ora e shqyptarit¹⁾ t'lëshoi, e fatosat
Që n'luftë, pa shkrepun, shkrine n'marri,
Gjikim po lypin, e thekshëm kosat,
Shpirtna me mni,

Sjellin n'shpi tandem. Qe Mehmet begu²⁾
Eshtna t'shpulpuemun, mbi vorr t'u u çue,
Idhun³⁾ prej s'largut t'hotë «ktune a shtegu
Me folë me mue.

Ktu t'prita ç'moti⁴⁾): ktu do t'paqohet
Vaji i nji femnës që n'mjerim lëshova,

1) Ora e shqyptarit – Orët janë, në përfytyrimin pagan, qenie mitologjike që mbrojnë shtëpitë ose njerëzit. Vepra mizore, dhunuese e plot turp e Mustaf pashës ka bërë që orët të mos e mbrojnë atë, sepse ai është tradhtar. Veprimi tradhtar i pashës është theksimi mitologjik i jepur një nuancë më të fuqishme trajcitetit të kësaj lufte dhe po aty jepet me forcë feudali tradhtar si i përbuzur e i flakur nga vetë populli. Shqipëria, ora e shqiptarit, e braktisi atë, e lëshoi.

2) Mehmet begu – nipi i Mustafa pashës, që ky i fundit e vras tradhtisht nga frika se mos i nipi i merrte pushtetin.

3) idhun – me hidhërim, me kërcënëm

4) ç'motit – prej kohësh

Pa faj;¹⁾ shqyptari ktu do t'kujohet
Se hupës²⁾ nuk shkova.»

E prej gjith' fushash bajnë valle t'mnershme
Arët e livadhet që 'j ditë grabite:
Sot, vonë, ma t'rrebshtëm përfaje t'hershme
Gjikimin prite.

Del, mizuer, këndenaj, del prej mërziet³⁾
Zgaq⁴⁾ i përbuzshëm, Shqypnia t'volli:
Ty shpina e detit, ty, vend robni,
T'pret Anadolli.

1) ...Ktu do t'paqohet/ Vaji i një femnes që n'mjerim lëshova/,
pa faj...» Vetëm në dyluftimin tonë, në hakmarrjen time do të
qetësohet gruaja që lashë të mjerë, pa faj.

2) hupës – pa nam, pa nishan, pa marrë hak, pa marrë shpagim.

3) Strofa e fundit: Del mizuer, këndenaj, del; prej mërziet...
Është një mallkim, akuzë e fuqishme poetike dhe një konkluzion
për shpagimin e tradhtisë. Tradhtia nuk ka vend në atdheun e
shqipeve. Ky është dhe konkluzioni i poezisë. Folja *vollı* përcakton
fuqishëm idenë e zhveshjes nga çdo tipar i këtij personazhi
dhe sjell nuancën figurative të njeriut që është i téri pjellë e
veprim i së keqes e i së pështirës.

4) zgaq – fundërrinë, llum; i poshtër

MALLI PËR ATDHE^{*)}

Ndër njikto vende për bukur
Dhen' tem i shuem¹⁾) jam tuj dishrue;
N'qytete t'hueja, porsi n'shkreti
Rri tuj gjimue.

A e bukur fusha kur çil prendvera,
Lulzim ka kopshti kur lulet dalin;
E drandofilles ndër fushë tret era
E përté malin.

Por gjith' këto t'mira ngushllim nuk m'apin:
Për atdhe temin zemra po m'shkrihet;

*) Poeti, i ndodhur jashtë atdheut, ka një përmallim për vendlindjen, për atë vend ku jetojnë prindërit, miqtë e shokët. Këtë përmallim atij nuk ia zbut as peizazhi i mrekullueshëm i vendeve të huaja ku jeton. Lirika ka një shpërthim poetik të thellë, ku plekset malli me dhimbjen, dëshira me këmbënguljen për të ardhur në atdhe. Vjersha u shkrua në Kremona të Italisë, 1888.

1) i shuem — i shkreti, i mjeri

Njatjé kur mendja lëshon ndonjëherë vrapin
Shendi') i përthitet.

Ndër lisa t'pyjeve, bylbyl, tuj këndue
Për çerdhe tande po ban ankime;
Mue, i mjerë bylbyli, po m'përgjan mue
Me kto dertime.²⁾

Sa herë nën hije t'njifarë çinarit³⁾
Afër nji kronit që i shkon përbri,
Për vend mendohem, ku ndodha s'parit,
N'vaj tuj u shkri.

E pves tuj kjamun erën e kronin
Për fush' e male ku mendja m'vret.⁴⁾
Por tuj rrjedh' uji, si e ka zakonin,
Gjimon e s'flet.

Prej majës s'malit shikoj larg fushën
Kah di se a fisi që jetën m'fali;
Po prej trishtimit me lot syt' m'mbushen
E s'mund t'i ndali.

1) shendi— gazi, gëzimi, gazmendi

2) dertime — derte, vajtime me lot e ankime

3) çinar — rrap

4) Ku mendja m'vret — Ku më shkon mendja, ku më rri mendja.

O bjeshk', o male, fusha t'bekueme,
Ku vetë herherna për shëti shkoshe,
O Maranaji¹⁾, o Buen' e mbëlueme
Me bimë gjelbroshe.

Kur kam me u gëzue? Ndër njato kësolla
Ma e pagjt²⁾) e kandshme m'u duktejeta,
Ndër dhena t'hueja, ku mbrapa u solla,³⁾
Veç trishtim gjeta.

Na dha ne t'shkretve vetë perëndija
Mallin m'u pamun, me ndejë n'nji volër
Grueja me t'shoqin, me prindën fëmija
E vllau me motër.

... Niaj zemër nierit nuک ka që udhtimin
Për mirakande merr me u bëgatue;⁴⁾
Larg teje, o Shqype, kush lyp gjallimin⁵⁾,
Po, do mallkue.

1) Maranaji – mal në Veri të Shkodrës

2) e pagjtë – paqësore, e qetë

3) Ku mbrapa u solla – Ku më vonë u enda. Në botime të ndryshme vargun e gjejmë me foljen: ku mbrapa u ndodha. Neve na duket se folja ' solla ka më forcë, është më shprehëse e ka nuanca më karakterizuese të ecejakeve të të mërguarit.

4) Për mirakande merr me u begatue – Nuk ka njeri të vërtetë që të marrë udhët e të lërë shtëpi e katandi me të vetmin qëllim që të pasurohet.

5) gjallimin – jetesën, të mirën, begatinë

Do vorre t'reja ndodhë që m'kallxojnë¹)
Naoshta tuj kjamun prej dhimbet gjindja:
Njitu, do t'm'flasin t'rrijn e pushojnë
Vllaznit e prindja.

O Prind, o vllazën! te 'j vorr me jue
E gjall' e i dekun unë do t'rri;
Sado²» n'gjuhë teme kan' me m'urue:
«Dritë pastë n'lumni».

Kremona 1888

1) Strofa; Dy vorre t'reja ndodhë që m'kallxojnë
Kthimi në atdhe me vonesë do ta çojë poetin përpëra varreve, se-
pse gjindja, njerëzit e tij do të kenë vdekur. Një ide e tillë është
për të gjithë të mërguarit, të cilët duke mos u kthyer shpejt në
atdhe do t'i gjejnë të vdekur njerëzit e tyre.

2) sado — sidoqoftë, të paktën

GJUHA SHQYPE^{*)}

Fort të ndershmit zotni Gustav Meyer-it

Përmbi za që lëshon bylbyli
Gjuha shqype m'shungullon;
Përmbi erë që nep zymbyli
Pa da zemrën ma ngushllon.

^{*)} Kjo lirikë i kushtohet Gustav Majerit, albanolog i shquar. Në dorëshkrim autori e ka përkushtimin: «Fort t'ndershmit zotni...». Gustav Majeri lindi më 25 nëntor 1850 në Gross-Strehlitz (Silezi e Sipërm) dhe vdiq më një spital afër Gracit, më 27 gusht 1900. Në vitet 1888-1897 ka botuar «Albanesische studien: Kurzgefasste albanesische Grammatik mit «Lesestuchen und Glossar» dhe veprën më të rëndësishme të tij «Etymologisches Wortebuch der albanesischen Sprache».

Mjedja ka pasur një korrespondencë të vazhdueshme me të, aq sa për ndihmën dhe kontributin e dhënë për çështjet gjuhësore ky albanolog i shquar e quajti bashkautor. Mjedja ia kushtoi Majerit këtë vjershë më 1892, kur ishte caktuar si profesor i lëndës së logjikës në Krakovi (Poloni).

Ndër komb¹⁾) tjerë, ndër dhena tjera
Ku e shkoj jetën tash sa mot,
Veç për ty m'rreh zemra e mjera
E prej mallit derdhi lot.

Njikto gjuhë që jam tuj ndie
Janë të bukra me temel;²⁾)
Por prap kjo, si diell pa hije
Për mue t'tanave ju del.³⁾)

Edhe zogu kërkon lisin
Mbi shpi t'artë ku rri me mbret;
E shtegtari dishron fisin
Përmbi vend që s'asht i vet.⁴⁾)

O Shqypni, e mjerë Shqypnia,
Plot me burra e trima plot
Ti 'j dit' ishe; por lumnia
Që ke pasun nuk a sot.

Nën njat tokë që ta shklet kamba
Zan⁵⁾) e t'moçmëve vështro⁶⁾)

1) komb' – kombe

2) temel – themel

3) ju del – ua kalon

4) i vet – i veti. Të vërehet krahasimi me bilbilin që kërkon vendlindjen e tij, pyllin, e i duket i mërzitshëm edhe pallati mbretëror përpara hapësirës, lirisë që ka pylli.

5) zanë – zërin

6) vështo – dëgjo, vërja veshin

Për bij t'tashëm, porsi e ama¹⁾
E t'koritunve, gjimo.

Nam e za, që kishe, t'treti.
E veç turpi e marrja t'mbëloi;
Për lumni veç 'kore t'mbeti
Qysh se fara e mirë mbaroi²⁾

Por gazmo ndër gjith' kto t'vështira
Përse ende s'sharrove kret;³⁾
Diçka t'mbet ndër ato t'mira
Mbas dy mij' e ma shum vjet.

T'ka mbet' gjuha që po ndihet
N'fush' e n'mal që ti zotnon;
Gjith' ku⁴⁾ hija jote shtrihet,
Ku shqyptari zanë e lëshon.

Prej Tivarit e n'Prevezë
Nji a guha e kombi nji,

1) Vargjet: Për bij t'tashëm. porsi e ama
E t'koritunve gjimo

Kanë në vetvete një revoltë e qortim për mefshtësinë që pati
vënë re te bijtë e shqipes, të cilët nuk kanë më energjinë, forcën,
guximin për të luftuar e për të fituar lirinë. Fjala gjimò tingëllon si
një zgjim i këtij brezi, si një thirrrje për luftë.

2) Vargu: «Qysh se fara e mirë mbaroi» – Nuk ka më trima si
dikur.

3) s'sharrove kret – nuk mbarove krejt fare. Kret – liri
poetike) për krejt

4) gjith ku – kudo që

Ku lëshon dielli njato rrëze
Që veç toka jote i di!)

Ku n'breg t'Cemit rritet trimi
Me zbardhë, Shqype, zanin tand,²⁾
E ku i Drinit a burimi
Që shpërndahet kand e kand.

Geg' e Toskë, Malci jallia³⁾
Jan' nji komb, m'u da s'duron:
Fund e majë nji a Shqypnia,
E nji gjuhë t'gjith' na bashkon.⁴⁾

Kjoftë mallkue kush qet ngatrrime
Ndër kta vllazën shoq me shoq:
Kush e dan me fjal' e shkrime
Ça natyra vetë përpoq.⁵⁾

Por me gjuhë kaq t'moçme e mjera
Si 'i bij'kje pa prind mbet;⁶⁾

1) Që veç toka jote i di – që e njeh, e di vetëm toka jote.

2) Me zbardhë, shqype, zanin tand – Ngre lart lavdinë, zulmën tënde.

3) jallia – fusha; banorët e fushave

4) E nji gjuhë t'gjithë na bashkon. – Gjuha shqipë është po-himi i njëjësisë kombëtare, i domosdoshmërisë të të kuptuarit të kësaj njëjësie që çon në bashkimin përfundimtar. Lirinë.

5) përpoq – bashkoi. Këto vargje janë një shpërthim kundër atyre që mundoheshin të futnin përfçarje në popullin shqiptar.

6) Si 'i bijë që pa prind mbet. – Nuk u mor kush me studimin e saj.

Për t'huej t'mabajshin dhenat tjera,
S't'kishte kush për motër t'vet.

Kur nji burrë u çue n'Austri
E me sy gjithkun t'kërkoi:
Gustav Majer-i asht emni i tij,
Emni i burrit që t'madhnoi.

Porsi dielli tuj flakue
Shpërndan terrin që na mbëlon,
Njashtu Majeri tuj kërkue
Kah ke dalë po ta difton.

T'difton motrat, t'difton fisin
Nëpër shekuj fluturim,
T'çon njatje ku luftnat krisin,
Ku a kap' Roma e lliri shqim.¹⁾

Njikto t'thot' (e ti s'e dishe)
Janë t'bijt' t'tu që pate mot;²⁾
Këta janë burrat që 'j ditë kishe,
Emnit tand me i dalun zot.

Nën qytet që ma vonë çili
Kombi yt luftar ma pak,³⁾

1) shqim - fare, krejt, janë kapërthye për vdekje.

2) mot - motit

3) Vargu: Kombi yt luftar ma pak - Edhe pse më i paktë në numër

Ku ish mbret atbotë Bardili,¹⁾
Shum' anmiku derdhi gjak.

E njat tokë që je tuj gëzue
E ke xanë tash sa mij'vjet.
Shqyptaria që mbet mbëlue
Sot nën dhé, edhé shqyp flet²⁾

Flet me rrasa, flet me sende³⁾
Ku lumnin'e yet e shkroi;
Por kurkush s'i di këto vende,
E harrimi t'tana i mbëloj.

Por gjithnji nën kambë po ndihen⁴⁾
Burrat t'tu që toka i mbëlon;
E nën dhé kocijt përzihen
Si 'j arë grun'kur era lëshon.

1) Bardili – Bardhyli, mbret i ilirëve

2) Vargu: Sot nën dhe; edhe shqyp flet – Poeti, ndryshe nga rilindësit e tjerë, që quanin si paraardhës të shqiptarëve pellazgët, mendon se janë ilirët, gjë që do të vërtetohet, mendon ai; në të ardhmen, me zbulimet që do të bëhen në fushën e gjuhësisë. Ky është mendimi i gjuhëtarëve sot.

3) Vargu: Flet me rrasa, flet me sende – Flasin zbulimet e mbishkrimeve dhe gjetjet arkeologjike.

4) Strofë: Por gjithnji nën kambë po ndihen etj.

Flet se tani historia po shkruhet, studime po bëhen dhe e kaluara e lavdishme historike e popullit tonë po del e madhërishme, ashtu siç është. Kjo po sjell dhe zgjimin kombëtar. Evokimi i së kaluarës historike ishte një nga kërkesat kryesore të rilindësve për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare.

Don m'u çue e gjith' për s'mbarit
Me u pri nipave mb' nji cak;¹)
Don me t'ba si ke kenë s'parit
T'nderës me kapë t'lumnueshmin prak.²)

Kremona, dhjetor, 1892

1) cak – në vendin e duhur

2) Strofa e fundit që mbyll lirikën është lidhur me idenë që tani u zgjuan bijtë e Shqipërisë dhe do ta fitojnë përsëri llrinë e dikurshme.

PRENDVERA

Jeni lodhë, dallëndysha t'shkreta,
Je molisë¹⁾, i ziu bylbyl;
Ah! pushoni n'streh'ku u gjeta,
Pusho n'kopshtë te njaj zymbyl.

Mbi krahë tuej prej dhenash tjera
Ju, prendverën na prutë këtej;²⁾
Shplodhn' ju, pra, dallëndysha t'mjera,
Rri, bylbyl, n'lulzim që kthej.

Se qe 'j prrue prej malit ulet
E t'tanë fushës ushqim i nep;
E nën borë po shpërthejn' lulet
Porsi fëmij' që zbulohen n'djep.

1) molisë — këputur, lodhur së tepërm, i pafuqi

2) Vargjet: Mbi krahë tuej prej dhenash tjera/ Ju prendverën na prutë këtej» figurë poetike, romantike. Mbi krahët e zogjve shtegtarë pranvera mbartet nga një vend në vend tjetër.

Fllad i let me vapë dashtnijet
Puthi pemën gemb për gemb
U zgjue pema, e qe prej shijet
Buloi mbarë nëpër kopshtë tem.

Ndej' bri votrës nieri myket:
Vrapo, bulk, ku puna t'hrret;
Tuj vrue fushën kau bërlyket,
Lyp m'u vue për lavër t'vet¹⁾

1) tuj vrue fushën – Duke parë fushën që është gati për l'u punuar, kau bërlyket, zhgërryhet, lodron, sepse dhe ai kërkon punë e pret të vihet në kular, në lavër të vet.

VERA

A zverdhë fusha, e ndër grunore
Po vëlojnë korrcat porsi zogj;
Këndoijnë katundcat me malcore
Pa u kujtue si dielli i dogj.

Veç n'at arë, porsi nji e tretun,
Zi ndër petka e n'fytyrë terr,¹⁾
Korrë nji cucë pa shoqe vetun
Me hije t'vet që mbrapa e merr.²⁾

Tjera herë ti vet' e treta
Korrshe, o bij', me motra n'shend;
Sivjet, vetun tuj korrë t'gjeta
Pa nji motër, pa gazmend.

.....

1) terr — kupto: e zymtë

2) Me hie t'vet që mbrapa e merr — Hija e saj e ndjek atë e duket sikur e merr me vete. Është një figurë e përsosur karakterizimi të këtij çasti lirik tragjik.

VJESHTA

'Dhe ju po shkoni,
Bylbyla, kshtu!
Po tretni këndynaj,¹⁾)
Dallëndysha, ju!

Deken mendova
Se m'vjen kurdo;
Se m'leni vetun,
S'mendova, jo.

Por, ma fort zemrën
Ma bren nji idhnim;
Çerdhet që i leni
Kujdesit tim.

Ndoshta, kur t'ktheni
Mue vorri m'mba²⁾),
E ju kërkoni
Çerdhen që s'a!

1) këndynaj — këndej

2) vorri m'mba — do të kem vdekur

DIMNI

Nëpër fush' e nëpër male
Frym murlani me stuhi,
O murrla, njat frymën ndale,
Ndal ti, o akull, mos më ngri,
Mos ma ngrini' kët' pikë gjak!
— Struku, struku, i shkreti plak.

Po del dimni me kosë n'dorë
Gjeth e bar i ka kositë;
Qet balkoni pjalm¹⁾) e borë,
E plakshkreta, tuj mërdhitë,
I thotë vedit me za pak:
Struku, struku, i shkreti plak.

1) pjalm — fërfellizë, mjellazë, borë që e çon veriu kur fryn; borë e hollë me erë e me shi.

●

NGA GJUHË TË HUAJA

●

VAJI I DALLËNDYSHES

(T. Grossi)¹⁾

Moj dallëndyshe shtegtare e rmyeshme,
Që po pshtete n'at balkue,
Për gjith nadje 'j kangë t'mallënnyeshme
Aq përmallshëm tuj këndue;
Ç'do me m'thanë n'atë gjuhë vajtore,
Moj dallëndyshëza shtegtore²⁾)

Larg gjithkujt e n'veni³⁾)
Lanë prej fatit tand që t'treti,
A thue kjake për vetmi,
A t'çoj mall me vaj u⁴⁾) i shkreti?
Kjaj, o kjaj mb'at gjuhë vajtore,
Moj dallëndyshëza shtegtore.

Por prap ndryshe a puna jote;
Sado pak fluturon me krahë,

1) Tomazo Grossi — poet romantik italian i shekullit XIX

2) shtegtore — udhëtarë

3) veni — venitje

4) u' — unë, kemi një liezon poetik

Fush'e male kah kalote
I kërkon tuj "dnesë gjithkahë;
Për gjithë' ditë n'at' gjuhë vajtore
Atë thrret, dallëndyshë shtegtore.

Ah! kish t'mundem... por shterngimi
I ktij burgut s'm'en me shfrye.
As frymë eret as lulzimi
S'mbërrin i diellit tuj shkëlxye:
Mezi ankimet që mbaj prore¹⁾
Ti m'i ndien, dallëndyshë shtegtore.

Qe shtatori tashma mbërrini
E pa m'lanun nuk po ndale;
Ke me shkue ku lulzon vërrini,²⁾
Me njerz tjer' e tjera male,
Ke m'u falë mb'at' gjuhë vajtore,
Moj dallëndyshëza shtegtore.

Unë atëherna për gjith' nade,
T'çilmen lotve syt' e mi,
Tu' u sjellë bora kollovrâde,³⁾
Tash kujtoj se ende po ndij
At' zan' tand që për mue prore
M'vjen se ankon, dallëndyshë shtegtore.

1) prore — për çdo çast.

2) vërrini — vend për të kaluar dimrin, kullotë dimërore

3) kollovrâde — lëmsh

Ndoshta 'j kryq kur t'vij' prendvera
Ke me gjetun mbi kët truell:
Përmbi te, dallëndyshë e mjera,
Ndalu'j herë se fati t'suell;
M'lut pushim mb'atë gjuhë vajtore,
Moj dallëndyshëza shtegtore.

VLLAVRASI

Capparozzo¹⁾

Nëpër terr që lëshonte nata,
Ngarkue teshat kaliboc,
Për nji pyllë ku s'ra kurr spata,
Ndiqte rrugën nji djaloç.

Landët e pyllës si 'j ujk iu dukshin,
Që prej ujet²⁾ n'mal luron;³⁾
Cuba t'rrebtë, që n'pritë u strukshin,
Gjethet e lisave kujton.

O Shqypni! gjimote i shkreti
Male, mbushë me gjuetarë plot;
Kësoll e bardhë, ku porsi mbreti
Shkon baria dit' e mot.

1) Xhusepe Kaparoco (1802-1848), poet italian. Vihet re që të gjitha vjershat e përkthyera nga Mqedja kanë një përkthim të liri, lirik, që i afrohet më tepër përshtatjes. Vjersha është shqipëruar më 1884 në Porto-Re, me titullin «Vllavrasi i Tosknis.»

2) prej ujet — prej urie

3) luron — ulërin

O ju lugje të Prevezës!
Këtu mue zemra po m'vajton;
Te ju hana me dritë t'rrezes
Shtigjt udhtarit ia kallxon.

Fis i dashtun, ku n'dritë dola
Afër detit t'papshtjellim;¹⁾
Shpi e bardhë ku s'parit fola
N'prehën t'nanës tuj gjetë pushim.

Njeshtu²⁾ thotë e me trimni
U nis udhës shtegtarë prap;
Fishklloï landa tu' u përzi
E prej frikës ngau djali vrap.

Por n'nji cub mbas gardhit hasi;
. Ndalu, i thotë, nuk ke kah mba,
Nji kobure n'bri ia rrasi
E mbi tokë përbys e la.

«Ah! nanëshkreta! – i shuemë briti,
E përbys u lëshue mbi 'j curr;³⁾
Për tre muej e shkreta m'priti,
E tekëndeji⁴⁾ nuk m'shef ma curr.»

1) t'papshtjellim – pa trazim

2) njeshtu – kështu

3) curr – shkëmb

4) tekëndeji – këtej e tutje

«Po jot' amë», — si për qesti,¹⁾
la ban gjaksi me idhnim plot, —
«Ti m'difto ku rri me shpi,
Fjala jote nuk hupë dot.»

«N'skaj t'Shqypnisë shkon vorfnisht jetën,
E pa djelm e mjera mbet;
Dy ma t'mëdhajt ndër luftna mbetën
E këtu i treti qe po jet.

Pat nji tjetër...» fija e zanit
lu kput djalit e gjimoi;
U dridh gjaksi, e aj farë luanit
Pushkën n'tokë me'jherë e lëshoi.

«Pat nji tjetër, që ajo e dote
Përmbi dritë të syve t'vet;
Kurr prej prehnit nuk e lëshotë:
Shokë ndër cuba vojt e gjet.»

«Vlla, — i përgjegji zemërvshtiri,²⁾
Njitu³⁾ t'vrava e këtu po des;
Nuk kam sy me m'pa 'ma nieri,
Ngryk' me ty njitu po jes.⁴⁾

1) qesti — shpoti, si për t'u tallë

2) zemërvshtiri — zemërguri

3) njitu — ja këtu

4) po jes — po mbetem

«Jo ti shëndosh! e fill te shpia,
Te nanëzeza fluturo;
Pa asnji fëmij, e mbyt vëtmia,
E mbëlon skami: mos e lësho.»

«Shka t'i them mandej nanës ngratë,
N'kjoftë se pvet për ty ndo'j send?» –
«Thuej se mora nji rrugë t'gjatë,
Se bashkë n'qiell dikur xamë vend.»

Porto-Ré, 1884

TË VORRUEMIT SIR JOHN MOORE

(Wolf)¹

Lodërtijat²) nuk u ndiene,
S'u ndie gjama e miqasis'
Kur fatosin n'vorr e shtiene
E prej luftnave pushoi;
S'pat t'përcjellt' e kaloris',
T'falët e armve s'i qilloi.

Nëpër terr³) që lëshote nata
Me i cilë vorrin na shpejtojshim;
E n'nji vorr që gropoi shpata
Trupi i t'dekunit pushon.
Me 'j kandil tuj u fikë punoshim
Me dritë t'zbetë që hana lëshon.

1) Ser Xhon Mur lindi në vitin 1761. Ishte gjeneral i shqar anglez. Poeti irlandez Sharl Wolf (1791-1823) i kushtoi poezi. Muri mbeti i vrarë në Spanjë, në vitin 1809, në luf-tën e zhvilluar kundër Napoleonit. Lirika mban datën: Kieri, 1887.

2) lodërtijat — trumpetat

3) nëpër terr që lëshote nata — i njëjtë varg, si te vjersha «Vllavras»

Nji pělhurë s'ia pshtuellme shtatit,
As nji rizë¹⁾ atë ftyrë s'ia mbëlote
Me i pritë dhét²⁾ ndopak tē ngratit
Arkë³⁾ pér doret nuk u gjet:
Si 'j luftar që flen pushote
Vesh' e njeshë me stoli t'vet.

Dhimbshëm burrin tuj ankue
Nëpër buzë, e salikueme;⁴⁾
Por nji vaj, që me diftue
T'dhimbt' e zemërs kujt s'i pshtoi.
Tuj këqyrë vorrin u kujtueme
Se 'j ditë tjetër bic⁵⁾ agoi.

Kur nën krye i vumë nji gur
Me fjetë burri përgjithmonë,
Mbi ftyrë t'tij, menduem, dikur
Kamba e t'huejtit ah! tash shklet;
Andej detin, ku t'pazonë⁶⁾
Pushka e inglizit nuk e pret.

Mbi vorr t'tij dikur trimnin'
Tham', ju shan pa frikë ushtari:

1) rizë – shami, cipë

2) dhët – dheun

3) arkë – arkivol

4) salikim – Shërbimet fetare para se tē varroset i vdekuri.

5) bic – jo e mbarë, ters

6) t'pazonë, – tē ligun tē mbrapshtin, atë që nuk beson zotin

Por jo! i vrami vet' njerzin
Ka me mujt' me e çuemun n'cak.
Ku e vue dorë e inglizve, udhtari
Jo kët vorr s'e prek aspak.

Tuj mbarue kët vepër mëshiret
U avit koha me kalue;
Krisma jonë me 'j tjetër diret¹⁾
Që ma rreptë po shungallon;
Larg e larg tuj bumbllue
Mb'armë anmiku rrrokull²⁾ lëshon.³⁾

N'vend ku gjakun derdhi trimi
Ia ruen trupin veç shkretia;
E nji rrasë, ku t'vehej shkrimi
Me e përmendun nuk u gjet.
Na e lamë burrin, por trimnia
N'buzë të vorrit me të jet.⁴⁾

Kier, 1887

1) diret — bjerret, humbet, zhdukët

2) rrrokull — përqark

3) lëshon — këtu: vërsulet, lëshohet

4) jet — mbetet

MBRETI I TULES

(W. Gëte)¹⁾

Deri n'dekë besnik ke s'thohet
Ishte n'Tule 'j padisha,
Diq e dashtna mbas do kohet
E 'j got' arit shej i la.

Sa at igotë arit gja nuk dote
E gjithmonë me tene²⁾) piu;
Por ka 'j lot për faqe i shkote
Gjithsaherë pite fatziu.

Kur pau vedin tuj mbarue
Njeh qytetet, e gjithshka
Trashgimtarit ia la shkrue,
Por putirin³⁾ nuk ia la.

1) Wolfgang V. Gëte (1749-1832) figura poliedrike. Një nga poetët më të mëdhenj të letërsisë gjermane dhe botërore. Kjo lirikë, e përkthyer nga Mqedja, ka tërhequr vëmendjen e shumë përkthyesve shqiptarë deri në ditët tona, por bukuria e përkthimit mqedjan është e veçantë dhe e përsosur.

2) tene — me të, me atë

3) putirin — kupën

N'ndeje¹⁾) t'parve, n'buzë të dedit
Gjith', parsinë n'nji gost' i thrret;
Ulet n'gost²⁾) e ka rreth vedit
Mbledhun bashkë parsin' e vet.

E t'ksaj t'kandshmes jetë dëshirin³⁾)
Piu ma t'mbramin e lumnoi
Pijsi plak, mandej putirin
Ndër valë t'detit e flakroi.³⁾

Tuj u zhyt' e pau n'fund t'zallit
Tuj këcye nalt', tuj hupë me turr;
E n'at' ças i ranë prej ballit
Fikun syt' e s'piu ma kurr.

1) ndeje – seli

2) gost – gosti

Në vargjet: E t'ksaj t'kandshmes jetë dëshirin.

Piu ma t'mbramin e lumnoi

Inversi mjedjan i vargut është përdorur për liri poetike, për forcë ekspresive të mendimit. Ai piu dëshirën e fundit të jetës së kendshme me kupën e kuftimeve më të mira.

3) fakroi – e flaku,

•

VJERSHA TË TJERA*)

të papërfshira nga autori në
"Juvenilia"



*) Renditja bëhet sipas botimit: Ndre Mqedja, «Juvenilja dhe vepra të tjera..»

Mbledhur dhe redaktuar nga Mark Gurakuqi.)
(N.SH. Botimeve «Naim Frashëri» — Tiranë 1964)

A N D Ě R R *)

Pezull prej qiellit fluturote e shkreta
E si dielli n'mjesditë rreze shpërdake;
Engjëll ndër cucat o nji çikë gjake¹⁾
Që veç qelli numron ndër valle t'veta.

Arit i kishte flokët, e kish si zhgjetë
Dritën e syve e mollzat rrumbullake,
E buzët e vocrra me të njyeme gjake,²⁾
Që kur i pash' krejt i mahnitun mbeta.

Mandej si nieri, që prej gjumit ngrihet,
Mora zemër e e pvetë me trimni:
«Engjëll a vajzë je tine, o bukuria?»

* Lirika u botua për herë të parë më 1909 me pseudonimin «Shqyptari» te «Diturija», viti I, Nr. 1, f. 7 Selanik. Vjersha mban datën 7 nëntor 1908.

Është një vegim poetik, që e përfytyron Shqipërinë si një vashë. Mbërrthime emocionesh të tillë janë karakteristike për poetët me temperament klasiko-romantik. Soneti ka një tingëllim erotiko-patriotik.

1) gjake — ngjante

2) gjake — ngjyrë gjaku

Qeshi goca nji herë, si vashë që pihet¹⁾
Uli kryetin tëposhtë e me dashtni
«Motër e Nanë, tha, m'ke – jam Shqyplaria».

1) pihet – mpihet

SHQYPES ARBNORE*)

Nalt përmbi re, mbi qeta¹⁾)
 Shndritsa për bor' amshore,
 Porsi 'j vetimë, si zhgjeta,
 Me flatra fishkullore
 Sielle ndër thepa e shita,²⁾
 Shqype, t'anguemit drita.

T' kaltërt e qiellës mbi krye,
 Hyzit ke shokë, që shndrisin
 Si gur t' paçmuem, e ty
 Petkun t' nusisë t' qëndisin.

*) Kjo lirikë botohet sipas variantit të gjetur në fletoren «El-basani», 28.XI.1922, Nr. 2, që, siç theksonte kjo fletore, bënte pjesë në librin e botuar «Atdheu — Vjersha të kohës së robnimit». Ka të ngjarë, që poetit t'i kenë kërkuar ndonjë vjershë për botim nga ky vëllim, kur ai ishte anëtar i Komisië Letrare. Për këtë vëllim e për disa vjersha të tjera ende nuk dimë gjë. Poezia është një grishje poetike që i bëhet zogut-shqiponjë, simbolit të lirisë, të zgjimit të ndërgjegjes kombëtare e të vetë emrit shqiptar, që të zbresë e të zgjojë për luftë shqiptarët e robëruar.

1) qeta — shkëmbinj

2) shita — shkrepë të mprehtë

O e bardha natë, ku dijen
Shprazi nji Zot, e shijen.

Qeti mbretnia yte,
Shqype, pengim liria;
E npër hapsina t' tyte¹⁾
E hyjve harmonia
T'argton e t' dalmen hana
Ndihet përmallshëm zana.

Por ndër fushore t'veja²⁾)
N'vrrije ku rrinë zogjt' t'tu,
Me bumullina rrfeja
Shkrepet përmnerë tu' ushtue
E tine n'ato maje
Nuk ndien ushtim' as vaje.

Oh, zbrit ndër ne, mbretnore³⁾)
Shqype, edhe 'j herë, si zbrite
Kur përmbi ball' madhnore,
T'madhit Kastriot i shndrite,
E u trand⁴⁾ gjith' bota unji.
Prej vringllit t'shpatës s'tij.

-
- 1) të tyte – të zbrazëta
2) të veja – të shkreta,
3) mbretnore – më i pari e më krenari, trimi, madhështori i zogjve
4) u trand – u trondit, u drodh

Krrut nën mizuer t'Stambollit
Gjimognë zogjt t'tu n'veriga;!)
Nji zgaq prej Anadollit
N'ahte?) i plandosi e n't'liga;
Hovit t'ushtrive t'tija
S'i duel ma n'ball' Shqypnia³.)

Shërbtorë n'vend tonë na jemi
T'huejit me vllazën tonë;
Emën as atme s'kemi,
As namin e gjithmonë,
Sot vashat e Shqyptarit
I çohen fli barbarit.

Jo, kështu n'at Krue mënia
e t'Parve tonë nuk ngeli,
Kur t'Gjergjit t' Madh duhia
Furi osmane shkeli
E rrakajë gjymtyrë e krena
Bijshin t'përgjakunt shena.⁴)

1) veriga – litarë hekura, pranga

2) ahte – gjamë, ankime

3) Strofa: Krrut nën mizuer t'Stambollit etj. Është një strofë, idenë e së cilës e gjen në shumë lirika të Mqedjes. Ai qorton ashpër heshtjen e durimin e shqiptarëve ndaj robërisë së Perrendorisë Osmane. Ky qortim del më i fuqishëm në poemthin lirik «Liria». Të duket si një përsëritje ideje, por në fakt, përmomentet historike, grishja për luftë e kujtimi se të kujt stërnipër ishin shqiptarët, u bënë tema të gjithë shkrimeve e studimeve të periudhës së Rilindjes.

4) shena – përrrenj të mëdhenj

Luftuen për atme trima
Atëherë, qiellorët, luftuene;
Shpata e Shqypnis' e ushtima
N't'ikun anmiqt' i vune:
E suk' e fush'¹⁾) gjimoshin
Nën kual që shkëndija lëshoshin.

Oh! zbrit ndër ne, mbretnore
Shqype, edhe j'herë si zbrite
Kur përmbi ball' madhnore
T'madhit Kastriot i shndrite;
T'binden barbarët e ri
Për djelm që ke, Shqypni.

1) sukë – çukë, kodra

B A S H K O N I U *)

Përmbi prone t'Skanderbegut,
Mbi qytete t' Arjanitit,')
Ku Golemi?) n'krahë petriti
Mbi halldupë u lëshote, e plot

Armë e krena anmiqsh përmblidhët
Atdheut t'vet me i ba therore,
Ndër kto kohna qytetnore,
Shqype, s'rreh flamuri jot.

Veshë me zhièle anadollaku
Me gjysë shkarpa nëpër kambë,

*) Lajtmotivi i Rilindjes: bashkimi i popullit shqiptar. Vjersha është një thirrje që i shërben së forti momentit historik. Është shkruar më 1902. Të vihet re se Mqedja çdo krijim poetik me temë patriotik e mbush me grishjen për liri e luftës.

1) Arjaniti – Ky asht Gjergj Arjanit Komneni Golem Topia, moshatar i Skënderbeut, princi i Kaninës, i ati i Donikës, gruas së Skënderbeut.

2) Golemi. Moisi Komnen Golem Topia, nipi i Arjanitit të Kaninës. Skënderbeu i dha në zotërim Dibrën e Madhe dhe të voglën. Trim, i njohur për lëkundjen e tij, ku ambicia e çoi edhe në tradhti, por më vonë ai vdiq si besnik i Skënderbeut.

Porsi kualt buqari n'lamë,
Lidhë me 'j pe përpara e çon

Parin tuej, o Male t'Mëdhana!
E njat¹⁾ zog, që s'i vetote
Syni diellin kur shikjote,
Sot nji hanë drapnore e bon.²⁾

Nuk di gjak, nuk di vllazni,
S'din atdhe zemra e dinakut;
E për mnerë anadollakut
I jep forcë për hupje t'vet.

Për qytete e kështjella rojsa³⁾
Frikshëm vrojtun prej Romakut,
Që sot gishti i anadollakut
Tu' u zgërdhi rrenue i shenjon:

Për gjak t'vllazënve që rrkaja⁴⁾
Hap npër male e nëpër fusha,

1) njat – atë

2) bon – dëbon, largon

3) Vargu: Për qytete e kështjella rojsa – Qytete e kështjella, të cilat ishin kthyer në vende të papushtueshme për armiqtlë, madje dhe për Romën e fuqishme. Me këtë varg fillon betimi i poetit dhe grishja e çdo shqiptari që ky betim të jetë bashkimi i tyre për luftë.

4) rrkaja-rrëkeja e gjakut. Luftërat e vazhdueshme të popullit tonë për liri kanë krijuar rrëkera gjaku.

Për t'hukatme¹⁾ që vejusha
Ban mbi fëmijë që pushka rrxon;

Për nderë t'vashave shqyptare,
Që n'derë t'shpis' dhunon nizami,
Për at' dhunë që i pari e i mbrami
Prej Halldupit ban n'heshtim;²⁾

Për tokë base³⁾ e male t'veshme,
Që me kambë dogj otomani,
E ç'atëherë gjith' toka fshani
Pa u stolisë ma kurr n'blerim

Për madhni që shet i hueji
Përmbi Kombin e Shqyptarit;
Për qestina⁴⁾ të barbarit,
Pr' ato lavde që qet Shkjav;⁵⁾

Për kocijt e Skanderbegut
Që prej vorrit xuer Halldupi

1) t'hukatme – vajtime, gjamë me dënesë

2) ban n'heshtim – bart pa e çelë gojën, në heshtje

3) base – pjellore

4) qestina – tallje, shpoti

5) Vargu: Pr' ato lavde që qet Shkjav – Këtu Mqedja nën-vizon pseudomadhështinë e shovinizmit serb lidhur me pretendimet e tij në Ballkan e në trojet shqiptare.

E bashknin' e atmes hupi,
Shkëndinë e zemrave, e i tha;

Mblidhn' ju vllazën, e bashkon' ju
Nën flamur të Shqyptarisë:
Prej nji gjaku, një gjinis'
A Shqyptari kand e kand.

Nji gjuhë shejte t'gjith kuvesim')
Nji istori, nji atdhe, ne kemi,
Geg' e Toskë nji zemre jemi
Me ndjekë, Shqype, hovin tand.

1) kuvesim – kuvendojmë

PËR NJI SHKOLLË SHQYPE MBYLLUN PREJ QEVERISË
OTOMANE*)

(Korçë, 1902)

Pra nji pakicë ferishte¹⁾
Që fjalët e nanës belboshin²⁾
Ë n'agim t'jetës u mësoshin
N'zyre t'njerzisë, n'dashtnim,

T'trembane n'Stembollë, o tigër,
E t'farmakuene³⁾ gjumin!

*) Kjo lirikë nuk është vetëm një protestë dhe një urrejtje kundër thundrës osmane, por aty është shprehur mendimi se populli shqiptar kurrë nuk mposhtet. Mjedja thekson se arsimi i popullit shqiptar është sa dritëdhënës për popullin, aq edhe fatal e i tmerrshëm për pushtuesin. Kjo lirikë është një pamflet e një satirë e fuqishme.

1) ferishte — foshnjë, vocërrak

2) belboshin — sa kishin filluar të flisnin. Këtu: Sa kishin filuar të mësonin.

3) t'farmakueme gjumin — ta prishën gjumin, ta shqetësuon gjumin

Keqas, o i mjerë, ti lumin¹⁾
Me e pritë ke ba mendim.

Ma rrebtë për ndalë e prita
Rrjedha shkumore çohet;
E ma damtore lëshohet
Vala që shkapërcen.

Parzmin t'pafaj t'ferishtes
Me dorë mizore rmove,
E zemrën u mundove
Me i shkepë²⁾ e gjithçka rrfen,³⁾

Me zhbi⁴⁾ n'at zemër t'vocërr
E ç'temeloi natyra!
Me i mësue se a rrenë detyra,
E zani i saj lajthim.⁵⁾

Ma mirë⁶⁾ përbimi krye tande
Prush grumbullove e thëngija
Pr' at ditë kur mbarë Shqypnia
T'shkrehet⁷⁾ mbi ty n'disprim.

-
- 1) lumin – kupto, vërshimin për të mësuar mbarë populli; fëmijë e të rritur.
 - 2) shkepë – çaj shkul
 - 3) gjithçka rrfen – gjithçka tregon, mban brenda zemra
 - 4) me zhbi – çrrënjos
 - 5) lajthim – gënjeshtër, rrenë
 - 6) ma mirë – Më mirë që veprove kështu, sepse më të rreptë bëhen ata.
 - 7) t'shkrehet – të lëshohet

Atëherë këto zemra t'mjera,
Që ti për çudë përftove
Kur zan' e nanës iu shove,
Si bisha o si luaj

Kundra kunorës sate,
T'lyeme me gjak t'pafajvet,
Kanë për t'u lëshue e t'mëdhajvet
Me u pri këta kalamaj.¹⁾

Shtrydhun nën peshë t'mizorve,
Rrethue me kobe e t'kqija,
U zgjue pérherë Shqypnia,
Pérherë ma e re lumnoi.

E gjakut t'derdhun rrkaja
E knelli²⁾ përgjithmonë,
Derisa n'ditë ma t'venë
Mbretna e mbretni vorroi.

Halldup, për t'zeza t'tuja
Qe koha e igjyqit mbërriti;

1) Strofa: Kundra kunorës sate..., thekson idenë se këta fë-mijë, të munduar e të persekuar, kurrë nuk do ta harrojnë kë-të dhe shpejt ata do të rriten, do të bëhen më të mësuar se prindërit e tyre e do t'jenë ata prijës në ide e në luftë.

2) knell – përtërij, ngjall

Me Mojzin Arjaniti¹⁾
Eshtnat e t'parvet rrmon.

E s'rishtas Skanderbegu
Shpatën e mnershme nxori
E mje që²⁾ t'dalë mizori
Prej këndej, n'dorë t'tij veton.

1) Mojzin Arjanitit – Moisi Golemi duc Arjaniti janë duke
nxjerrë eshtrat e të parëve.
2) E mje që – derisa

MIKUT TEM PAL MORETIT*)

Ti mbi kodrat t'Brianzes¹⁾ gjelbrore,
Ti nd'arnaje²⁾ bri lumiit ma t'Madh³⁾),
Kur përhapet ma e gjana fushore
Hijeshue krejt n'arë e livadh:

Ku jesmini, ku vjollca e zymbyli
Rrotull fushën stolisin për shend,
E i kadirun⁴⁾ prej tyne, bylbyli
Pëershndron⁵⁾ ahte⁶⁾ e mjerime n'gazmend,

* Kjo lirikë mbërthen idenë e madhe: Asnjë vend, sado i bukur që të jetë, s'është kurrë më i mirë e më i bukur se atdheu U botua në vitin 1931.

1) Brianze — krahinë e Lombardisë, e përmendur për bukurinë natyrore

2) arnaje — ara

3) lumiit ma t'Madh — Është fjala për lumen Po, një nga lumenjtë më të mëdhenj të Lombardisë.

4) i kadirun — i temjanitur, i mbushur me crë të mirë.

5) pëershndron — ndryshon, kthen, shndërron

6) ahte — rënkime, ankime

M'thrret, o Pal, e n'kët zemër idhnake!¹⁾
Që natyra kurkund nuk paqon,
Shend e kandje, që sates t'i giake
Mb'kët lulishte me i sjellun kujton.

Ah, s'di kandje kjo zemër e mjera!
Larg prej këndenaj nji mall e derpton;²⁾
Ku len dielli ma s'parit e tjera
Bjeshk' e vrrije t'lulzueme gazmon.

Atje larg, përmbi flatra t'prarueme,
T'lëshojnë mendimin, o Pal, fluturim:
Veç ku e llirvet a toka e lulzueme
Zemra eme mund t'presin galdim.

Atje zdapa t'madhnueshëm prej qiellet
Lëshohen malet e kaltërtë mb' nja;³⁾
Atje Shqypja mbretnore përsillet⁴⁾
N'gjire t'plojta⁵⁾ tuj ramun mbi ta.

1) Strofa: M'thrret o Pal, e n'ket zemër idhnake... ka këtë kuptim; Ti më fton o Pal, por zemrën time të vrarë; të hidhëruar se ndodhem larg atdheut, asnjë peizazh, sado i mrekullueshëm të jetë, nuk e qetëson. Nuk mundet të ndiejë zemra ime gjëzim e kënaqësi, siç ndien zemra jote, edhe pse vendlindja jote është e bukur si një lulishte, thotë poeti.

2) derpton — përshkon

3) mb'nja — njëri mbas tjetrit, varg e varg

4) përsillet — rrotullohet në kaltërsi, bën figura në fluturim

5) n'gjire t'plojta — duke u sjellë ngadalë, duke formuar rathë.

Atje me ahe kuvesin çetinat
Trimënин' e nji kombi që kje;
E poshtë Drini, tuj ujtun¹⁾) bashtinat
T'ilirjakve nji epos na bje.²⁾)

Rrokulluese prej malesh n'fushore
Zbrisin shenat e prrojet me tur;
E përrrethit³⁾) n'at valën shkumore
Ndihet gjuha që s'hupi jo kurr.

Ndij ndër lere⁴⁾ t'qytetthit ngujue⁵⁾,
Ndij Rozafën⁶⁾ përmallshëm si këndon,
Kur, temeli i një Shkodrës s'lumnue,
Mban ferishten për gji e e shujton.⁷⁾

1) tuj ujtun — duke ujitur

2) Strofa: Atje me ahe kuvesin (kuvendojnë)...

Eshtë një sintezë poetike, ku, me pak penelata, jepet madhështia e natyrës shqiptare, e bjeshkëve me pyje, ku çetinat e ahet bisedojnë me njëri-tjetrin, si dëshmitarë të bëmave e të lavdisë së këtij kombi trim. Ato flasin për trimërinë ilire, ndërsa Drini poshtë, me rrjedhën e tij, thur eposin ilir.

3) përrrethit — rreth e përqark

4) lere — mure të vjetra të rrënuara, të shkatërruara, gërmadha

5) ngujue — mbyllur, kyçur

6) Rozafa — Gojëdhëna rrëfen se ajo u bë fli për ngritjen e kalasë së Shkodrës që mban emrin e saj.

7) shujton — ushqen

Atje mujsi¹ i pushtedes mizore
Që sot atmen ndër hekura mba,
Skanderbegu, npër malet arbnore
Qëndron shpirt²) e përhapet ndër ta.

E kur hana me rrezet e zbehta
Bjeshk' e vrrije t'stolisin me shend,
Rri fatosi me çetat e veta
Me fatosa tuj çilun kuvend.

Rreth e rrëth nëpër bregje e mbi curra
Prigjojnë³) zanat e maleve mb' nji⁴)
Shka kuvesin për atme ata burra
Si veç goja e fatosave di,⁵)

E me cenë⁶) nëpër male e fushore
Tuba-tuba tu' u sjellun i shef;
N'petka t'bardha si bora dimnore,
N'flokë xhixhlojsa prej hanet⁷), i njef.

1) mujsi – mundësi, ai që mposhti, mundi pushtetin mizo, të turkut, Skënderbeu.

2) Qëndron shpirt – Mbetet shpirt, mbetet mbrojtës e frymë-zues për liri.

3) prigjojnë – përgjojnë

4) mb' nji – së bashku

5) Si veç goja e fatosave di – Ashtu si dinë të kuvendojnë, të flasin, fatosat.

6) me cenë – me zell

7) prej hanet – hëna me rrezet e saj i ndrit flokët

Thoni ju, o çetina, ndër breshta¹⁾
Ça këndoijnë t'lumet²⁾ për Shqypë andej;
Thoni, shena npër fshatat e shpeshta
Tinëzimet³⁾ që zana ju rrfej.

Ndoshta kurr ato vende t'dishrueme
S'do t'i shof un' o Pal, për mallnjim;⁴⁾
N'dhena t'hueja kët jetë t'farmakueme
Ndoshta e sosi tuj dekun n'mërgim.

Oh! atëherna prej trupit t'ngurue
Niket zemër t'pafate ma shkreh⁵⁾
N'atdhe temin dhe dekun tu' e çue,
Prej galdimit e shuemja tesh rrëh.⁶⁾

1) breshta – pyje me bredha

2) t'lumet – zanat

3) tinëzimet – fshehtësitë

4) për mallnjim – për të fashitë mallin, për t'u çmallur

5) ma shkreh – ma shkul

6) Strofa e fundit: Oh! atëherna, prej trupi t'ngurue... Zemra e poetit; edhe shkulur nga trupi i ngujuar; I ngirë; do të rrahë përsëri, prej gëzimit porsa Pali ta çojë në atdhe, në Shqipëri.

MIKUT P. MORETIT

*Kur kthei talian kangën teme¹⁾
«Vorri i Skanderbegut»*

E tine²⁾, o Pal, kujtove
Se 'j ndiejsinë³⁾ burrnie
Në këto kohna qytetnie
Evropës i zgjove,

Si kur Adriatiku,
Dyndun⁴⁾ prej mnerës, lumote
Mb'ani⁵⁾ që Roma i çote
E Venediku

T'Madhit Shqyptar.⁶⁾ Prej zijet
Pritte Italia e true

1) Kur përktheu italisht këngën time «Vorri i Skanderbegut».

2) tine — ti

3) ndijesinë — ndjesi, ndjenjë

4) dyndun prej mnerës — tronditür prej tmerrit

5) ani — anijet

6) t'Madhit Shqyptar — Skënderbeut

Shka vjen prej asaj Krue
Prej Shqyptariet,

E kurna¹⁾ Sfetigratin²⁾
Marrë prej Fatosit ndijshin,
E kur shtegtarët iu bijshin³⁾
Thye Amuratin:

Dyndej gjith' deti e bregu,
E ushtote 'j brohori
Tuj britë Evropa unji⁴⁾:
Rrnoftë Skanderbegu!

E me kumbon' e topa
I rrfeshin t'parët vogjisë⁵⁾
Se për trimni t'Shqypnisë
Pshtoi prap Evropa.

Po atëherë ndjesina⁶⁾ tjera
Në zemër Evropa mbëlote.⁷⁾

1) kurna — kur

2) Stefigradi — Qe kaqja e fundit që Skënderbeu e mori me luftë, pasi u kthye në Shqipëri. Në këtë betejë u shqua si udhëheqës Moisi Golemi.

3) Vargu: E kur shtegtarët ju bijshin/ Thye Amuratin — Kur udhëtarët sillnin lajmet se sultan Murati ishte thyer.

4) unji — krejt, mbarë

5) vogjisë — popujve

6) ndjesina — ndjenja

7) mbëlote — ushqente, fshinte

Për tjetër shllim¹⁾) luftote
Italje e mjera.

Njaj komb i yt që zanin
E gjuhën e lulzue
Përtej Egjen tuj t'çue
Bindte Otomanin.

E rreth ku i shkelte kamba
Dritë qytetniet bite;
E madhnis' së tij larg prite
Uzdaja e trama.²⁾

Në flamur t'lumnuem që n'dore
Kish Morosini³⁾ shkrue
Kryq e liri tuj vrue⁴⁾
Hana drapnore⁵⁾,

Dridhej mizorja⁶⁾ e idhnimin
Në zemër përdhuni pritte;⁷⁾

1) shllim qëllim

2) trama – frika

3) Françesko Morosini (1618-1694); kapiten venedikas qëndroi 28 muaj i rrethuar në Kretë nga turqit, të cilët i theu në Dardanele më 1687.

4) tue vrue – duke vërejtur

5) hana drapnore – Perandoria Otomane

6) mizorja – Turqia

7) Në zemër përdhuni pritte – Hidhërimin e mbyllte në zemër; pritte – ndalte; këtu: mbyllte

E Venedikut rritte¹⁾
Ora Kështërimin.²⁾

Sot për qëllim asht ari
E dhuna tregtari;
Për t'rejen qytetni
Rrjedh gjak Vardari.³⁾

E ndër haremë t'mshehta
Çika t'Evropës tregtojnë,
Që helmi do t'mbarojnë
O thika t'mprehta.⁴⁾

Sot otomanit topa
I nep për mizori,
E krahin t'pafuqi
I mban Evropa⁵⁾

1) Venedikut rritte — lartësonte, jepte

2) Kështërimin — Duhet nënkuptuar edhe qytetërimi.

3) Vargu Rrjedh gjak Vardari: Lumi Vardar është mbushur me gjak. Vite të një luftë të rreptë, 1908-1910, ku një nga kumet e saj është beteja e Kaçanikut. Poeti ka parasysh betejën që zhvillohet në Veri, në Kosovë kundër Xhavit e Shefqet Tur-gut pasqës.

4) Strofa: E ndër haremë t'mshehta...

ka kuptimin: Çikat, vajzat që shiten nëpër haremët e Evropës do t'i zhdukë ose helmi, ose thikat e mprehta, sepse këto haremë ishin dhe vende kriminaliteti.

5) Evropa e ushqeu Perandorinë osmane që të kryejë mizori me topa. Në këtë strofë vihet se fare mirë demaskimi që i bën Mqedja politikës grabitqare të Evropës ndaj Shqipërisë, duke e parë atë si luftënxitëse.

NË DEKË TË SHOQIT TEM G.J.S.

Ishte tu' u errun nata,
E përmbi krye ngurue
I rrishë kur lingata
Shkrite njat jetë t'dishrue;
E thoshe; pra s'do t'desin
Nji që sa shokë mbë të shpresin.¹⁾

Shpreson nji atdhe për dije
E harte²⁾ që n'të shndrisin;
Për at dashtni e shije
Që zemrën ia stolisin;
E i veton rrebtë nji mende
Ndër shkrime e ndër kuvende.

Por aj mbi krejcën pshtetun
Ryeshëm e ngrehi shtatin,

1) Shpresin – shpresojnë. Nuk besojnë se do të vdesë ai shok, njeri tek i cili shpresojnë të tjerët.

2) harte – artë, që duhet kuptuar letërsi, muzikë, pikture e skulpturë. Artet e bukurë.

E syt', përpara mbetun,
I ngjalli prap, e shtratin
I trandi nji fuqi
Ardhun n'at'cas përsëri.

E më thotë: o vlla, nji teje
Këto zemra përgjithëherë,
T' forcuemë prej nji feje¹⁾
Rrahne n'këtë jetë të mjerë;
Nji caku kje, nji shkëndia
E zemrës: Shqyptaria.

Për mue kjo jetë po soset,
O vlla, pa u sosun nata;
Kjo tymen do t'paloset
Pa u endun mirë e ngrata.
Por jo, për këte s'mërzitem,
Se 'j jetës ma t'mirë i avitem.²⁾

Vetëm ndër dhena t'hueja
Me dekun, o Shqypni!?

Para se n'fusha tueja
T' ndeshem nji herë përsëri,
T'falem me bjeshkt' e ngrine³⁾
Që ti n'lulzim përtrine.

1) nji feje – Ka më shumë kuptimin «nji bese».

2) jetës ma të mirë i aviten – paragjykim fetar për jetën tej varrit.

3) bjeshk' e ngrine – Bjeshkët e ngrira, plot borë e akull, por që ardhja e prandverës i përtërin, i lulëzon.

O prill i ri; ku lliri
Zotnoi nji ditë ma së parit,
E kombi i huej s'e shtiri¹⁾)
Detin për n'tokë t'Shqyptarit;
Por lir' e fuqiplete
Shqypja dykrenshe urdhnote,

Ku Topja i madh flamorin
Tand kundra t'huejit qiti,
Shqype, e kah ti krahnorin
T'mësuemit nën zgjedhë valviti,
E ndrroi n'liri robnimin
Nën Vérin e Prendimin.

Pa puthë njato shkambie
T'lame me gjak t'Shqyptarit;
Pa u hjekë mbi gjuj vallnie
Që eshtnat vorruen t'barbarit,
Kur mnershëm si rrufe
Për kryq e për atdhe

Lëshohej ku i dekës ish shtegu
Mbi çeta t'Anadollit
I rrëmbyeshëm Skanderbegu
Si shkulmet e Devollit,
Si valët e j'prrojt që majë
Lëshon, e npër fushë bje rrkaja.

1) shtiri – folja shtjerr, përshkoj, kaloj ujët aty ku është më cekët. Pra, kombi i huaj s'arriti të kapërcente detin e të zbris-te në tokë.

Pa t'gëzue përsëri, moj Shkodër,
Që m'bane djalë t'Shqypnis
E n'hije t'njasaj kodër
Urojmës¹⁾ s'lliris:
Eshtnat me i lanë, e urime
Me pritë prej kuj n'gjuhë time.

E u pak: me dorë i shkova
Djersën e ftohtë, e m'zbritshin
Lott kur mahnit' e vrova
Hyjxit, që nalt shëtitshin
Nëpër dritore e vruene
Me sy t'përlotët, e shkruene,

Ngrimun si 'j gur, mbi krye
Kqyrshe ato vol trishtimi;²⁾
Kur ai, si t'ish tuj kthye
Shpirti prej ndo'j udhtimi,
Tuj çilun syt' përsri
Tha t'mbramen fjalë: Shqypni.

1) urojmë – shtyllë, mburojë

2) vol trishtimi – grumbull trishtimesh, trishtim të madh.

VJOLLCËS

Manushaqe,
Që po knaqe
Mshehë ndër ferra
Ku s'shef kend;

Ti nuk dite,
Moj orëngrite,¹⁾
Me e mshehë vedin
Përnjimend;

T'tradhton era
Që prendvera
Botës ia hapi
Anekand;

Tash shtegtare
Njeti bare.²⁾
Bore, e mjera³⁾
Shendin tand.

1) orëngrite – fatzezë

2) njeti bare – gjetiu, të çojnë gjetiu, të këpusin

3) bore, e mjera – humbe, o e mjerë

NJI SHOQIT QË KTHEHET NË SHQYPNI*)

N'lulishte e ndër breshta
Që msyni prendvera,
Kthen rishtas kah vjeshta
E zogjve potra:
Kthejn' n'qiella ma t'kaltërtat,
Ku t'çilin zymbyli.
Dallndysha e bylbyli.

E ty, tuj shtegtue
N'nji dhé që dan dedi,¹⁾
Bylbylat, o Ndue,
Po t'marrin me wedi;
Ndër dhena t'fatosave,
Ku rrjedhën ka Drini,
Dallndysha që t'prini.

Shko, se ernat e leta
Po t'qesin tej dedin;

*)Vjersha përmban një notë të thellë dashurie për atdhe. Pikënisja personale nuk zbeh tendencën patriotike të poezisë, por, përkundrazi, e bën më të fortë.

1) dedi — deti

Anijat e shpejta
Pa trandun vetvedin
Ndër ujna t'pamatuna,
Gazmohen me t'çue
Te Shqypet, o Ndue.

Te vendi ku s'parit
Ti dritën e gzove
T'ktij diell e t'shqyptarit
N'gjuhë t'ambël belbove
Ferishte, dhe u dukeshe
Bylbyl, që këndote
Te kumbulla jote,

Te malet e Ishueme
Rreth brezit t'ylberit,
Që zbrisin t'palueme¹⁾)
Me t'nyeme mermerit²⁾)
E t'atmes janë kezja;³⁾)
Lakmue prej diellit
Mbi hiret e prillit.

Te toka fatose
Ku turrej lliri,
O Daun, që rropose

-
- 1) t'palueme – palë-palë
2) me t'ngyeme mermerit – ngjyrë mermeri
3) kezë–kësulë e pruarar

Ushtrina si 'j nieri,
Mbi çeta t'Liburnve ,
Ndër ahe e ndër pisha,
I çartun si bisha.

E e madhe, rrethue
Prej ujnash, mbi kodra,
Me mot tuj luftue,
Fatose duel Shkodra,
Që ndrrimet e rruzullit
Soditi n'madhni
Përherë tu' u përtri

Ku n'suka e n'llivadhe,
S j'zøjë e madhnueme
Ish Lezhja fatmadhe
Me heshta e rrethueme
Prej djelmsh, që lishoheshin
Ndër lufta, ku i joni
Shtërngohej Agroni.

Ti i lum që fushoren
E shtrueme nën Krue
Mund t'shifish, e mndoren
Ma t'madhen shugrue
Prej gjakut t'fatosavet
Që mbar'
për Shqypni
Vetvedin ban' fli.

Kur Gjergj Kastrioti
Si rrfeja, e petriti,
Golem fuqiploti
E i madhi Arjaniti,
E parzmi i njij popullit
Reshtohej mburoje,
Për kryq e për troje.

E mnershëm ushtote
Nën thundër t'Kruetanit
Hukata, që çote
Larç rriba e murranit,
Ndër prroje t'përgjakuna
Kah mali e kah bregu
Tu' u hov' Skanderbegu.

E zagnat t'lantueme
Rrafshote Anadolli
Me trut' e zbrumueme
Që shpata ju holli;
Mb'sa n'brigjet e Bosforit
Hukatshin unjijë
E nuse e fëmijë.

Soditte Sarajin,
Mahnit' Otomani,
Kur gjamën e vajin
Lëçitte Divani

Divani – Këshilli i zyrtarëve më të lartë në oborrin e sultanit
të Turqisë, që kryente funksionet e Gjykatës së Lartë.

Se n'dhenat e nemuna
T'Shqyptarvet i ngrati
U thye Amurati.

Oh! ç'gzuejti tuj ndiemun
Evropa gjithmbare
Se Azjen¹⁾ e hiemun
Ndër dhena shqyptare
Kthei Gjergji kah Bosfori
E shpinën i solli
Evrop's Anadolil

E duert e provueme
Dikurna ia priti
Me krena t'shpulpueme
Që shpata kosit,
E n'maje t'thepisuna,
Mbas hanet që hupi
Shkroi: «S'qaset halldupi.»

1) Azjen — azinë

UZDAJA PA DOBI¹⁾

Mjerë nana tuj dekun
Për mue veç mendonte,
E shkreta dishrote
Me m'lanë pa siklet.

E m'thirri për afrit
Tuj kjamun me mue;
Mandej tuj gjimue
Kshtu m'epite gajret;

Mbasnesrit pa nanën
Belda¹⁾ ke me jetun;²⁾
N'këtë shekull ti vetun,
Mjerë nana, po rri.

*) Vjersha «Uzdaja pa dobi» (Uzedaja – shpresa) u shkrua në Kremona më 1889, me një stil bisede e kontekste nga më të zakonshmet, por të dhëna me art. Sensibiliteti poetik është në qetësinë e delikatesën e bisedës. Gjithmonë jemi në motivin përmallues e përkushtues të Mqedjes ndaj nënës, që nuk i ikën moralizimit.

1) belda – ndoshta

2) jetun – mbetur

Pa hae e pa t'shtrueme
Cullak¹⁾ po rri, bir:
Por nieri për mshirë
Sakt hallin ta di.

Kur tm'marrin mue deka
Po t'mbetë reshperia²⁾
Gjithkush te ajo shpia
Ha bukën e pi.

Mue Nanën m'muer Deka³⁾
E m'mbet reshperia,
Por kush te ajo shpia
S'ha bukën as s'pi.

Prap m'thotë mue Nana:
Kallxoja mir' hallin,
Jetimit zavallin⁴⁾
Zabiti ia hjek.

Si m'thotë mue Nana
la zblova gjithë hallin;
Jetimit zavallin⁴⁾
Zabiti s'ma hjek.

1) cullak – lakuriq, zhveshur

2) reshperia – dyert e pasuna

3) Strofën e gjashtë: Nëna i vdes, po dyert nuk ia hapi kush nga të pasurit.

4) zavallin – hallin, vuajtjen

Prap' m'thote mue Nana:
Merr letrat e kndimin,
Shpesh dija¹⁾ jetimin
E qiti çirak.²⁾

Ndër shkrime, bir fisin³⁾
Nderoje e n'ushtri:
Pse nam e lumni
T'nep fisi për hak.

Me shkrime vet' fisin
Nderova e n'ushtri:
As nam, as lumni
S'm'dha fisi për hak.

As fisi, as zabitit,
As vet' reshperia
Zez hallet e mia
S'm'i kqyri⁴⁾ ndopok.

Kremona, 1889

1) dija — kultura të mësuarit

2) E qiti çirak. — E nxori në drithë.

3) fisin — kombin, popullin, vendin tënd

4) s'm'i kqyri — nuk m'i shikoi, nuk m'i pa

ILIRIA E EPIRI*)

(Kang' për mot që vjen)

Lissus

Prej majës s'malve që mblojn' Shqypnin'
Me ar pshtjellue, me gur t'paçmueshëm
T'vite përrethit tuj ndal' furin'
Drini i lumnueshëm.

E ti ndër kodra me pem' lulzue,
O Lesh, ti rrishe si 'j Zoj' e rande
E nd' ujna t'detit që vijn' me t'lmue
Ti ftyrën tande

Kqyrshe tuj gzue. Stolis' me t'mira,
Me rruga t'shtrueme bukur, me shpia
T'nalta sa qiella, me viaj¹⁾) t'dlira,
Me shkoll' ku fmia

* Ndodhet dorëshkrim ruhet pranë AQSH F.40 D.2. Është shkruar në Goricia, më 1893.

1) Vijë – kanal

T'u rritte n'dije, si mbret ti rrishe
Mbi sa qytete për afrit ishin;
Lakmi kurrnjenit¹⁾ ti i lumi s'kishe
Lakmi t'gjith t'kishin.

Kqyrshe mbi kodra vneshta t'gjelbrueme
E lisa e bredha, e ullishta t'gjana;
Kopshtij gjithfaret, me tok, t'lulzueme²⁾
Ku u ndite zana

Natën n'drit' t'hanes n'velle tuj kndue
Ndër erna lulesh; e posht' n'val' t'detit
E n'lum përgjegjshin shoqet tuj çue,
Tuj ngreh prej vedit³⁾

Gjith' grat' e trimat e njati vendit
E lundratari kur për det shkote
Natën u ndalte, e at' za gazmendit
Tuj ndi gazmote.

1) Kurrnjenit – askujt

2) Në botimin e M. Gurakuqit ky varg është shtypur gabim. Dh. Shuteriqi, në botimin e bërrë në «Nëntori», nr. 3.V.1963 e ka mirë. Në dorëshkrim është kështu: «Kopshtij gjithfaret, me tokë t'lulzueme». Nuk po prekim variantet e vjershës. Po jepim të pranueshmen e autorit. Kështu kemi vepruar dhe përraste të tjera, që nuk janë si origjinali.

3) Tuj ngreh' prej vedit – Duke i joshur vajzat me vallet e këngët e tyre gjindjen e atij vendi, deri edhe lundërtarët që 'kalonin aty.

Kqyrshe avullin¹) e madhe e t'qëndrueshme
Si shkami i malit, ku ti je ngrehun,
Njat avullin' e bardh' e t'lumnueshme,
Që t'mate mshehun²)

Prej hovit t'huejve. Ma se avullia
E pritte hovin krahnori i t'birve
T'tu që shpejtoshin ku e thirrte mnia
Kombin e llirve.

Si luaj ngane me heshta e zhgjeta
Kur t'mjer't Etolat³) syne⁴) Medunin,⁵)
Kur Teuta pshtetun n'ushtria t'veta
Pa ulun gjunin⁶)

Para t'dërguemve prej Rom's, me faqe
T'rrept' i tha t'Madhes⁷): mos prit çä lype.
E at' herna s'parit xun luftna e gjaje
Shqyptart me shqype⁸).

1) avullinë — avllinë, murin, ledhet që rrrethojnë qytetin përmbrrojtje nga sulmet.

2) Që t'mate mshehun. — Që të ruante e nuk t'i tregon te vlerat e pasuritë që t'ndillnin lakminë e të huajt.

3) Etolat — banorët e Etolisë, grekë

4) syne — mësynë

5) Meduni — kështjellë ilire. Sot ndodhet në Mal të Zi.

6) pa ulun gjunin — pa u përkulur

7) s'Madhes — Romës

8) shqype — kupto me romakët, se emblemat e tyre kishin emblemë shqipen. Ishte emblema e liktorëve.

E mir' luftuene, se për fis ngashin¹⁾
Uljini e Shkodra, kurnji pa mbetun;²⁾
Me prit' larg t'huejin llirt u bashin
Si 'j nieri i vetun.

E idyqind lemba³⁾ t'delshin limanit,
Që bani i pari i Sirakuzës;⁴⁾
E ruejshin fisin për s'gjatë e s'gjanin
E u siellshin buzës

T'detit gjithkahna, Mbi barka t'hueja
U Ishoshin t'tana si Ishit shkyferi
Mbi pllumba t'frikshëm kur e merr uja;
O si për mneri⁵⁾)

Çohet furtuna n'det e përsillen
Tallazet t'rrepta e gjimon moti,
E ret' e zeza shkojn' tuj mblue qиellen
E askush i zoti

Sa me e mbajt' lundrën që përpin deti
O e shkrep furia mbi shkambinj t'bregut;

1) Për fis ngashin. — Luftonin për vendin e tyre.

2) Uljini e Shkodra kurnji pa mbetun — gjithë krahinat.

3) lemba — anije ilire të vogla, por të shpejta e të manovrueshme.

4) i pari i Sirakuzës — Dionisi Plak i Sirakuzës, që thuhet se ka ngritur qytetin e Lezhës si dhe ka ndërtuar limanin.

5) për mneri — për tmerr

E bierr me t'dhimtun tregtari i shkreti
Fitimn' e tregut.

Ndër Grek, n'Italje lundrat i hapshin
T'bit tu, o i lumi, tuj ba tregti;
Për t'mirët t'qytetit rrugë e mund kapshin
E për vllazni.

Gjithkush tregtiet kthete ndër shpija
E m'tesha t'arit e me arm' t'reja
E dhandri nuses, e prindve fmija
Ça kishte dheja')

E dija²⁾ e t'largcve, me t'madh gazmendenin
Dhundi t'paçmueshme bishin prej njeti
N't'pasun e n't'mira shifshe gjithkendin,
O i lum qytetil

Po 'j dit' do t'vete e ma i lum do t'ishe
Ndër gjith' qytete me t'thirrun t'parin,³⁾

1) dheja – toka. Në bazë të ligjit të luftës të asaj kohe, ushtarët sillnin në shtëpi plaçkën që fitonin në luftë.

2) dija – dituria.

Strofat: Gjithkush tregtiet kthete ndër shpi... dhe E dija e t'largcve me t'madh gazmendenin.. kanë idenë që sillnin jo vetëm plaçkë; por çdo gjë që kishte të bënte dhe me kulturën, dijen e tyre.

3) me t'thirrun t'parin– qyteti i Lezhës do të lumturohej një ditë se aty do të varrosej Skënderbeu i Madh.

Kur n'nji kish' tande me mbajtun kishe
Ma t'madh Shqyptarin.

.....
.....
.....
.....

Ti do ta shifshe , kur deka t'korrin
Jetën e tij, e t'delte shtegut
T'ksaj botës e ti do t'mbajshe vorrin
E Skanderbegut.

Kur Zotyn' nevet njat vorr na bani
Lter ku për fisin lirim u lypte,
Te ti po vite Shqypnia, e zani
I saj n'qiell hypte.

Tash gjith' a ndrrue: ku rrishe tine
Sot shef shtegtari shkambije t'shkreta,¹⁾
As s't'mben'²⁾ gërmadha, as shkrime ltine;³⁾
E me flet' t'veta

1) shkambije t'shkreta – Vendi ku ishte ndërtuar Lezha e lavdishme tani ka mbetur me shkëmbinj të shkretë.

2) t'mbenë – të mbetën

3) ltine – latine

Pa t'dhimbunt moti gjithshka ty t'shini,
Ku rrite motit lum shpia e mretit
Tash kullot berri e e pëgan Dini¹⁾
I Muhametit.

O i mjeri! N'luftna ku shndritte lliri
Przie Malcori rri me t'pafe;
E vllau vret vllaznit, vret prindt i biri
Për nji pushk' t're.

Gorizia, 1893

1) E pëgan Dini – E ndyn, e fëlliq besimi fetar muhamadan, pushtuesi osmanlli.

Me vargjet e fundit poeti synon t'i prekë shqiptarët në sedër, duke i qortuar ashpër për gjakmarrjen dhe vrasjet, për ndasitë fetare e shërbimet që i bën tradhtari të huajit, qoftë edhe në emër të fesë.

PËRMBAJTJA

I Jeta dhe vepra e Ndre Mjedjes	5
II Juvenilia	37
Vaiji i bylbylit	39
tretuni	54
Andrra e jetës	73
I mbetuni	95
Shqetegtarri	96
Vorri i Skanderbegut	103
Mahmud pasha	108
Mustaf pasha	118
Malli për atdhe	123
Gjuha shqipe	127
Prendvera	134
Vera	136
Vjeshta	137
Dimni	138
Nga gjuhë të huaja	139
Vaiji i dallëndyshes	141
Vllavrasi	144
Të vorruemit Sir John Moore	148
Mreti i Tules	151
III Vjersha të tjera të papërfshtira nga autorët në «Juvenilia»	153
Andërr	155
Shqypes arbore	157
Bashkoniu	161

Për nji shkollë shqype mbyllun prej qeverisë otomane	165
Mikut tem Pal Moretit	169
Mikut Pal Moreti	174
Në dekë të shoqit tem Gj. S.	178
Vjollcës	182
Nji shoqit që kthehet në Shqypni	183
IV. Vjersha të mbeturë dorëshkrim.....	189
Uzdaja pa dobi	191
Iliria e Epiri	194

Mqedja, N.

Vepra letrare 1. [Red. Li. Siliqi.]
T., «Naim Frashëri». 1988:

1 V.

V.1 204 f

(B.m) dhe

(B.v.): 891. 983

+ :891.983 - 1

M. 88